

81H-31

J 75.

AGIM  
ISAKU



roman

8JH-31  
J75.

Agim  
Isaku



HIJA

---

Roman

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»  
TIRANË

## KAPITULLI I

Dielli po perëndonte i kuq dhe i madh sipër rrafshultës bregdetare. Mbi pellgjet e shumta të rezervatit të gjuetisë, po rrëshqiste kështu një muzg i lehtë paravjeshte, i pandjeshëm, si i zbutur nga lagështia e detit. Gjithë po aq pandjeshëm rrëshqiste mbi ujëra një varkë e lehtë dhe e gjatë druri. Në bashin e saj, mbështjellë me një xhakavento të madhe ushtarake, rrinte si i mpirë kryetari i shoqatës së gjahtarëve. Çiften e kishte të mbështetur në supin e majtë. Një djalë i ri truphequr, mbase i biri i rojtarit të rezervatit, e shtynte varkën me një hu të gjatë që e ngulte ritmikisht në tokën e butë, poshtë ujit të cekët. Vetëm kur varka po kalonte fare pranë pritës së tyre, Reshat Zagora pa në fundin e saj një rrjetë me rreth druri, nga ato që

natyralistët i përdorin për të kapur fluturat. Tani rrjeta mbliidhte dritën e fundit të asaj dite të ngrohtë.

Reshat Zagora lëvizi këmbën e djathtë që i ishte mpirë. Poshtë tij kërcitën barërat e thata. Larg u dëgjuan rrahje të shpejta krahësh. Nga fëshfërima e mprehtë ai e kuptoi se ishin rosat dhe u kthye sërish në drejtim të gjahut. Rosat i mbyllën krahët për të zënë vend në një prej brigjeve të përtejme, pas kallamave që tani e kishin tharë gjethin e tyre të fundit. U nder një heshtje e ankthshme që dukej sikur po e gërvishtte sipërfaqen e ujërave. Pastaj rosat i hapën flatrat përsëri për të zbutur uljen dhe, në çast, u dëgjuan të shtëna armësh, lehje zagarësh, pastaj rrahje të alarmuara krahësh. Të trembura, gjithë duke fituar lartësi e shpejtësi, rosat po vinin drejt pritës ku kishte zënë vend ai. Nëpër zhukat e rënduara nga kërmijtë u dëgjua sërish kënga e bulkthave. Rosat kaluan pikërisht sipër grykës së armës së tij, por Reshati nuk pati asnjë dëshirë për të qëlluar. Ato ikën duke u përpjekur të vinin një lloj rregulli në rreshtimin e tyre. Kërkonin një vend tjetër ku të kalonin natën, mbase përtej pyllit të vogël, por Reshati e dinte se atje kishte gjahtarë të tjerë.

U dëgjuan lehje të tjera zagarësh, kësaj rradhe më afër, pastaj pllaquritje në ujë. Me sa duket ndonjë nga rosat e goditura kishte rënë në kënetë.

— Pse nuk qëlluat?

Reshati ktheu kokën dhe pothuaj u habit kur pa se nuk ishte vetëm në pritë. E kishte harruar fare Fore Farashukun, fytyra e gjerë e të cilit, dy pëllëmbë më tej, ishte skuqur e gjitha. Arma i dridhej në dorën e madhe gishta-trashë.

— Të kishit qëlluar! — tha Fore Farashuku, kësaj radhe me zë të butë, sikur përpiqej të shtypte poshtë tij qortimin që i lejoi vetes pak sekonda më parë. — Me siguri që fishekët nuk do t'ju shkonin kot. — Dhe qeshi me gjysmën e poshtme të fytyrës, si për t'i kërkuar falje.

— Pse nuk qëlllove ti? — ia ktheu fare qetësisht Reshati duke e ulur armën mbi gjunjë.

— Unë? Po ja, ashtu... kujtova se do të qëllonit ju dhe... prita, pra nuk qëllova, he...

Përtej grumbullit të vogël të pemëve që përpiqeshin më kot të dukeshin si pyll, u dëgjuan të shtëna të njëpasnjëshme. Pastaj lehje zagarrësh. Klithma të shpeshta zogjsh nate. Pllaquritje në ujë. Fërfëllimë flatrash. Krisje barërash të thata.

Reshati e theu armën siç e kishte mbi gjunjë dhe hoqi fishekët duke i kapur me thonjtë e fortë.

— Nuk do të gjuajmë më? — pyeti me një lloj pakënaqësie Fore Farashuku.

— Jo. Ti po të duash vazhdo. Unë po të pres në hotel.

Fore Farashuku u ngrit i pari.

— Unë për ju erdha. Ju e dini, se mos kam ndonjë pasion të madh për gjahun unë! Po ikim bashkë.

— Ikim! — përsëriti edhe Reshati, por nuk lëvizi nga vendi. Mbi sipërfaqen e ujit që reflektonte një dritë të mugët, po kthehej varka e lehtë prej druri. Lëvizjet e djalit tani ishin më të shkathëta. Në pupë ishte ulur një vajzë veshur me bluzë të bardhë, me sa duket ndonjë nga punonjëset e fazanerisë pranë rezervatit. Në prehër mbante një kovë të madhe plastike. Diçka trazonte pa pushim aty brenda, përhumbshëm, dhe Reshati pati ndjesinë se nga çasti në çast ajo do të fillonte të shpërndante nëpër sipërfaqen e lëmuar të ujit **ushqim për zogjtë**. Si në kohët e lashta, tha me vete Reshati duke provuar një ndjenjë qetësuese përjetësie.

— Ikim? — pyeti Fore Farashuku që rrinte në këmbë me çantën e marshimit hedhur në njërin sup.

Reshati nuk foli dhe iu duk sikur e folura e tjetrit, duke thyer qetësinë që mbretëronte përqark, i hiqte edhe atij diçka nga shpirti. Sigurisht Fore Farashuku nuk kishte asnjë faj për këtë. Mbase e kishte fajin ajo rrjeta në fundin e varkës që, pasi kishte mbledhur dritën e fundit të ditës, ishte kthyer tani për të marrë diçka edhe tek ai.

Ujërat ishin bërë të errëta dhe klithma e vetmuar e një zogu nate i ktheu në shpirt një ndjenjë të pakuptueshme turbullire. U desh edhe

pingërima tepër e veçantë e një zogu tjetër, që turbullira të mblidhej lëmsh dhe, duke u lëkundur si pendul, t'i lëndonte gati materialisht rropullitë, të cilat, teksa përpiqeshin t'i iknin goditjes së saj, ishin larguar nga vendet e veta dhe kishin dalë pothuajse në kafazin e kraharorit.

U mbështet me shpinë pas gardhit të pritës. Nga ky pozicion i ri mund të shikonte nja 500-600 metra më tej një kasolle të vogël kashte. Ndërtimi i saj, qetësia që e rrethonte, bluja e mbyllur që kullonte sipër kulmit tepër të pjerrët kishte diçka nga filmat dhe atij iu kujtua Bert Drenica. Sa muaj kishte pa e takuar? Dy? Tre? Në takimin e fundit ai i kishte thënë se po përgatitej të xhironte një film me një ndodhi disi të rrallë vrasjeje. Madje edhe titullin provizor ashtu e kishte menduar: «Ndodhi e rrallë.»

— Reshat, o Reshat! — dora e madhe e Fore Farashukut po e tundte për supi. Me sa duket për diçka i kishte folur, por ai nuk e kishte dëgjuar. Fytyra e shokut dukej e shqetësuar sinqerisht dhe atij i erdhi mirë.

— Po, — tha ai më në fund, — the gjë?

— Asgjë, asgjë... Thashë se mos ishit i sëmurë...

— Jo, Fore, jam mirë. Mos ki merak për mua.

— Po rrinit pa folur, si i përhumbur dhe unë kujtova se mos... — Fore Farashuku lëshoi një të qeshur dhe, mes së qeshurës e gjeti

me vend të shtonte: — Harrova fare se kam të bëj me një kryetar rrethi! Hallet që keni ju, problemet që ju ziejnë në kokë... Është një rreth i gjithë që pret mendjen tënde...

Goditja e topthit prej leshi që kishte ndier pak më parë t'i mblidhej në gjoks kësaj radhe ishte qendrore, pikërisht në zemër.

— Jo, — tha me nervozizëm Reshati. — Po mendoja gjëra fare pa rëndësi, madje nuk po mendoja fare, po të duash të të them të vërtetën. Po kujtoja, për shembull, kasollen në bahçen tuaj, fotografitë e Andreas varur nëpër mure...

— Ha-ha-ha! — qeshi Fore Farashuku kot, duke vënë në lëvizje vetëm pjesën e poshtme të kokës, ndërsa balli ishte po ai i pari, i tendosur dhe i vëmendshëm, sikurse sytë e vegjël. Sa mirë kishte qenë pak më parë, kur ai kishte qenë i shqetësuar. Thjesht i shqetësuar.

Si i kishte thënë në një prej takimeve të fundit Bert Drenica? Po pinin kafe në barin e qetë, ndërtuar sipër qytetit. Reshati po tregonte. Berti sillte nëpër gishta filxhanin bosh të kafesë. Luga e vogël në të bënte një zhurmë nervozuese. Pse nuk tregon edhe ti diçka?, i kishte thënë dikur Reshati. Berti kishte ngritur supet e fuqishme. Tufa e flokëve të drejtë i kishte zënë gjysmën e ballit tepër të lartë. Pastaj, duke vënë buzën në gaz me mundim, sikur kjo t'i shkaktonte dhimbje, kishte shtuar: Kur rri me njerëz si ju, është pak e vështirë të flasësh.



Më mirë të dëgjosh. Reshati e kishte kapur lehtësisht atë ton të veçantë të zërit të Bertit, por nuk kishte dashur ta besonte se ishte ironik. Domethënë?, kërkoi sqarim të mëtejshëm ai. Domethënë, kishte vazhduar kësaj radhe drejtpërdrejt Bert Drenica, ju keni fituar zakonin e keq që vetëm të flisni. Dëgjoni pak ose aspak të tjerët. Reshati kishte heshtur. Nuk e kishte pritur këtë nga një mik dhe në përgjithësi nuk i pëlqenin afrime të tilla të tepruara. Kishte vënë re se e njëjta gjë i ndodhte edhe me Greta Tytymgen, sekretaren e komitetit. Edhe ajo, duke shfrytëzuar njohje të vjetra... U ngrit, tha se kishte një takim dhe iku.

Duke kujtuar këto, Reshati psherëtiu dhe u mbush thellë me frymë.

— Eh, — bëri fare pranë tij, tani pothuajse në terr, Fore Farashuku. — Eh, hallet! Sa halle ka njeriu!

— Fore, — tha Reshati gati me inat, — nuk kam asnjë hall. Asnjë. Qartë?

— Qartë, — tha Fore Farashuku duke rregulluar edhe një herë çantën në supin e majtë.

Reshati u ngrit.

— Do ikim? — pyeti tjetri pa qenë nevoja.

Reshati u nis përpara. Kishte dalë hëna dhe hijet e tyre të gjata e të errëta dukej sikur thyenin në kalim barërat dhe zhukat anash shtegut të ngushtë nëpër të cilin ecnin. Por ata kalonin dhe bimësia ngrihej përsëri, e spërkatur me hënë.

Gjysmë ore më vonë ishin në kompleksin e hotel-klubit pranë detit. Reshati i tha shoferit të mbyllte makinën dhe të vinte të darkonte me ta, por ai iu përgjigj se kishte nevojë të shkonte pasi kishte lënë njërin nga djemtë pa qejf.

— Mund të vish nesër të na marrësh?

— Kur të urdhëroni, — tha Sabriu.

Sapo kapërcyen derën e jashtme të hotel-klubit, u mbështollën me erën e tij karakteristike, një erë vjetërsie, lagështie, kuzhine të mirë dhe tym duhani. Megjithëse gjahtarët e tjerë nuk ishin kthyer ende, të dyja sallat e ngrënies ishin plot. Ishte e shtunë. Një kamerier me fytyrë të zeshkët e tepër të mprehtë u hoqi udhë mes tavolinave. Shumë veta kthenin kokën për t'i parë dhe dy punonjës të komitetit të Partisë u ngritën në këmbë. Reshati shkoi t'i takonte. Fore Farashuku gjithashtu u zgjati dorën e tij të madhe. Njëra nga gratë e punonjësve të Komitetit të Partisë u skuq në fytyrë ndërsa thoshte fjalët e pakta të përshëndetjes dhe Reshati pati përshtypjen, se diku e kishte takuar edhe herë tjetër.

Kamerieri i priste në hapësirat mes tavolinave. Peceta e bardhë në parakrahun e tij të majtë dukej si një tabelë ku mund të shkruhejshin porositë.

— Në dhomën e pritjes? — pyeti ai.

— Sigurisht, — tha Fore Farashuku në vend të Reshatit.

— Në rast se nuk është e zënë, — shtoi Reshati.

— Është e lirë, shoku kryetar, — tha kamerieri pa e kthyer kokën.

Dhoma e pritjes që në të vërtetë s'ishte dhomë, por pothuajse një apartament i shkaktoi Fores një sërë klithmash habie. Tavolinat e rënda të gdhendura në dru lisi të errët, abazhurët që imitonin shandane të lashta, dy kuaj hekuri të gdhendur, qilimat e trashë me push, kondicioneri që gumëzhinte lehtë në cep të dritares, poshtë perdeve e deri te shpendët e balsamosur të vendosur nëpër mure, secila më vete, përbënin një zbulim për të. Hapte një derë, futej në një kthinë, në banjën e madhe veshur me pllaka majolike në ngjyrë të blertë... Reshati rrinte ulur në njërin prej ndenjësive të mbuluar me kuvertën thekëgjatë dhe pinte cigare. Thua, nuk kishte pasur rast tjetër për të ardhur këtu Fore Farashuku? Nga banja në fund të apartamentit u dëgjuan rrjedhje të zhurmshme ujërash. Kishte diçka prej fshatari dhe në të njëjtën kohë prej fëmije në të gjithë sjelljen e Fores dhe kjo i pëlqente Reshatit. Tekefundit ishte diçka e sinqertë.

U hap dera e jashtme dhe në vend të djalit fytyrëhequr hyri njëra nga gratë e shërbimit, e veshur e gjitha me të bardha. Njëkohësisht me

të, duke fshirë duart me peshqirin e madh të vaskës, hyri nga dera tjetër edhe Fore Farashuku.

— Do të hani? — pyeti gruaja. Ajo e kishte zërin të zvergur dhe tepër të ulët, megjithatë të qartë.

— Po, — tha Reshati.

Gruaja dha menynë duke parë në një vend të papërcaktuar me një gjest shkollareje. Porositën biftek dhe shishqebap të çastit. Reshati kërkoi edhe një porcion djathë të bardhë.

— Jo, — u hodh Forja dhe i shkeli syrin Reshatit. — Jo, djathin mos e shkruaj. S'është nevoja. Ti, po të mundësh të na sjellësh ca pjata të lara.

— Bosh?

— Po, bosh.

— Pije do të merrni?

— Verë. Ju e dini që shoku Reshat pi vetëm verë, apo jo?

— Dy shishe?

— Është e mjaftueshme, — tha Reshati. — Faleminderit!

Gruaja doli duke e tërhequr derën pas vetes. Fore Farashuku e la peshqirin në shpinoren e një karrigeje, diku nga cepi i dhomës, dhe filloi të nxirrte nga çanta ushtarake mezet e përgatitura në shtëpi. Reshati shikonte duart e mëdha qimeverdha me pikla të kuqe që hynin e dilnin me shkathtësi në çantë.

— S'ishte nevoja për të gjitha këto, — tha.

— Se mos i kam parë unë! I ka vënë Donika. Kur i thashë se do të gjuanim bashkë, ti e di që unë nuk jam ndonjë gjahtar kushedi, u bë me fletë. Pastaj në kooperativë mund t'i gjesh të gjitha me një çmim të lirë. — Duart e tij vazhdonin të nxirrnin nga thellësia e çantës letra të mbështjella me njolla yndyre përsipër. Reshati pati frikë se do të ndotej mbulesa e bardhë e tavolinës. — Fshati fshat, — vazhdonte në të vetën Forja, — kur s'ke një shok a një mik që të merr e të sjell në qytet!

Reshati e pa me habi. Me sa duket Fore Farashuku i ndjeu sytë e tij dhe ngriti kokën. Vështrimet e tyre u përplasën shkurt. Forja lëshoi një të qeshur kompensuese.

— E di, e di ç'do të më thuash, — tha. — Do të më thuash që të kam ty, sepse unë ty të kam vërtet mik për kokë, po ti, hë-hë, nuk dëgjon nga ai vesh. Për ty unë rri edhe dhjetë vjet të tjerë shef llogarie në kooperativë. Sikur të kishin të gjithë kuadrot ndershmërinë tënde! Le që, se mos të kam rënë pak në qafë ty! Kam një jetë të tërë...

Reshati e ndjeu veten jo mirë, sikur në bark i kishin futur akull.

— E di, — tha dhe lëshoi një buzëqeshje të butë. — E bëjmë më mirë pa shumë fjalë?

— Urdhëro? — duart e Fore Farashukut kishin mbetur brenda çantës. Zhurma e letrave kishte pushuar.

— Pa shumë nderime e fjalë të mëdha, —

sqaroi Reshati. — Është më mirë më duket. Ne jemi shokë të vjetër.

— Më mirë është, — tha Fore Farashuku pa u menduar gjatë, — më mirë doemos, po ja që na marrin në qafë nganjëherë postet. Kryetar komiteti, them unë, dhe, megjithëse shokë të vjetër, sesi të shoh...

— Si?

Fore Farashuku ngriti supet.

— Pa di unë? Ndryshe, jo si atëherë kur ishim në shkollë. Por ama edhe atëherë unë e dija. Dukeshe ti. Dita e mirë, thonë pleqtë, duket që me sabah. E mban mend sa herë kam thënë...

— Jo, nuk e mbaj mend. Megjithatë nuk ka asnjë rëndësi, apo jo?

Fore Farashuku diçka pëshpëriti gjithë me buzën në gaz. Reshati ndezi një cigare dhe vetëm kur e zgjati dorën ta shkundte në taketuke pa se në buzë të saj kishte lënë cigaren tjetër të lënë përgjysmë. E fiku cigaren e parë pa folur. Djali i shërbimit që kishte sjellë pjatat, gotat dhe verën, po ndihmonte Foren për të përgatitur mezet.

— Ku mund të flas në telefon? — pyeti Reshati, më tepër si për t'i lajmëruar se ku po shkonte.

— Në holl, — tha qetësisht djali, pa e ngritur kokën. — Ose në dhomën e shërbimit, po që se dëshironi.

Reshati u ngrit. Kaloi edhe një herë për-

mes sallës së parë, të mbushur plot, dhe, derisa shkoi te telefoni, nuk e kishte të qartë se kujt do t'i telefononte. Qëndroi një çast në mëdyshje me receptorin në dorë, pastaj krijoi numrin e shtëpisë.

— Julia! — tha kur në anën tjetër u ngrit receptori.


— Jo, — u dëgjua zëri i trashë i të birit. — Mami nuk është. Kanë dalë me Lirën.

— Ah, qenke ti, Alban! — tha Reshati pa ditur ç'të shtonte më. Sa shumë ishte trashur zëri i të birit! Mbase kishte filluar të pinte duhan. — Ti pi duhan? — tha me zë dhe në çast u pendua për pyetjen që bëri. Edhe kështu, qyshse i biri ishte kthyer nga shkolla, marrëdhëniet ishin mjaft të ftohta. Disa herë ai kishte menduar se duhej të zhvillonte një bisedë me të, por përherë ose nuk i dilte kohë, ose, edhe kur e fillonte, si për dreq, ose biseda merrte tone ironike, ose ai vetë nxehej pa e kuptuar nga një lloj kokëfortësie të shpjegueshme të Albanit.

— Vetëm për të më bërë këtë pyetje e paskeni ndërprerë gjahun? — Zëri i të birit ishte ironik. U dëgjua që binte diku thellë zilja e portës së jashtme të shtëpisë. — Ja, erdhi mami, mund ta pyesësh atë, — tha ftohtë Albani dhe lëshoi receptorin mbi tavolinën e vogël.

Ai priti. Julia po afrohej duke mërmëritur një motiv të vjetër.

— Ti, Reshat, je? — pyeti ajo.



— Po. Të mora të të them se nuk do të kthehem sonte.

— Po unë këtë e dija.

— Të kisha lajmëruar? Paskam harruar, — gënjeu.

— Reshat, si është puna?

Reshati lëshoi një të qeshur të lodhur.

— Asgjë, — tha. — U gjenda bosh dhe të telefonova. Po tani nuk kam ç'të të them. Kjo është e gjitha.

— Nga flet?

— Nga rezervati i gjuetisë, nga hoteli i rezervatit.

— Me kë je?

— Me Foren. — Nga ana tjetër u dëgjua një mërmërimë e padeshifrueshme. — Ka ndonjë gjë andej?

— Jo. Ah, po, — u kujtua ajo. — Desh harrova. Telefoni ministri i Tregtisë së Brendshme.

— Ndonjë gjë urgjente?

— Jo. Deshi të dinte nëse e keni caktuar apo jo përgjegjësin e seksionit të tregtisë. Nuk tha gjë tjetër. Ti kur do të kthehesh?

— Nesër në drekë. Natën e mirë!

Ndërkohë në sallën e lokalit kishin filluar të vallëzonin dhe atij iu desh njëfarë kohe për të dalë në anën tjetër. Ndrçimi i zbehtë që dukej sikur dobësohej edhe më shumë pasi thithej nga muret e veshura në ngjyrë të errët, i bënte të dukeshin më të ngathëta lëvizjet e



vallëzuesve. A thua kishin vallëzuar në këtë lokal edhe atëherë, para gjysmë shekulli, kur mbreti i Italisë fashiste ia kishte bërë dhuratë këtë hotel-klub dhëndrit të vet, kontit Çiano? Atëherë muzika duhet të kishte qenë tjetër. Mbase kishte pasur thjesht një gramafon të vendosur në një anë. A ishin takuar, siç thoshin, në këtë vend konti Çiano dhe Ribentropi? Ata sigurisht nuk kishin ardhur deri këtu për të vallëzuar. Kishin lënë anijet në det, kishin zbritur pastaj në varka të lehta dhe, duke ecur hajdutërisht nëpër kënetat e turbullta, më pas, nëpër baltërat e rënda, kishin dalë te ky hotel-klub... Dhjetëra herë kishte thënë të pyeste drejtorin e muzeve të rrethit në ishin të vërteta të gjitha këto, dhe i dilte nga mendja. Kurse për Bexhet beun, ish-feudalin më të madh të zonës që vinte këtu për «gjah» dhe i vriste njerëzit «aksidentalisht», ishte i sigurt. Fshatarët që patën shërbyer këtu në vitet e luftës, i kishin treguar se ishin parë edhe arkivole që dilnin nga dyert e hotel-klubit mëngjeseve. Njolla gjaku të freskët mbeteshin nëpër dyshemetë e dhomave. Çarçafë të shqyer, xhama dritaresh të thyer...

Bert Drenica i kishte treguar se filmi i tij i ardhshëm do të kishte në qendër pikërisht një vrasje të tillë. Katër shokë në ndjekjen e bandave. Njëri prej tyre gjendet i vrarë. Askush nuk është në gjendje të japë një përgjigje të prerë dhe të qartë. Mendohet për vetëvrasje. Vetiu lindin pyetjet: Pse e bëri këtë vetëvrasje?

Ç'të fshehta ka marrë me vete atje, në varrin e zi? Shkaktohen pështjellime në forcat e ndjekjes, në familje lindin tensione të rënda. Metastazat e dyshimit, më të tmerrshme se ato të kancerit, shtrihen në rrethin e afërm e të largët farefisnor. E vërteta ishte se atë e kishte vrarë pa dashje njëri nga shokët e vet. Sa rëndon mungesa e sinqeritetit? Kjo ishte pak a shumë pyetja së cilës do t'i përgjigjej filmi. Në një përfytyrim shkespirian i vrari ngrihej nga varri dhe i drejtohej vrasësit duke i kërkuar që t'i hiqte baltën nga gropat e syve, nga veshët, nga vrimat e hundës, nga goja dhe nga pllaka e varrit. Ti dhe vetëm ti mund të më bësh njeri të ndershëm, ashtu siç jam në të vërtetë, i drejtohej ai vrasësit. Dhe gjithçka kishte ndodhur pa dashje. Po, ka gjithë ato mënyra për të vrarë një njeri...

Po qe se Fore Farashuku do ta qëllonte atë aksidentalisht në gjah e sipër, a do të kishte guxim për të deponuar krimin? Reshati e kapi veten te dera e dhomës së pritjes duke formuar pikërisht këtë pyetje dhe i erdhi turp nga vetja. Nuk kishte asnjë të drejtë. Përpara tij fytyra e Fores ishte e qeshur dhe e gëzuar.

Marrëzira, tha ai me vete dhe shkoi e u ul përballë shokut. Ç'ishte nevoja për hamendësimet e tilla të pakuptimta?

## NDËRKAPITULL

(ose parahistori)

*E thirrura nga jashtë ishte përsëritur më me këmbëngulje kur Isuf Shtërgu ishte ngritur përfundimisht në këmbë.*

— Erdha! — thirri ai duke kthyer kokën pa qenë nevoja nga dritarja e vogël dhe e errët.

— Isuf, je në vete? — megjithëse i ulët, zëri i së shoqes ishte i alarmuar seriozisht. — Ku do të shkosh në mesin e natës?

— Fli ti, fli! Mua kot nuk më kanë zgjedhur kryetar këshilli, — tha me një ton të shtruar e tepër të qetë Isuf Shtërgu. Reshatin, i cili i pati dëgjuar si nëpër tym të thirrurat, pëshpërimat e zgjuan përfundimisht. Rrinte shtrirë në

dysHEME, në shtrojat e ngrohta, dhe shikonte të atin që po fuste këmbët e holla e të gjata në pantallonat prej shajaku të zi dhe kishte frikë, ndërsa humbnin ato këmbë në terr, se do të binte e do të shkrihej edhe ai në atë terr, por i ati kishte qëndruar; dukej fytyra e tij ku lëshonte reflekset këmisha e bardhë prej tisorit. Dhe, vetëm atëherë (por ndoshta edhe më vonë, pasi këtë çast ai e kishte sjellë e risjellë shpesh nëpër mend netëve), pra ndërsa shikonte ato këmbë të holla si prej qiriri, ai e kishte kuptuar pse të atin nuk e thërrisnin me mbiemrin e fisit, Zagora, por Shtërgu. Edhe zëri i asaj nate me shi ashtu e kishte thirrur: O Isuf Shtërgu, ore! Eja se u therrën ata të Dakajve. Dhe i ati kishte ikur atë natë të fundvjeshtës së vitit 1947 si një shtërg i vonuar.

Pas dy ditësh, kur gjithçka u bë e qartë (të atin e paskëshin thirrur atë natë diversantët, e kishin lidhur, e kishin shpënë përfund fshatit dhe i kishin prerë kokën barbarisht), plaka e Dakajve, ndërsa pinte kafënë prej qiqrash të ngushëllimit, tha me kokën e vogël të mbështjellë me sharp: Iku. Shokët i patën ikur që në luftë. Shkoi t'i takojë, të shkëmbejë plagët. Kyç e liga për këtë shtëpi!

Reshati, atëherë jo më shumë se dhjetëvjeçar, e dëgjonte me kokën të mbështetur pas gllanikut të zi dhe në sytë e tij fluturonte një shtërg i vonuar.

Pavarësisht nga urimi i plakës së Dakajve,

e keqja erdhi përsëri pas dy muajve. Bora kishte ngrirë dhe retë ishin larguar për t'u hapur udhë ftohtësirave kozmike. Mes asaj së ftohte, Reshati kishte parë ëndërr sikur kishte veshur një pallto të madhe të trashë, të prerë prej jorganit.

Diversantët duhet ta kishin vënë zjarrin aty nga mesnata, por shtëpia u ndez përfundimisht ndaj të zbadhur. Reshati ndjeu t'i digjnin shpuatat e këmbëve, rrëmbeu motrën e vogël, e ëma dy fëmijët e tjerë, dhe dolën përmes tymit, ku sytë këmbët. Me këmbën në dëborë ai pa edhe djegien e trarit të fundit.

Të nesërmen i kishin hipur në një kamion për t'i çuar në qytet. Rrinin në pjesën e përparme të karrocërisë, struktur pas kabinës, brenda së cilës kishin futur ngjeshur ushtarë që ishin të plagosur në përleshjet e asaj dite. Motra i kishte sytë tepër të mëdhenj dhe nuk i kthente asnjëherë nga trupat e diversantëve të vrarë në fund të kamionit. Ata ishin tre, të mbështjellë me kapota të trasha dhe të ngrirë në pozicione të panatyrshme, ashtu siç i pati gjetur plumbi. Reshatit i dukeshin sikur luanin rolin e të vdekurit. Njërit i kishte mbetur pak dëborë në një prej cepave të buzëve dhe ngjante sikur, megjithëse kishte gjatë gjithë rrugës që përtypej, nuk po e mbaronte që nuk po e mbaronte dot. Nëna psherëtinte kohë më kohë me kokën të kthyer mënjanë. Reshati kishte ndjesinë se nga sytë e saj vazhdimisht pikonte diçka që mbetej për-

jetësisht në rrugën plot kthesa. Ishte një substan-  
cë e lehtë, që me ikjen e saj e lehtësonte vazhdi-  
misht nënën.

Makina i shpuri në qendrën e qytetit të vo-  
gël që asokohe ishte edhe qendër e qarkut. Nëna  
nuk pranoi të zbriste pa i hequr më parë trupat  
e diversantëve të vrarë. Policët që e bënë këtë  
punë i lëshuan në borën e ngrirë e të shkelur,  
që dukej si kalldrëm. Mosni, mosni, se është  
gjynah!, kishte thënë nëna, kur koka e njërit prej  
diversantëve qe përplasur lehtë përtokë. Polici  
trupmadh (më vonë Reshati mësoi se atë e qua-  
nin Shaqir Balani) e kishte parë me habi.

— Për diversantin thua? — pyeti ai me një  
lloj mosbesimi.

E ëma vetëm sa tundi kokën për të thënë  
«po».

— Kujdes, — tha edhe sekretari i parë që  
kishte dalë për t'i pritur. Ai iu afrua makinës, i  
mori të gjithë fëmijët njërin pas tjetrit në krahë,  
dhe, pasi i puthte, i lëshonte me kujdes në tokë.  
Reshati nuk pranoi ta ndihmonin dhe u hodh  
vetë. E ëma zbriti në fund fare. Nga njëra prej  
ndërtesave pranë, një ushtar i ri solli një fron  
druri të lyer me bojë të gjelbër për të vënë kë-  
mbën ajo. Psherëtimi që lëshoi ndërsa këmba e  
saj prekte në atë tokë të huaj, qe e gjatë, tepër e  
gjatë dhe tepër e thellë. Reshati i vogël u tremb  
se mos, me mbarimin e asaj psherëtime të thellë,  
e ëma tretej e gjitha.

Atë dimër Reshati filloi edhe shkollën. Në të vërtetë nuk ishte tamam shkollë ajo që bënte. Së bashku me fëmijë të tjerë që kishin pasur pothuajse të njëjtin fat, merrte një sërë njohurish bazë, sistemonte ca të tjera të marra kohë më kohë, në mënyrë që në shtatorin e ardhshëm të regjistrohej në shkollën e rregullt. Në mësim vinin edhe gjashtë partizanë të forcave të mbrojtjes së popullit. Ata i varnin armët prapa derës, hiqnin kapelat dhe uleshin shtrembër në bankat e vogla që nuk i nxinin. Kishte raste kur çanga e alarmit binte në mes të orës së mësimi. Ata ngriheshin vrulltazi, kapnin armët dhe rresh-toheshin në oborrin e kazermës që dukej nga të gjitha dritaret e klasës. Vazhdimisht Reshati kishte frikë se nuk do të ktheheshin. Por ata, pasi mungonin dy apo tri ditë, vinin përsëri, uleshin nëpër bankat e vogla, nxirrnin fletoret që i mbanin në xhepin e pasmë të pantallonave dhe rifillonin të mbanin shënime.

Ashtu i vazhduan mësimet deri në vjeshtën e vitit të ardhshëm. Nëna, së bashku me fëmijët e tjerë, shkoi te xhaxhai në një fshat ku lufta e kishte zënë si hanxhi. Reshati qëndroi në qytet që të kishte mundësi të vazhdonte shkollën. Flinte në kaponon, së bashku me ushtarët e Divizionit të Mbrojtjes së Popullit, dhe hante bukë në një mensë me ta. Sa e sa herë i qëllonte të hante fare pranë sekretarit të parë. Shikonte mustaqet e tij të prera shkurt dhe nuk i durohej sa t'i rriteshin edhe atij qimet e mjekrës e të faqeve.

Vjeshtën e ardhshme, me riorganizimin e klasave, atë e regjistruan në klasën e katërt. Hyri me druajtje ditën e parë në klasë. Këtu ishte ndryshe. Megjithëse pothuajse të një moshe, shokët e klasës iu dukën tepër të vegjël. Nuk kishte më armë të varura prapa derës. Nuk ishin as Zijai i zgjuar e as Velimiri, as Kiço Kiçoku kokëmadh e as Martinkoja që, sa herë shkruante, fishkëllente lehtë, as Bektashi që e lagte lapsin me gjuhën e trashë.

Ai qëndroi një hop te dera pa ditur ku të ulej. Mësuesi e caktoi me një djalë të ngathët, flokët e të cilit, megjithëse të prerë shkurt me gërshërë, dukeshin përsëri si misërishte të thara në diell.

— Si të quajnë?

— Reshat Zagora. Po ty?

— U, sa çantë të bukur që paske. Mua më quajnë Fore Farashuku, — dhe solli nëpër duar çantën prej meshini të Reshatit. — Ku e paske blerë këtë? Apo je djalë pasaniku?

— Jo, nuk jam djalë pasaniku. — Sikur të ishte disi më i njohur me të, ai do t'i kishte kërcyer në fyt. — Ma kanë falur.

Fore Farashuku e kishte hapur ndërkohë kapakun e çantës dhe kishte futur kokën brenda saj. Martinkoja i kishte thënë Reshatit se e kishte marrë në një kamion gjerman. Poshtë kapakut kishte një radhë lapsash ngjyra-ngjyra.

— Sa e bukur! — tha Fore Farashuku. — Kush ta ka falur?



— Një partizan, — tha Reshati. — Martin-koja. E njeh ti?

— Jo. Ti ua thua mësimeve?

Reshati nuk dinte si të përgjigjej. A ua thoshte ai mësimeve? Ngriti supet.

— Po më ndihmove, do të të marr në bahçen time.

## KAPITULLI II

Albani mbylli magnetofonin dhe u shtriq para pasqyrës prej bronzi që arrinte deri në gjysmën e lartësisë së murit. Trupi i gjatë, lakuriq nga mesi e lart, iu duk tepër i mbushur. Hijet e brinjëve dhe gropat e faqeve pothuajse ishin rrumbullakosur. Nga dhoma e ngrënies vazhdonin të vinin zëra. Ende nuk kishin ikur vizitorët e fundit të pasdrekes. Ditëlindja e të atit kishte qenë pa dyshim një ditë e lodhshme për të gjithë. Darka do të ishte edhe më e lodhshme. Nëpër të gjitha dhomat, me gjithë përdorimin dorëlëshuar të deodorantit, mbizotëronin erërat e rënda të gatimit.

Pa orën. Donte dhe një çerek që të vinte gjashtë. Ku të shkonte ai? Shtrati i shprishur,

hedhësi i diskut (imitim tepër vulgar i ndonjë statueti antik), perdja me lule të mëdha lënë përmënjane, grila e ngritur përgjysmë, të qeshurat jo dhe aq të singerta që i ngrinin nervat, këpucët e sportit të hedhura përfund borosë, sirtarët e së cilës ishin shumica të hapur duke zbuluar rrëmujën që zotëronte në ta, fotografia me ngjyra e kushedi ç'këngëtareje që dukej sikur ikte nëpër mjergull fokusesh si për t'iu larguar vështrimit tepër mashkullor të Heminguejt që, në një fotografi pranë, pinte një gotë me uiski; me një fjalë gjithçka i thoshte të vishej e të dilte. Po ku të shkonte? Ndiej çuditërisht i lodhur. Do të kishte qenë më mirë të ishte futur në një punë. Nuk mund të kalohej një vit i gjithi këshu.

Pasi ishte rrëzuar në rezistencë materiale gjatë sesionit të parë, Albani nuk ishte paraqitur fare në sesionin e vjeshtës. Ishte sjellë dy ditë në Tiranë, as nga fakulteti nuk ishte dukur, jo më në provim. Tani duhet të priste sesionin e ri të qershorit. Sigurisht do të ishte shumë mirë sikur të dërronte degë e të vazhdonte për letërsi. A do të ndërhynte babai?

As vetë nuk e merrte vesh ç'i kishte ftohur marrëdhëniet e tyre këto kohët e fundit. Doemos rol kishte luajtur edhe rrëzimi në klasë, por nuk mund të thoshe se kjo ishte e gjitha. Ose, edhe po të ishte e gjitha për babanë, nuk mund të ishte kështu për Albanin, i cili vazhdimisht ndihej i irituar.

Pa e pasur mendjen, e kishte veshur këmi-  
shën dhe po afrohej te dera. Tani në qytet nuk  
ishin më shokët e tij, të cilët kishin ikur për të  
vazhduar studimet. Ku të shkonte këtë mbrëmje?  
Edhe Irma nuk ishte më. Ç'bënte vallë tani ajo  
në Tiranë? Dhe iu shfaq ndërsa zbriste shkallët  
e gjera të gurta të korpusit kryesor të Univer-  
sitetit.

U kthye. Hapi radion që kishte mbetur në  
një stacion të huaj dhe u përpoq të përqendrohej  
për të dëgjuar emisionin e lajmeve. Trafiku i  
drogës dhe i armëve. Pothuajse 15 vjet terror  
fashist në Kili. Në festivalin e Venecias kishte  
pasur sukses të plotë filmi i Herman Olmit «Jetë  
të gjatë zonjës.» Albani mbajti vesh. Të qeshura.  
Kishte mbaruar emisioni i lajmeve dhe një sha-  
kaxhi po i përgojonte ato ende pa u ftohur.

E fiku radion dhe iu afrua dritares. Përrjash-  
ta po binte muzgu dhe rrugët po mbusheshin me  
shëtites. Sa nga ata e dinin që babai i tij, krye-  
tari i komitetit, atë mbrëmje festonte ditëlind-  
jen? Me siguri shumë pak dhe, po qe se në mes  
të shëtitesve nuk kishte punonjës të Komitetit,  
ndoshta askush. Nga dhoma e ndenjjes erdhi e  
qeshura e zhurmshme e Fore Farashukut. Qysh  
se kishte filluar punë në komitet si përgjegjës i  
seksionit të tregtisë, ai i kishte shpeshuar vizi-  
tat në shtëpinë e tyre. Nuk harronte asnjë ditë-  
lindje, nuk mungonte në asnjë sëmundje. Mjaft  
të dëgjonte zërin e tij diku nëpër shtëpi dhe Al-  
bani pyeste të motrën: Hë, ç'solemnitet kemi

sonte? Forja kishte qenë në shtëpi edhe atë natë kur Albani ishte kthyer nga provimi. I përkulur mbi plitkën e vogël me korrent po bënte një kafe. I ati ishte ulur në divanin përballë televizorit me kollare të liruar, pa i hequr këpucët nga këmba. Hë?, e kishte pyetur i ati. U rrëzova, kishte thënë Albani i qetë. Fytyra e të atit qe skuqur. Doemos që do të rrëzoheshe, po të merrshe tërë kohën e kohës me romane... Të kam thënë, e kishte ndërprerë i biri, nuk më pëlqen të bëhem inxhinier, sado me rëndësi që t'ju duket zanati i inxhinierit. Më regjistron dikë tjetër dhe unë do t'ia dal mbanë. Broçkulla, i kishte thirrur i ati, ose bëhesh inxhinier ose do t'i biesh kazmës gjithë ditën në fermë! Kazmës edhe mund t'i bie, kishte thënë Albani, duke u përpjekur të dukej i qetë, por kjo nuk do të thotë asgjë. Sigurisht, i ishte kthyer i ati me ironi, gjithë po me atë fytyrë të kuqe, për ty nuk do të thotë asgjë, ti kujton se gjithçka që fluturon hahet. Jo, unë nuk kujtoj se gjithçka që fluturon hahet. I ati e kishte parë ngultazi. Pastaj fjalët kishin ndjekur njëra-tjetrën derisa kishte ndërhyrë Fore Farashuku. S'ka gjë, ska gjë, është i... kishte dëgjuar Albani zërin e butë të Fores që i fliste të atit, por ai e kishte mbyllur derën dhe nuk e kishte dëgjuar më.

Sigurisht që jam i ri, tha me vete dhe u ul pranë tavolinës, sigurisht që jam i ri. Dhe, sido që të jem, nuk do të bëhem kurrë si ti. Sa herë

që kujtonte atë mbrëmje, nxehej; kishte një dëshirë të papërmbajtur që ajo natë të kthehej edhe një herë dhe gjërat të rridhnin nëpër një shtrat tjetër. Dhe, pikërisht ngaqë e dinte se një gjë e tillë nuk kishte se si të ndodhte, ai nxehej e turfullonte me vete.

U hap dera dhe në të ndarën e ngushtë që u krijua mes asaj dhe murit u duk koka e verdhë e së motrës.

— Po mëson? — pyeti ajo kur e pa me bërryla të mbështetur në tavolinë.

Ai mohoi me kokë.

— Vjen të shkojmë deri te furra të marrim një tavë?

— Po të duash, shkoj edhe vetë.

— Aq më mirë, — tha Lira që kushedi pse kishte marrë një pamje tepër të preokupuar. Me sa duket e ëma i kishte besuar ndonjë prej gje-llëve. — Sa mirë! Kam aq shumë punë në kuzhinë, saqë po më zien koka si tenxhere me pression.

Albani e shikoi me vëmendje. Hunda e ngushtë dhe e gjatë, mollëzat pothuajse të rrafshëta, sytë e vegjël e të zgjuar pranë njëri-tjetrit. Sa shumë që i ngjante të atit!

— Ç'pate? — pyeti e motra.

— Qelbesh erë festë e lavdi, — tha ai duke qeshur e doli.

— I marrë! — dëgjoji të motrën që thoshte pas shpinës së tij.

Te furra nuk kishte shumë njerëz. Ata ishin ulur në një fron të gjatë prej druri mbështetur pas murit në anë të derës lënë hapur dhe i kishin kthyer sytë nga rruga ku kalonin kohë më kohë njerëz të vetmuar. Dokë Jemeni, tavë-pjekësi, ishte ulur në mes të tyre me një cigare të pandezur në gishtat e trashë. Fytyra e tij e bardhë dhe e rrumbullakët se ç'kishte diçka nga brumi.

Albani u afrua si me druajtje.

— U, u, djali i kryetarit, — tha Dokë Jemeni. — Mirëmbërëma!

— Mirëmbërëma! — tha Albani dhe ndjeu gjakun t'i vërshonte deri te veshët. Në zërin e Dokë Jemenit kishte një nënshtresim të keq ironik.

— Mirëmbërëma! — thanë edhe dy-tre zëra të tjerë.

— Do të presësh pak. Ja, ç'ti bësh, ka ca vende, si ç'është furra, që nuk pyesin në është tava e kryetarit apo e hamallit të portit. Furra, more djalë, është e drejtë dhe e paanshme si vdekja. E di ti historinë e vdekjes?

Një djalë që ishte ulur pranë Dokës, u ngrit dhe ia lëshoi vendin Albanit. Vetëm atëherë ai njohu vëllanë e një mjeku gjinekolog, futbollist rezervë të ekipit të rrethit, që banonte në një pallat me të.

— Faleminderit, — tha Albani dhe nuk pranoi të ulej. E kishte takuar disa herë në shtëpi mjekun. Vizitat e tij kohët e fundit ishin shpeshuar.

Pa njerëzit rreth e qark. Dy futbollistë të ekipit të rrethit, zdrukhtari i një prej shkollave tetëvjeçare dhe për të cilin ai nuk ishte i sigurt në quhej Kasem Rahmiu (apo Rahmi Kasemi?).

— Ashtu është, — tha Dokë Jemeni, — po, meqë nuk e ka dëgjuar djali i kryetarit, po e tregoj.

Historia ishte një stisje tepër e pistë dhe banale. Albani u habit kur në fundin e saj disa nga të pranishmit qeshën.

Sytë e të gjithëve ishin kthyer përsëri nga rruga. Një burrë trupmadh kishte në dorë një qesë plastmase të mbushur me sardele. Ecte, fuste dorën në të, merrte diçka dhe e hidhte për-tokë. Ndoshta kokat e sardeleve.

Njëri nga futbollistët kërkoi një cigare. Kasem Rahmiu ose Rahmi Kasemi i zgjati menjëherë paketën e tij.

— Do ti? — e pyeti ai Albanin ndërsa duar të tjera po merrnin cigare në paketën e nderë.

— Jo, faleminderit. Nuk e pi.

— Gjynah, — tha Dokë Jemeni.

Dy-tre veta qeshën.

— Pse? — pyeti Albani dhe në çast u pendua për pyetjen që kishte bërë. Në të gjithë qytetin Dokë Jemeni kishte namin e njeriut të pamëshirshëm që nuk ia përtonte të vinte në lojë cilindo. Kishte një pakicë njerëzish të cilëve kjo u dukej e këndshme dhe, sapo gjenin një copë kohë të lirë, shpejtonin te furra e tij. Por kishte gjithashtu një mendim i cili nuk ia falte atë



ironi të pakufizuar, që shpesh bëhej e panjerezishme. Madje thoshin se ishte pikërisht shoku i tij më i ngushtë skulptori amator Nardi Adhami ai që e kishte përcaktuar më mirë nga të gjithë Dokë Jemenin. Po ta ndash Dokën në dy pjesë simetrike, thoshin se kishte thënë Niko Agushi, dhe të dyja pjesët t'i vendosësh përballë, ato do të fillojnë të shajnë e të shpifin për njëra-tjetrën.

— Si pse, more djali i kryetarit? — e filloi larg e larg Dokë Jemeni duke shtypur cigaren që tani ishte ndotur me gishtat e trashë. — Nuk e di ti se është fatkeqësi për vartësit kur shefi i tyre nuk pi as duhan e as raki? — Të qeshurat përçark gurgullonin të përmbajtura, si të futura nëpër qypa. — Tjetër puna kur shefi pi duhan dhe raki, ia gjen anën, e zbut.

— Po unë nuk jam shef, — u mbrojt dobët Albani.

— E, e, doemos, ti nuk je shef, por ama je bir shefi. E di ti pse lëngu i rrushit quhet raki?

Albani nuk e dinte dhe as që donte ta dinte shpjegimin që i jepte Dokë Jemeni rakisë. Në rrugë u ndezën dritat dhe një mace e zezë që diçka përtypte u tremb, u hodh në ligustrat përannash, pastaj u kthye përsëri. Me sa duket po hante kokat e sardeleve që kishte hedhur pak më parë burri trupmadh. Stoli i gjatë prej druri kishte mbetur në hijen e një peme të vjetër. Duart e njerëzve lëviznin në erë si për të larguar mushkonjat.

Drejt derës së hapur të furrës po afroheshin dy gra të zëna për krahu që shikonin me druajtje përçark. Me sa duket ora për të nxjerrë tavat kishte afruar.

— Fiu! — bëri nën buzë njëri nga futbollistët në drejtim të grave.

Gratë u futën në kuadratin e dritës që dilte nga dera e hapur e furrës.

— Çohu, Dokë!

— Sa shkoi sahati? — pyeti Dokë Jemeni.

— Shtatë e pesë.

U ngritën. Albani hyri në furrë i fundit. Gratë kishin marrë tavat dhe po dilnin. Heshtja që i mbështillte lëvizjet e tyre të druajtura ishte e ligë. Më e ligë se çdo fjalë dhe Albanit i erdhi turp.

Hyri në shtëpi gjithë nerva. La tavën e madhe sipër tavolinës së aneksit dhe iu drejtua s'emës e së motrës pa i parë në sy:

— Sa herë që keni për të çuar tava, më dërgoni mua. Të mos ju shoh të shkelni në atë batlak.

Dhe, pa pritur përgjigje, iku në drejtim të dhomës së tij. Nënë e bijë u panë në sy pa kuptuar gjë.

Aty afër mesnatës Albani u ngrit nga tavolina e punës. I dhimbnin shpina dhe rrëza e qa-

fës. U shtriq dhe u ul sërish të hidhte në të pas-  
tër fillimin e parabolës «Njerëzit pa hije» që e  
kishte shkruar me mundim gjatë dy javëve të  
fundit. E kopjoi shpejt, e lexoi edhe një herë,  
por nuk i pëlqeu. Mbase kishte pasur të drejtë  
poeti Lirak Brezi, me të cilin ishte konsultuar  
para disa ditësh, kur i tha se e kishte menduar  
pak si tepër gjithë ç'donte të shkruante. S'i ke  
lënë shumë vend shpirtit. Kështu mirë, nuk e  
ke menduar keq, domethënë ana racionale është  
mirë, por ndjenjat. Ah, ndjenjat! Dhe ai kishte  
zhvilluar më tej mendimin e tij të ndërlikuar  
për raportet mes ndjenjës dhe mendimit.

Nga dhoma tjetër vinin zhurmat e fundit të  
darkës. Përmes grilës dukej terri i mesnatës. E  
lexoi edhe një herë fletën e mbushur me shkrim  
të imët dhe mezi e mbajti veten për të mos e  
grisur.

U zhvesh me të shpejtë, fiku dritën dhe u  
shtri. Hëna e madhe e vjeshtës, e prerë në gri-  
lën e ulur, binte riska-riska në tapet.

Kështu, murgu i ri Pargo Pardes ishte zhdukur nën hijen e argjipeshkv Johaninit, Sevasti Manuel nën atë të protosevastit të krahut perëndimor Llogo Orsuni; e bukura Ochride nën hijen e gjerë të karalavires Opa Myrfsi etj. etj. etj.

Gjithçka ishte e qartë: hijet e njerëzve kishin fituar një aftësi të lahtarshme, sapo hyje brenda tyre, humbje fytyrën, zërin dhe të gjitha ato gjëra të tjera që i duhen njeriut për të siguruar identitetin. Dhe, sikur të mos mjaftonin ato humbje, në fund fare njeriu zhbëhej.

Atëherë njerëzit filluan të qëndronin larg njerëzve, sidomos në mëngjes herët, në pragmbremje, e, veçanërisht në prani të qirinjve, kandilave, pishtarëve, zjarreve e gjithfarë burimesh të tjera drite që kishin aftësinë të krijonin hije.

Kështu të gjithë shefat e kishin në dorë të zhbënin vartësit e tyre. Mjafton t'i jepnin urdhër: «Eja më pranë» Pa luftë, pa të bërtitura, pa roja të shumta e pa kërcënime, ashtu, thjesht duke buzëqeshur si me përkëdheli, sikur donte të të ledhatonte flokët, shefi të thoshte: «Eja më pranë, eja!».

Dhe njerëzit filluan të qëndronin larg njerëzve.

### KAPITULLI III

U hap dera dhe hyri përgjegjësi i administratës me një dosje tepër të bardhë nën sqetull. Mbajti këmbët një çast te pragu, si për të shpallur se e dinte që nuk po futej në një zyrë çfarëdo, pastaj eci me hap të lehtë e në të njëjtën kohë solemn drejt tavolinës së kryetarit.

— Mirëmëngjesi, shoku kryetar!

— Mirëmëngjesi, Hito! Ç'kemi?

— Një firmë për listën e re të rojës operative për muajin tetor, — ai hapi dosjen e madhe dhe nxori prej andej vetëm dy fije letër. Ia vuri përpara dhe priti në këmbë. Reshat Zagora i hodhi një sy kalimthi listës pa ndalur askund dhe firmosi në fund, poshtë emrit të vet që ishte shkruar me tush të kuq.

— Faleminderit! — tha përgjegjësi i administratës duke marrë fijet e letrës me gishtat e hollë.

— Dhe herë tjetër, o Hito, nuk do të t'i pranoj listat për firmë po që se nuk e zbaton vërejtjen që të kam bërë.

— Urdhëro? — Hito Sporea sikur nuk e kuptonte ku e kishte fjalën Reshati.

— Emrin tim, them, ta shkruash me makinë, si gjithë të tjerët, pa lajle-lule. Mos e përsërit herë tjetër. Qartë?

— Qartë, — tundi kokën Hito Sporea. — Po ne...

— Ditën e mirë! — e ndërpreu Reshat Zagora.

— Punë të mbarë! — tha Hito Sporea dhe u tërhoq drejt derës duke ecur gjysmanash, si gaforret.

Kur u mbyll dera, Reshati po lexonte evidencën e punëve të ditës në bujqësi. Ai kujdesej që vazhdimisht të mbante lidhje me drejtuesit e ekonomive bujqësore; ekipi për ujitjen që kishte drejtuar vetë për më shumë se tetë ditë e kishte kompletuar njohjen e tij të situatës, ndaj shifrat i ishin pothuajse të njohura. Iu kujtua mbledhja që kishte bërë me të gjithë shtabin e rrethit në parcelat me misër të kooperativës «Rruga e takimit». Pa hyrje të gjata, pa fraza të stërholluara. Nata kishte qenë e ngrohtë dhe me hënë. Zhurmëronin ujërat... Ndezi një cigare dhe e thithura e parë i solli një turbullim

të këndshëm. I hodhi një sy kalendarit të tavolinës. 22 shtator. Dielli lind në orën 6 e 31 minuta dhe perëndon në orën 6 e 32 minuta. Dita e barabartë me natën. Ekuinoksi i vjeshtës. Pa dyshim ishte një ditë jogjithfarësh, vështruar në planin gjeografik.

U ngrit dhe hapi derën e brendshme që lidhej me zyrën e vogël të ndihmësit. Memli Muçostepa ngriti kokën nga gazeta e ditës. Vështrimi i tij ishte i lodhur.

— Mirëmëngjesi, Memli!

— Mirëmëngjesi! — Memliu u ngrit në këmbë, pa përçark sikur të mos ishte ai vetë që u ngrit dhe pastaj u ul përsëri në karrigen e lartë.

— Si e ke nënën?

— Ashtu.

— Asnjë shpresë?

— Asnjë.

Reshati u mbush thellë me frymë dhe u duk sikur psherëtiu. Eci në drejtim të dritares që shikonte nga veriu. Në pallatin përballë komitetit, një grua veshur me robdëshambër të zbardhur nga koha, kishte dalë në ballkonin e katit të tretë dhe po derdhte ujin e një borse ngjyrërozë. Reshati pothuajse e ndjeu vakësirën e shtrattit dhe iu hap goja. Vështrimi i gruas ishte i zbrazur.

— Po të duash, shko në shtëpi, — i tha Memliut.

— E kotë. — Memliu hoqi syzet dhe fërkoj sytë me dy gishta të dorës së djathtë. —

Është një ambient tepër lodhës. U bë më shumë se një muaj kështu.

— Si të duash.

Jashtë frynte erë. Në rrugët e ndriçuara nga një diell i fortë shfaqeshin kohë më kohë kalimtarë të paktë. Parulla e madhe «Aksioni, shkollë e madhe edukimi» dukej sikur i drejtohej hapësirës. Në dorën e një kalimtari trupmadh tundej një qese plastmase me peshk.

— Si është peshkimi? — pyeti Reshati.

— Keq, — tha Memliu. — Ka pasur fortunal dhe nuk kanë dalë fare më shumë se gjysma e anijeve në det.

— Domethënë nuk e mbyll planin.

— Po qe se pushon deti, e mbyll. Edhe nja 1500 kv i kanë mbetur për vjetorin.

Reshati vazhdonte të shikonte nga dritarja. Gruaja e shkundi edhe një herë borsën dhe, kur u siguria se në të nuk kishte më ujë, u fut brenda. Degët e akacies, thuajse të zhveshura para kohe, dridheshin nga era. Në pranverë, kur akacia ishte plotësisht e blertë, nga ajo dritare nuk mund të shikoje pallatin përballë.

Zilja e telefonit shungulloi në zyrën e tij të madhe, por Reshati nuk lëvizi nga vendi. Memliu ngriti receptorin e njërit prej tre telefonave që kishte mbi tavolinë.

— Urdhëroni, — tha, — ndihmësi i kryetarit ju dëgjon. — Reshati pa se si fytyra e Memliut u bë tepër serioze dhe, përzier me dhimbjen për nënën që po i vdiste, kishte diçka më



tepër nga sa mund ta mbante, të rëndësishme. Kapi me dorë pjesën e parme të receptorit dhe i foli me zë të ulët Reshatit: — Njëri nga ndihmësit e kryeministrit.

— Ma jep, — tha Reshati dhe zgjati dorën. — Po, — shtoi pastaj me zë tjetër kur vuri receptorin në vesh. — Po, Reshat Zagora jam.

Biseda ishte e shkurtër. Kërkohej që brenda dy ditëve të ishte në kryeministri realizimi i pritshëm i planit dhjetëmuor, kurse, pas dhjetë ditësh, ai vjetori.

— Nëntëmuorin e kemi gati, — tha Memliu.

— Konsultoje edhe një herë me shokët e planit.

— Po.

Ndërsa po dilte, Reshati pa dosjen sipër së cilës ishte shkruar me laps «Letra të popullit».

— Ka ndonjë gjë?

Memliu u mendua pak para se të fliste.

— Edhe ka, — tha pastaj.

Reshati e pa në mënyrë pyetëse.

— S'të marr vesh.

— Është letra e një shitëseje dhe një letër anonime, — ai i nxori nga tufa e letrave dhe ia zgjati. — Këtyre të tjerave u jap udhë vetë.

— Mirë, — tha Reshati. — M'i kalo pastaj.

Në thelb ai ishte i kënaqur nga puna që bënte Memliu. Shumë probleme gjenin zgjidhje që atje, pa arritur në zyrën ngjitur.

— Ke pirë kafe sot?

— Jo, — tha Memliu.

— Eja.

— Shkoni ju, unë po vij pas pak. Sa të rakordoj me shefin e planit. Punë minutash.

— Mirë. Të pres poshtë.

U fut në zyrën e tij, mbylli derën e për-bashkët dhe doli në korridor ku desh u për-plas me Natale Balanin, punonjëse në seksio-nin e planit.

— Mirëmëngjesi! — tha ajo duke u sku-qur lehtë. Në parakrah, mbështetur pas gjok-sit, kishte një dosje që spikaste në sfondin vi-shnjë të fustanit. Shalli i hollë, të cilin kushedi pse nuk e kishte hequr nga qafa, i jepte gjithë pamjes së saj diçka fluturake.

— Kishit punë me mua? — pyeti Reshati kur e ndjeu se heshtja po bëhej më e gjatë nga sa duhej.

— Jo, — ajo tregoi me kokë derën ngjitur, — me shokun Memli. Faleminderit!

Mbase edhe nuk ishte skuqur. Mund të ish-te thjesht refleksi i fustanit vishnje që i jepte fytyrës së saj atë kuqëlim. Veçanërisht mollë-zat dukeshin sikur digjeshin.

Reshati u kthye të mbyllte derën e zyrës së tij. Sidoqoftë, tha me vete kot, sidoqoftë...

— Ditën e mirë, — dëgjoi pas shpine zërin e saj ku voziste një ndjenjë e lehtë lodërtare dhe pastaj rrahjen e takave në dyshemënë e shtruar me dërrasa.

— Mirupafshim! — tha ai pa e kthyer ko-kën.

Kërciti butë çelësi në bravën e vajisur mirë. Takat e saj u dëgjuan për fare pak kohë në heshtjen e korridorit të gjatë, që e mernte dritën nga dy dritare anësore tepër të larta.

Ai shpejtoi të largohej. Kur po kalonte pranë zyrës së seksionit të tregtisë, dëgjoji një zë të trashë që shahej në telefon. Mund të ishte edhe Fore Farashuku. Në mbledhjen e fundit të kryesisë, si kalimthi, Greta Tytymçja, sekretarja e komitetit, e pati ngritur edhe problemin e Fores. Reshat Zagora e kishte ndier të nevojshme të ndërhynte për të sqaruar se vërtet Fore Farashuku ishte disi i ngathët, por, kishte shtuar ai, le të mos harrojmë se askush nga ne nuk u bë zyrtar që në muajin e parë të punës. Aq më tepër, problemet e tregtisë... Greta Tytymçja nuk e kishte kundërshtuar, por edhe vërejtjen e saj nuk e kishte tërhequr.

Zbriti në katin e parë dhe u fut në klubin e vogël. Sikur të ndodhej aty Greta, do të qe mirë ta bisedonte shtruar problemin e Fores. Por në klub nuk kishte njeri. Ai porositi kafënë dhe ndezi një cigare, siç ishte i mbështetur pas banakut të lartë.

Kur u kthye në zyrë, i gjeti mbi tavolinë të dyja letrat që i kishte thënë Memliu. Zgjati dorën energjikisht dhe mori të lexonte të parën letrën anonime. Dukej menjëherë që e kishte shkruar një karrierist. Letra drejtohej kundër zëvendës drejtorit të ndërmarrjes ushqimore, Raqi Osumit. Mirëpo, formulimi i saj ishte disi i

veçantë dhe Reshati u kthye ta lexonte edhe një herë nga fillimi. Vërtet që Raqi Osumi është një djalë me dije dhe i ndershëm, vërtet që lexon shumë dhe është tepër i kulturuar, thonë se di edhe gjuhë të huaja, është parimor dhe i ashpër ndaj shfaqjeve të huaja, rrjedh nga një familje e mirë dhe e varfër, I ati, ngaqë nuk ishte në gjendje t'i rriste vetë të gjithë fëmijët, këtë e besoi në shtëpinë e fëmijës, ka edhe shokë të mirë, për aftësitë që ka e bën kur të duash drejtor e kryetar komiteti, por e ka një të keqe, dhe ky është shkaku që po ju shqetësoj, — shton te letërshkruesi, — është tepër i rrëmbyer dhe sillet keq me vartësit. Dakord, dakord, për të mirën e punës e ka, por ama sillet ashpër.

E lëshoi ngadalë në tavolinë. Megjithëse deklarohet që në krye si letër kundër Raqi Osumit, shija që të shkaktonte ajo ishte krejt e ndryshme. Me sa duket letërshkruesi ose ishte tepër i ndershëm, ose nuk dinte të bënte letra të tilla dhe kishte rënë me këmbët e tij brenda; kishte dashur ta shante dhe, pa e kuptuar as vetë, e kishte lavdëruar nëndrejtorin e tij.

Shkeli butonin jeshil që ndodhej poshtë cepit të tavolinës dhe në çast, sikur të qe prapa saj, në derë u dha Memli Muçostepa me një nënqeshje të zgjuar në fytyrën rrumbullake.

— Këtë letër e kam anonime për Raqi Osumin, — tha Reshati.

— Po?

— S'di. Sesi më duket.

— Prandaj jua kalova juve. Në ndërmarrjen ushqimore po ushtrohet kontroll nga ana e komitetit. Me sa duket kemi të bëjmë thjesht me një masë «profilaktike».

Nganjëherë Memli Muçostepa bëhej i vështirë për t'u kuptuar.

— Në ç'kuptim?

— Domethënë dikush në atë ndërmarrje parashikon lëvizje, spostime dhe me këtë do t'ju kujtojë për diçka. Ose thjesht dikush do t'i dalë para së keqes. Profilaksi, — përsëriti ai i kënaqur nga gjetja e vet, — thjesht profilaksi.

Memliu nuk u hap më tej dhe Reshati nuk deshë të pyeste përsëri.

— Faleminderit, — tha duke lënë të kuptohej se biseda mund të quhej e përfunduar.

Memliu doli. Para se të mbyllte derën, qëndroi pak si në përgjim, pa e kthyer kokën pas, por Reshati e përmbajti veten dhe nuk foli.

Sapo u mbyll dera, ngriti receptorin dhe formoi numrin e seksionit të industrisë së lehtë dhe ushqimore.

— Desha të di diçka për rezultatet e ekipit të kontrollit në ndërmarrjen ushqimore, — tha kur në anën tjetër iu përgjigj përgjegjësi i seksionit. — Jam Reshat Zagora.

Njeriu matanë fillit filloi të rendiste shifra dhe probleme.

— Desha diçka për shokët drejtues të ndërmarrjes, — tha Reshati.

— Në adresë të drejtorit të ndërmarrjes, eki-

pi, me sa duket, do të ketë një sërë vërejtjesh dhe do t'i propozojë komitetit për masa.

— Ju mendoni për shkarkim?

— S'e besoj se shkon deri atje, shoëu kryetar. Shumë mosrealizime kanë shkaqe objektive. Disa mosrealizime në bujqësi kanë reflektuar edhe në planin e ndërmarrjes. Kështu...

— Po për nëndrejtorin? — e ndërpreu Reshati.

— Për Raqi Osumin? — përgjegjësi i seksionit u mendua pak. Me sa dukej po përpiqej të gjente diçka nëpër letrat që duhet të kishte përpara. — S'kam ndonjë të dhënë të veçantë, — tha ai pastaj. — Të interesohem pranë shokëve të tjerë të ekipit?

— Jo. S'është fort e ngutshme. Megjithatë, po qe se ka ndonjë gjë të veçantë, më vini në dijeni. Faleminderit!

— Ju lutem!

Reshati mori një laps të kuq dhe, pasi u mendua një copë herë, shkroi me të në fundin e letrës atje ku duhej që vetë autori të kishte shkruar emrin e tij: Raqi Osumi. U mendua përsëri, e mbështolli me vija të shumta që trasheshin duke kaluar sipër njëra-tjetrës, vuri në fund një pikëpyetje të madhe dhe e ktheu fletën përmbys.

Letra e shitëses Domenika Dani kishte një karakter krejt tjetër. Pa hyrje dhe pa fjalë të mëdha, ajo tregonte se drejtori i ndërmarrjes, Labo Ajeti, kishte disa kohë që i binte në qafë.

E kishte kërcënuar se, po të mos krijonte marrëdhënie intime me të, do ta pushonte nga puna. Ose në shtratin tim, ose në udhë të madhe, i kishte thënë ai, shkruante Domenika Dani.

Në çdo fjalë që lexonte Reshati ndiente gjakun t'i digjte lëkurën e fytyrës. U ngrit dhe u soll një copë herë nëpër zyrën e madhe. Letra, sipas një logjike tepër të thjeshtë (një grua me burrë e fëmijë, kurrsesi nuk do të shtyhej të hapte një nam të keq për veten), ngjante të ishte e vërtetë. Gjatë punës së tij si drejtues ai ishte ndeshur vazhdimisht me probleme të ndryshme, paaftësi, përvetësime, neglizhime në kryerje të detyrës, arrogancë dhe prepotencë, elementë karrieristë, të cilët, duke dashur t'i futnin stërkëmbëshin shefit të tyre, u futnin stërkëmbëshin punëve të shoqërisë, etj., por asnjëherë nuk e kishte ndier veten më keq sesa kur ndeshte në raste të tilla të shfrytëzimit të pozitës.

Është e vërtetë, përsëriste me mend duke përfytyruar buzët e trasha të drejtorit të ndërmarrjes tregtare. Është e vërtetë, po ec e provoje që është e vërtetë.

U ul. Nxori stilografin dhe shkroi me një shkrim nervoz në anë të letrës së shitëses:

«Sh. Fore! Të shqyrtohet me precedencë në drejtorinë e ndërmarrjes dhe, po qe e vërtetë, ndaj drejtorit të mbahet qëndrim i pamëshirshëm.»

Vuri datën dhe firmosi.

Shkeli butonin jeshil për Memliun, ia dha

dosjen dhe doli nga zyra pa i thënë asnjë fjalë.

Ora në sheshin e qytetit tregonte 9 e 43 minuta. Në orën 10 kishte lënë për t'u takuar me sekretarin e parë pasi do të shkonin në ndërmarrjen bujqësore të rrethit. Makina e furnizimit të lokaleve të tregtisë bënte një zhurmë të shtruar. Përmes derës së pasme të furgonit që e kishin lënë hapur, dukeshin tavat me pasta e ëmbëlsira të tjera dhe Reshati pothuajse e ndjeu në gojë ëmbëlsinë e tyre.

Kaloi sheshin para Komitetit Ekzekutiv me duar të lidhura prapa. Një ekskavator po hapte një kanal dhe atij iu desh të ndërronte udhë. Hyri në rrugën «Zigur Lelo». Era e veriut atje i binte përballë, megjithatë ajo ishte ende e ngrohtë. Ndoshta do të kishte qenë më mirë të kishte marrë makinën. Sikur ta kishin bërë me fjalë, sot punohej në të gjitha rrugët që e lidhnin Komitetin Ekzekutiv me atë të Partisë dhe ai e kuptoi se s'mund të arrinte në kohë po të mos nxitonte.

Nga bari në anën tjetër të bulevardit doli trainieri i ekipit të futbollit, i qeshur dhe fill pas tij dy djem të veshur me tuta, ndoshta futbollistë.

— Mirëmëngjesi, shoku kryetar, — thirri ai që larg.

Reshati u mjaftua vetëm me një tundje koke.

Sekretari i parë e priste ulur në ndenjësën e pasme të makinës te shkallët e Komitetit të Partisë.



— Kujtova se nuk do të vije, — tha ai kur Reshati zuri vend në ndenjësen përkrah.

Reshati i tregoi se si iu desh ta zgjaste rru-  
gën.

Lehtë, pothuajse pa u ndier, makina e rëndë lëvizi përpara. Reshatit iu bë se pa Fore Farashukun te dera e Komitetit të Partisë, por nuk e ktheu kokën prapa.

Pas disa minutash makina ishte jashtë qytetit. Bimësia e tharë nga vapa dhe vjeshta, kanalet e shumta në anë të parcelave të mbushura me ujëra nga shirat që kishin rënë kohët e fundit, pemët që dukeshin si të rrjepura ndërroreshin me shpejtësi.

Sekretari i parë po shikonte me vëmendje ca letra. Me cep të syrit Reshati pa se ishin evidencat ditore. Duhet të shkonte doemos atë pasdreke në drejtorinë e naftës. Me gjithë ndryshimet e vazhdueshme në ekipin drejtues, punët në atë sektor nuk po shkonin mbarë. Pasi të përfundonte studimi për natyrën e zonave naftëmbajtëse, duhej parë edhe propozimi që kishte bërë drejtori i ndërmarrjes për të rishikuar diçka në shpërndarjen e të ardhurave. Ia tha mendimin sekretarit të parë.

— Kjo kërkon rakordime me qeverinë, — tha sekretari i parë. Evidencat kishin mbetur të hapura në gjurin e tij dhe tundeshin lehtë.

— Sigurisht, pasi të bëhet studimi për strukturat naftëmbajtëse tepër karakteristike të zonave të rrethit tonë.

— Ashtu, — tha sekretari i parë, por dukej se e kishte mendjen gjetkë. — Në qeveri shkohet me mendim të pjekur.

Reshati e pa ngultas. Pse, nuk e dinte ai që në qeveri shkohet me mendim të pjekur?

— Urdhëro? — tha Reshati, me sa duket me një timbër më shumë nga sa duhej të mprehtë në zë, përderisa sekretari i parë reagoi menjëherë.

— Më fal, — tha ai duke buzëqeshur. — E thashë ashtu, në përgjithësi, — dhe i rrahu gjurin miqësisht. Reshati e besoi. Kishte tre vjet që punonin së bashku dhe tani ai ishte në gjendje ta kuptonte tjetrin.

Në anë të rrugës, një burrë mbi gjashtëdhjetë vjeç, veshur me kilota ushtarake dhe një kapelë leshi në kokë, mori qëndrim gatitu dhe e nderoi me grusht makinën. E gjithë pamja dhe qëndrimi i tij kishin një solemnitet tepër naiv që nuk mund ta merrje për keq.

— Si bëre me punën e djalit? — pyeti sekretari i parë.

— Ka filluar punë.

— Ku?

— Në ndërtim.

— Më mirë kështu. Vazhdon të shkruajë?

— Edhe shkruan. — E bija i kishte thënë se Albani po shkruante një histori, si punë përralle, me hije, ngjarjet e së cilës zhvilloheshin në kohën e Bizantit. Në fytyrën e së bijës kishte preokupim. Si me «hije»? e kishte pyetur Re-

shati. Ku e di unë?, ajo kishte ngritur supet e holla. Një si përrallë. Po t'i afroheshe hijes së një njeriu tjetër, treteshe. Përralla, përralla, kishte thënë Reshati, por diku thellë ishte ngritur pusia e padukshme e dyshimeve. Domethënë shkruan, — tha ai me zë, duke parë nga dritaret e makinës, — por unë nuk besoj se do të bëhet diçka. Më ka sjellë shumë kokëçarje.

— E po fëmijët tanë janë, duhet të kemi më shumë besim, — tha sekretari i parë.

Reshati ngriti supet dhe nuk foli. Sado që xhamat e makinës ishin të blertë, jashtë ndihej vjeshta.

## KAPITULLI IV

Nëna e Memli Muçostepës, pas një përmirësimi disajavor, vdiq nga fundi i tetorit, kur kishin filluar shirat dhe temperaturat ishin ulur në mënyrë të ndjeshme. Reshati u kthye nga mbledhja në Kryeministri aty afër mesditës dhe te nëpunësi i rojës i Komitetit pa lajmërimin. Varrimi do të bëhej po atë pasdreke. U ngjiti në zyrë dhe i telefonoi Memliut në shtëpi. Pasi i dha ngushëllimet e rastit, i tha se me makinën e tij mund të shkonin në varreza të moshuarit e fisit. Për çdo rast do të lajmëronte Sabriun në garazh që të mos e hapte motorin dhe të ishte gati.

— Faleminderit, — tha Memliu me zë të shuar. — Po kemi prenotuar taksin.

— Pavarësisht. Makinën e ke në dispozicion.

— Faleminderit! — përsëriti Memliu.

Për disa sekonda u bë heshtje.

— Ke ndonjë nevojë tjetër?

— Jô. Ishim të përgatitur. Megjithëse edhe pak kafe...

— Mirë, mirë, — e ndërpreu Reshati. — Po dërgoj Sabriun me Fore Farashukun të ta sjellin.

Dera e zyrës u hap dhe në pragun e saj u dha Ollga Çoba, e cila, kur e pa se Reshati po fliste në telefon, deshi të ikte përsëri.

— Mirupafshim! — tha Reshati dhe, sapo mbylli telefonin, u kthye nga dera: — Urdhëro, Ollga!

Fytyra e Ollgës ishte e shqetësuar dhe atij iu duk sikur diçka ishte çrregulluar në pjesën e poshtme të saj, sikur dikush e kishte goditur nga poshtë-lart dhe ia kishte ngjeshur tiparet.

— Më falni, — tha ajo. Edhe të folurit e kishte ndryshe nga herët e tjera. Duke qenë se ajo shpërndante postën, Reshatit i takonte të fliste disa herë në ditë me të.

— Ç'ke kështu? — e pyeti.

Para se të fliste, Ollga e kaloi një herë dorën e vogël sipër flokëve të thinjur sikur deshi të hiqte diçka që atje kishte mbetur rastësisht, pastaj e vuri para gojës dhe tha gojëmbuluar:

— Është turp, e di, e di, është turp ta them, po mua më kanë humbur dhëmbët.

Reshati e pa me habi. Ishte në vete ajo?

— S'të marr vesh, — tha me ton të butë e

tërë kujdes, sikur po fliste me një të sëmurë, — shpjegohu më mirë, të lutem.

— Ka dy ditë që nuk flas dot me njeri. Të thuash që kam bërë ndonjë turp, jo. Po kam humbur dhëmbët. S'di ku i lashë! S'kam lënë zyrë pa kontrolluar. Ua bëra shkresat lëmshtë gjithëve, po s'i gjeta që s'i gjeta. Vetëm në zyrën tuaj nuk kam parë. Më fal! Të shoh pak! Sa të heq merakun!

Reshati mezi e mbajti veten për të mos qeshur me zë. Kishte dëgjuar që njeriu të humbte lloj-lloj gjërash, po kurrë se mund të humbnin edhe dhëmbët.

— Po s'ka mundësi, — tha Reshati. — S'ka sesi... — Situata po i dukej absurde.

— E kam atë drejtë zakoni, i mbaj nganjëherë në duar. Them se mos i kam lënë gjëkund, me ndonjë dosje. Të shoh edhe këtu një herë. Kot, kot e kam...

— Shiko, shiko, — tha Reshati dhe shkoi te dritarja. Në sheshin e vogël e të pjerrët, kalimtarë të rrallë shpejtonin jakëngritur për në punë të tyre. Iu kujtuan kohët e para kur sapo kishte filluar punë si kryetar komiteti. Shpesh rrinte kështu në dritare dhe, duke parë njerëzit, pyeste veten se deri ku ishin kufijtë e pushtetit të tij.

Me kalimin e muajve të parë, kur ai e mori veten nga ajo humbje ekuilibri që i shkaktoi ngritja në postin e kryetarit, ishte fashitur edhe hija e kompleksit të madhështisë, siç e quante

tani, pas kaq vjetësh pune, me emrin e saj të vërtetë.

Më pas aty, nga viti i tretë i punës si kryetar, filloi ta mundonte një ndjenjë e pakundërshtueshme faji. Vuante për çdo mungesë sado të vogël në treg. I dukej sikur të gjitha ankesat i drejtoheshin pikërisht atij. Dhe sa më shumë që shkonin ditët, aq më e fortë bëhej kjo ndjenjë. Kjo i sillte përpëlitje të gjata shpirtërore, nganjëherë vonesa të panevojshme në marrjen e vendimeve. Kaq herë ishte menduar të ulej e t'i shkruante një letër Byrosë Politike ku t'i kërkonte lirimin nga detyra. Dhe do ta kishte bërë sikur të mos e kishte përmbajtur krenaria. Ia kishte treguar gjatë një dreke njërit prej zëvendëskryetarëve të Këshillit të Ministrave gjithë këtë ndjenjë pasigurie. Ai e kishte dëgjuar deri në fund me tepër vëmendje dhe në fund kishte thënë me buzë në gaz se kjo ishte një shfaqje normale e ndershmërisë, por Reshati e kishte gjykuar të pamjaftueshëm dhe tepër dashamirës shpjegimin e tij. U desh të kalonte njëfarë kohe që ai ta kuptonte se kjo ndjesi e hollë faji nuk ishte gjë tjetër veçse një hije këmbëpërpjetë e kompleksit të madhështisë që kishte vuajtur në fillim.

— Nuk qenkan, — tha tepër e trishtuar Ollga Çoba.

Reshati u kthye. Pothuajse e kishte harruar fare se ajo ishte në zyrë.

— Më vjen keq, — tha Reshati duke parë

fytyrën e Ollgës të pikëlluar. Ajo nuk duhej të ishte më shumë se 5 vjet më e madhe se Reshati, por dukej tepër e vjetër. — Mbase i ke lënë diku nëpër shtëpi. Mos u bëj merak, se atje do t'i kesh.

— S'lashë vend. Jo, jo, nuk janë në shtëpi. Më kanë rrjedhur fare. Nuk di ku e kam kokën.

Reshati përgjithësisht u shmangej shpërthimeve të tilla të papërmbajtura, të cilat gjithsesi kërkonin që edhe ti të pozicionoheshe njëfarësoj, prandaj e ndërpreu:

— Mos e bëj kaq të madhe, moj Ollga!

— Ashtu, ashtu thoni ju, shoku kryetar, por ta dish sa frikë kam mos i kam gëlltitur në gjumë!

Reshati e përmbajti me zor të qeshurën. Nuk ia kishte marrë mendja që Ollga të ishte aq naive, gjë që nuk ia lejonte vetë mosha e saj.

— S'është e mundur, — tha.

Ollga u qetësua papritur.

— Ashtu thoni ju?

— Sigurisht.

Edhe djali kështu më tha. Po, kur e thoni ju, do të jetë patjetër e vërtetë. Humbën, humbën, të paktën të mos i kem gëlltitur!

Ollga doli. Reshati iu afrua përsëri dritares. Jashtë kishte filluar përsëri shiu. Kjo donte të thoshte se temperaturat duhet të ishin ngritur disa gradë. Sa lehtë i kishte besuar Ollga. Që në fillim fare, kur filloi punë si kryetar, ai vuri re se kishte ndryshuar edhe pesha e fjalës së tij. Njerëzit e besonin tepër lehtë, aq lehtësisht, sa që



atë më pas kishte filluar ta merrte malli për dialogë të vërtetë, ku ai të thoshte një mendim dhe një tjetër ta kundërshtonte. Kjo kishte bërë që, me kalimin e kohës, veçanërisht në takime pune, ta përmbante veten dhe të fliste vetëm në fund, ose vetëm atëherë kur mendimin e tij e kërkonin. Iu kujtua vërejtja që i kishte bërë Bert Drenica. Ai i kishte thënë të kundërtën, se fliste shumë. Me sa duket kishte diçka që nuk shkonte në raportet mes heshtjes dhe të folurit tek ai. Ndoshta ende, herë pas here, i ngjallej sërish ajo ndjenjë e vjetër që e bënte në raste të veçanta me sa duket fjalaman.

U largua nga dritaret sikur kishte frikë se mos ndonjë prej kalimtarëve shikonte se si ishte skuqur. Goditi lehtë me njërin prej gishtave gjeten më të sipërme të fikusit dhe shkoi e u ul në vendin e tij. Një sërë shkresash prisnin për t'i lexuar. Sipër tyre edhe disa telegrame, me sa duket të ardhura gjatë ditëve që kishte qenë në mbledhje.

Para se të fillonte nga puna, i telefonoi Julisë për t'i thënë se ishte kthyer nga Tirana dhe e porositi të bëhej gati për varrimin e nënës së Memliut. Pastaj krijoi numrin e seksionit të tregtisë. Pas një pauze të shkurtër iu përgjigj një zë gruaje që dukej si përgjëmësh. Me siguri ishte e ulur pranë kaloriferit. Reshati i tha kush ishte dhe zëri i saj sikur u shkund pak.

— Nuk është në zyrë Fore Farashuku? —  
pyeti.

— Jo. Ka dalë.

— Para disa kohësh ju kam përcjellë një letër të një shitëseje, por ende nuk kam marrë përgjigje. Dini gjë ju?

— Letrën e kam lexuar edhe unë, por me të po merret personalisht shoku Fore.

— Kur të kthehet, i thoni të më telefonojë.

— Po e kërkoj që tani, — tha ajo. Nga zëri i saj ishte shkundur dhe përgjumja e fundit. Me sa duket ajo dinte shumë më tepër rreth letrës, por nuk donte ta jepte veten.

— Si e kishte emrin ajo shitësja? — pyeti Reshati si për të provuar hamendjen e tij.

— Domenika Dani, shoku kryetar.

Ishte e vërtetë. Ajo dinte shumë më tepër.

Kur Reshati ngriti kokën nga shkresat, ora po shkonte 15<sup>00</sup> dhe ai iu përgjigj më në fund telefonit që kishte rënë pa ndërprerje pothuajse çdo çerek ore. Ishte nëpunësi i rojës i komitetit. Poshtë një burrë kërkonte takim me të.

— Si e quajnë?

Emri i njeriut që i kërkonte takim nuk i kujtoi asgjë Reshatit, por nëpunësi i rojës i tregoi se kishte disa ditë që e priste dhe ai i tha ta lejonte të ngjitej lart.

Sapo lëshoi receptorin, zilja ra përsëri.

— Po, — tha ai. — Reshat Zagora jam.

— Po ku je, more shoku kryetar, se na i bëre sytë ujë. — Ishte zëri tepër euforik i Fore

Farashukut. Në të njëjtën kohë edhe tepër intim.  
— Si ia kalove asaj Tirane? Mirë, hë? Si në kryeqytet ma, ç'pyes edhe unë!

— Mjaft tani, Fore. — Kohët e fundit Forja ishte bërë tepër i shkathët, gjë që edhe e kishte habitur edhe e kishte gëzuar Reshatin. Megjithatë... Pasi dha porosi të çonin kafe te Memliu, Reshati vazhdoi: — Të mora sidomos për punën e letrës së asaj shitëses.

— Të Domenika Danit? — Nuk ishte e vështirë të vije re se edhe për gojën e Fores emri i saj ishte tepër familjar.

— Po. E sqarove?

— Iku ajo punë. E kanë pushuar.

— Si? Si? — Reshati nuk po u besonte veshëve. — Si e kanë pushuar?

— E kanë pushuar nga puna.

— Dhe e thua kaq qetësisht? Më sqaro pak.

— Me vendim të drejtorisë, për thyerje të rënda disiplinore, sipas kodit të punës. Ajo ka rreth një javë që është pushuar nga puna.

— Ti nuk gjen ndonjë lidhje mes pushimit të saj dhe letrës që më ka drejtuar mua?

Fore Farashuku u përgjigj pa u menduar:

— Mbase edhe mund të ketë një lidhje shkakore. Si njeri i thashethemeve që ishte, doemos që ashtu do të përfundonte. Por gjithçka ishte bërë në rregull e me shkrim. Vërejtje para kolektivit, paralajmërim, pushim. Madje, për të qenë brenda, dy herë paralajmërim e dy herë qortim para kolektivit. Vetëm dy herë pushim

nuk mund të ketë, — dhe Fore Farashuku lëshoi një të qeshur të trashë, acaruese, që Reshatit iu duk e paturpshme.

— Ti e gjykon çështjen të mbyllur me kaq? Fore Farashuku iu shmang përgjigjes:

— Do të shkojmë në varrimin e nënës së Memliut?

Reshatit i hipi gjaku në kokë.

— Nejse, — bëri ai duke e përmbajtur veten me zor. — Unë të pyeta nëse të duket kjo çështje e mbyllur me kaq.

Reshati ishte i nxehur dhe njeriut që u fut në derë i bëri një shenjë të prerë me dorë që të priste përjashta.

Para se të tërhiqej përsëri në korridor, fytyra e njeriut të panjohur bëri një shenjë të dukshme pakënaqësie.

— Të them të drejtën, — zëri i Fores nuk e kishte më atë sigurinë e parë, — mua ashtu më është dukur, megjithatë ju e dini më mirë.

— Dëgjo këtu, unë them të merresh më thellë me këtë punë. Mos të duken të rastit edhe të gjitha ato ngatërresa që ka në ndërmarrje?

— Nëse ju keni sinjalizime të tjera...

— Unë nuk kam asnjë sinjalizim. Kam vetëm letrën e një punëtoreje për drejtorin e saj, i cili e kërcënon me pushim nga puna, sikur të ishte ndërmarrja e të atit. Dhe paralajmërimi që na bëri u vërtetua: ajo u pushua nga puna. E ke takuar ti vetë shitësen?

— Po.

— Dhe?

— Dhe, të them të drejtën, m'u duk edhe mua pak si ngatërrestare, — diçka kishte humbur përfundimisht në sigurinë me të cilën Fore Farashuku kishte folur pak më parë.

— Madje aq shumë ngatërrestare, sa që është në gjendje të ngatërrojë edhe moralin e saj, — ironizoi hidhur Reshati.

— Këtë, të them të drejtën, nuk e kam menduar. . .

— Ta kishe menduar. T'i mendosh të gjitha dhe të bësh një relacion të hollësishëm me shkrim për shqetësimet e ndërmarrjes tregtare.

— Ajo ka ndër mend t'i drejtohet gjyqit. Po sikur të prisnim edhe rezultatet e gjyqit?

— Ajo na është drejtuar neve, domethënë mua, dhe me emrin tim, të paktën në këtë rast, ajo lidh pushtetin. Sipas teje u dashka që pushteti të presë vendimin e gjyqit a kushedi të ç'organizmi tjetër, pa të japë pastaj mendimin e vet?

— Si të urdhëroni!

— Kështu urdhëroj! — Dhe mos harro për kafen! — Reshati e mbylli telefonin pa pritur ç'do të thoshte tjetri. Vetëtimthi iu kujtua i ati ndërsa vishte për herë të fundit pantallonat në atë natë të largët të fundvjeshtës së vitit 1947. Mos shko, i kishte thënë e shoqja. Do të shkoj, ishte përgjigjur Isuf Shtërgu, kot nuk më kanë zgjedhur kryetar këshilli.

Fshiu djersët. Duart e mbushura me damarë

të kërcyer blu i dridheshin lehtë. Ndezi një cigare.

Dera trokiti. Me sa duket, duhet të kishin trokitur edhe herë të tjera, pasi, për veshin e Reshatit zhurma e trokitjes ishte tepër afër, sikur të kishte dalë prej andej jehona e trokitjeve të para. Iu kujtua fytyra e pakënaqur që ishte tërhequr ndërsa ai fliste në telefon. U përpoq të sillte ndër mend emrin, por ishte e pamundur.

— Hyr — tha me zë të lartë.

Ishte vërtet burri që kishte dashur të futej pak përpara. Tani fytyra e tij ishte bërë katrore nga pakënaqësia. Reshati u përpoq të buzëqeshte, por fytyra e tjetrit nuk lëvizi. Kishte veshur një pardësy të trashë kafe me jakë tepër të vogël, të modelit të para dhjetë vjetëve. Vinte i shkurtër, i mbushur, me flokë të krehur lart, paksa të thinjur në anë. Reshati i zgjati dorën. Dora e tjetrit ishte e ngathët dhe e tultë, me mish të fortë.

— Uluni! — Reshati i tregoi një prej kolltukëve rreth tavolinës së ulët ku kishin mbetur gazetat e dy ditëve të shkuara.

— Faleminderit! — tha burri prerë dhe nuk u ul.

Nuk do të zbutet, mendoi me shpoti Reshati. Burri i lidhi duart përpara barkut dhe, me këmbët e hapura në gjerësinë e shpatullave, mori një qëndrim tepër monumental. Rrëshqitazi Reshati vuri re se të gjithë gishtat e dorës së tij

ishin të së njëjtës gjatësi, si të prerë nxitimthi me sharrë.

— Flisni!

— Më mirë të flisni ju, — ia ktheu burri. Tani po bëhej enigmatik si një sfinks në miniaturë.

Reshati ngriti kokën dhe e pa me habi.

— Nëse ke ardhur të na bësh lodra këtu... — ai tregoi me dorë nga dera.

Burri u lëkund njëherë mëdyshazi, pastaj foli:

— Kam ardhur të marr vesh si e emëruat inxhinieren Eglantina Gega në ndërmarrjen e peshkimit, në vend që të emëroni gruan time.

Reshati u mbush me frymë para se të fliste, pastaj tha shtruar, por prerazi:

— Së pari unë nuk e di cila është gruaja juaj, — ai bëri një pauzë, aq sa i duhej tjetrit për të thënë emrin e gruas.

Vendimi për të shkuar në peshkim Eglantina Gega dhe jo gruaja e burrit që kishte përballë kishte qenë një vendim pa dyshime. Shefi i kuadrit pati lexuar edhe kërkesën e një inxhinierje që donte të largohej nga ndërmarrja e naf-tës, por nuk ishte marrë parasysh për arsyen e thjeshtë që inxhinierja, domethënë gruaja e burrit që kishte përballë, kishte një sërë disavantazhesh, të cilat tani Reshati nuk mund t'i kujtonte. Mund të kishte thirrur këtu njërin nga seksioni i kuadrit, por pamja e burrit ishte pothuajse kërcënuese dhe Reshati provoi dëshirën për ta përballuar vetë.

— Dhe së dyti, unë dhe e gjithë kryesia e komitetit kemi vende të tjera ku japim llogari për ato që bëjmë.

— Llogari duhet të jepni para popullit, — tha me pompozitet i panjohuri. — Vetëm para popullit që ju ka zgjedhur.

Reshati vuri buzën në gaz.

— Me sa shoh unë, në mos qofsha i gabuar, juve ju rrinë të mëdha rrobat e popullit, — tha me shpoti.

— Erdha vetëm t'ju them se i kemi edhe ne dy njerëz në Tiranë, madje pikërisht në Kryeministri, i kemi. I kemi, posi. Se ju vetëm me miq e të njohur merrni vesh.

— I thatë të gjitha? Me miq të tjerë? Ku? Jo? Atëherë! Përjashta! — Reshati u çudit edhe vetë me tonin e ulur të fjalëve. — Dilni përjashta!

Burri, që me sa duket nuk e priste këtë, ose të paktën nuk e kishte pritur kaq shpejt lëshoi duart dhe në çast, sikur me lëvizjen e tyre të ishin lidhur mijëra fije të brendshme e të padukshme, u lëshua e gjithë pamja e tij. Megjithatë vazhdoi me kokëfortësi:

— Kujton se do të më heqësh qafe kaq shpejt? Nuk të ndahem unë, jo, se jam bir i popullit unë, po edhe dy miq, të thashë, i kam.

— Mbylle tani, — fjalët ranë rëndë dhe, ashtu si herë të tjera, Reshatit iu duk sikur do të lëvizte xhami i tavolinës, prandaj e mbajti me të dyja pëllëmbët të hapura përsipër.



Me sa duket pamja e tij u bë e rëndë, pasi burri u spraps një hap dhe tha, zëpaktë. kësaj radhe:

— Ju lutem, shoku kryetar!

— Përjashta! Na bën edhe kërcënime këtu. Të kesh turp, të kesh, — duart që mbanin cigaren dridheshin.

— Po unë...

— Jashtë!

Kur vuri cigaren në buzë, Reshati pa se i dridhej gjithë trupi. Nëse nga jashtë zëri kishte qenë i shtruar, brenda kishte gjëmuar. Gryka i ishte tharë papritur dhe i dukej sikur zemra i ishte ngritur lart e i trokiste te bulçitë. Hapi me të shpejtë një nga sirtarët e vegjël në të djathtë të tavolinës, poshtë telefonit, dhe mori një tabletë adulate. E përcolli me gjysmë gote ujë. Pas dhjetë-pesëmbëdhjetë minutash do të fillonte efekti i tabletës dhe ai do të ndihej më mirë. Liroi kollaren, mori një nga gazetatat dhe e shfletoi pa u përqendruar askund.

Ra telefoni, por ai nuk iu përgjigj.

Në orën 15 e 20 minuta, kur po vishte pardësynë, telefoni ra përsëri. Duke menduar se do të ishte Julia, ai u zgjat mbi tavolinë dhe kapi receptorin.

— Po, — u përgjigj pa thënë emrin.

— Jam Forja, këtu poshtë, te nëpunësi i rojës. Do të dilni t'ju pres?

— Jo. Shko ti. Ditën e mirë!

Më pas, ndërsa e shikonte trupin e madh të Fore Farashukut poshtë çadrës teksa i binte mes për mes sheshit nën një shi të shqyer nga era, ai u pendua që nuk dolën së bashku. Edhe po që se nuk ishte thelluar në çështjen e asaj shitëses, ai nuk kishte asnjë të drejtë të sillej ashtu me Foren. Le që ishin rritur bashkë, por ai vetë e kishte sjellë si përgjegjës seksioni dhe, po ta shikoje punën në këtë kënd, ai kishte të tjera detyrime ndaj Fores. Të paktën duhet ta kishte ndihmuar më shumë, ta kishte mbajtur më pranë. Edhe vizitat e Fores në shtëpi kishte nja dy javë që ishin rralluar. Mbase që thjesht një rastësi, por sidoqoftë. Reshati tundi kokën si për të shkundur që atje kushedi çfarë, por pamja përsëri iu ngrit se iu ngrit nga fundi i vetëdijes. Në një makinë. Nën një shi të pjerrët. Një dorë që zgjatej. Qimeverdhë, me pika të kuqe përsipër. Një makinë centrifuge për heqjen e mjaltit.

— Jo, — tha me zë të lartë. Mbërtheu par-dësynë, futi çantën në krah, mori çadrën dhe doli. Ora kishte kaluar nga 15 e 30-a dhe ai duhej të nxitonte që të mos bëhej vonë për në varrimin e nënës së Memliut.

## NDËRKAPITULL

(Ose parahistori)

Qyteti ishte tepër i vogël dhe Reshati me siguri do ta kishte ndier veten të huaj në një qytet tjetër më të madh. E kishte provuar dhe ia kishte dalë që me një vrap t'i binte dy herë nga lumi te Kisha pa emër, pra nga kreu në fund dhe anasjelltas. Kishte njohur pastaj brenda një kohe të shkurtër Shezaiun e tmerrshëm, shitësin e ushunjëzave, i cili, me një torbë plot me shishe gjithfarësh, trokiste derë më derë duke e hequr bran këmbën e tij të djathtë dhe një të njëjtën kohë kishte mësuar se atë këmbë, as ia kishte bënë e ëma ashtu, as e hiqte zvarrë kasten për t'u dukur edhe më i tmerrshëm, si kishte kujtuar në fillim, por e kishte qëlluar vetë me pushkë që të mos shkonte ushtar; Cen Balanin, vëllanë e vogël të policit trupmadh, Shaqir Ba-

lanit, atë që ecte nëpër rrugë përshëndëm, pa e ulur kokën të shikonte ku vinte këmbët dhe shtëpinë e të cilit e kishin qëlluar për një kohë të gjatë, netëve, xhindet me gurë, që ai të hiqte dorë nga dashuria me Zhani dentisten; Kiço Osumin, të atin e Raqi Osumit që, pasi kthehej së vrapuari nga fshati në fshat me aparatën fotografik, në vend që të ulej me fëmijët, mbyllej në një dhomë të errët, ku thoshin se fliste me hijen e së shoqes së vdekur vite të shkuara; Myrton, ndihmëskovaçin që rendte në rrugën e pluhurosur me një tog lopatash mbështetur në shpatullën e zhveshur, lakuriq nga mesi e lart dhe thërriste: «Gala-galica, ju vrau polica!» Nure Memen që, pasi kishte vënë bast se hante në një të ulur një arkë me hallvë susami, e kishte ngrënë në arkën në klubin e vogël të Met Peqinit dhe e kishin dërguar menjëherë në spital, ku thoshin se i kishin hequr stomakun dhe gjysmat e zorrëve pasi nuk kishin mundur t'ia lanin dot nga hallva; Mërgim Sporen, xhaxhanë e Hito Sporeas, të cilin, ngaqë këndonte bukur, e thërrisnin Mërgim Kënga; Ajçe Kaçakun që lëngonte prej vitesh nge dergja e thatë; me një fjalë të gjithë, derisa një ditë e njohu edhe të atin e Fore Farashukut, Simo bostanxhiun.

Ishte një ditë pazari dhe ai, së bashku me Foren, po silleshin mes grumbujve të qepëve, kosheve me rrush e mollë, të thirrurave, damixhanëve me raki, qypave me pekmez e gjizë, grumbujve të lakrave e mollëve, pulave që kakaris-

nin, rosave të varura prej këmbësh që dukeshin si të ngordhura, grerëzave që vërtiteshin mbi hoje mjalti, mbi rrush, njolla pekmezi... Mërgim Kënga, ulur në një kosh të kthyer përmbys, me xhaketën prej kadifeje të futur në njërin krah, rrethuar me burra të tjerë përqark një mangalli ku piqeshin si të harruara cironj të thatë, pinte raki dhe këndonte:

Në dy javë shkurti, të dielë në drekë,  
falu, Ajçe, falu, nga shkëmbi mos bjerë.

Ata të dy u futën mes shalëve të burrave që mbanin erë dhë dhe erë vjeshtë dhe u afruan pranë mangallit. Mërgim Kënga, pasi hoqi edhe një herë nga shishja e rakisë, vazhdoi:

Të thirri bimbashi, të thirri tri herë,  
falu, Ajçe, falu, nga shkëmbi mos bjerë,  
seç të iknë shokët, mbete vetë i tretë,  
falu, Ajçe...

Një dorë e thatë me pikla të kuqe, si e spërkatur me gjak, kapi veshin e tultë të Fores, një pëllëmbë para syve të Reshatit, dhe e tërhoqi për ta nxjerrë nga rrethi i burrave.

— Gjidisëz! Të zura, he! Ku më zabërhanit tërë ditën e perëndisë? As punë, as zanat! Gjidisëz!

— Lëshomë se vij vetë, — Fores i ishte skuqur maja e hundës.

— Të të lëshoj, hə? Të bukur mendje që më paske! Posi! Jo, or, jo, do të vish me mua. Si e ke emrin ti? Fore, hə. Do të të bëj të të thërrasin Çeço, do të të bëj!

Sytë e Fores lëvizën me shpejtësi majtas e djathtas dhe, pasi ndaluan për një çast te Reshati, u kthyen lart, drejt të atit:

— Baba, ky është Reshati. Të kam thënë që jemi shumë shokë. Ai m'u lut, se ai...

Simo bostanxhiu e lëshoi veshin e të birit dhe zgjati dorën e thatë drejt Reshatit, i cili instinktivisht u tërhoq një hap pas, jo dhe aq nga frika se mos e zinte për veshi, por nga halli i atyre piklave të kuqe. Rrudhat e panumërta në fytyrën e Simos u shtrinë si nga një dorë e padukshme dhe ai qeshi, kur tha:

— Mos ki frikë, s'ka pse të kesh frikë ti, ti je i biri i Isuf Shtërgut, apo jo?

Reshati e lejoi dorën eshtake t'i kalonte sipër flokëve.

— E ke njohur ti?

— E kush nuk e ka njohur Isuf Shtërgun? Burrë për kokë të burrit. S'bën nëna dy Isufë. Pa ejani të dy me mua tani, — dha ai u priu duke mermëritur kohë e pa kohë: — Sa mirë, sa mirë!

Reshati nuk arrinte të kuptonte ç'ishte kjo gjë kaq e mirë. E kishte parë dhe herë të tjera këtë plak në pazar pa e ditur se qenkësh i ati i Fores. Rrinte përherë në të njëjtin qoshk dhe shiste gjëra të vogla. Me një kapelë të çuditshme

rrumbullake si kapelë oficeri pa strehë, të zezë e të lerosur, brenda së cilës mblidhte flokët. Ai vinte në pazar çdo ditë, dimër e verë, dhe, atëherë kur nuk kishte për të shitur mollë, shalqirë e pjepër, fiq e kumbulla, vinte për të shitur filxhanë me piper të kuq, me farë kungulli të pjekur, tasa me turshi, lloj-lloj paketash me farëra të ndryshme qepe e sallate, spinaqi e domateje...

I shpuri te qoshku i tij i përhershëm. U dha nga një kokërr mollë.

— Jeni djem të mbarë, apo jo? — pyeti ai duke parë më shumë nga Reshati. — Ti je djalë i mirë. Më ka rrëfyer Forja që e ndihmon në mësim. Po doemos që do ta ndihmosh, me atë baba që ke pasur ti... Ai ndihmonte dynjanë, pa e vranë. — Simo bostanxhiu tundi dorën për të përzënë një tufë grerash që kishin hipur mbi hojet e mjaltit në një tenxhere të madhe. Pikat e kuqe në kurrizet e duarve të tij mund të ishin edhe pika piperi.

Ata të dy hanin mollët dhe nuk flisnin.

— Tashti, më bëni një punë?

— Ohu! — bëri Forja i pakënaqur.

— Po, — tha Reshati.

— Shumë mirë, shumë mirë, djem të mbarë! Sot do të kënaqeni. Edhe punë do të bëni, edhe do të kënaqeni duke luajtur. Do të shkoni tek Andrea...

— Bobo! — Përsëri me gomarët! — tha Forja

— Hë, do të shkoni, apo jo? — kësaj radhe plaku iu kthye Reshatit.

— Po, — tha Reshati.

Andrea ishte vëllai i madh i Fores. Në të dalë të qytetit, në këmbë të një kodre që zbardhte nga shtufi, ai kishte grumbulluar kuajt dhe gomarët e fshatarëve që kishin ardhur në pazar dhe, kundrejt një page të vogël, kujdesej për ta. Ai u dha nga dhjetë lekë për të blerë ndonjë gjë dhe u tha të shkonin të luanin, pasi kjo nuk ishte punë për ta. Mbante një këmishë të bardhë, të pahekurosur, të fryrë rreth mesit, me mëngë të përveshura. Flokët e artë dhe krela-krela, i kishte krehur me kujdes duke i hedhur lart dhe Reshatit i pëlqeu që në takimin e parë.

— Mirë mua që më ka zënë qerrja bishtin, — u tha ai. — Po ju ç'zahmet keni të rrini gjithë ditën e ditës mes erës së kuajve e të gomarëve? Shkoni të luani. Hajde, mbathjani!

Ata të dy u sollën një copë herë në pazar duke u kujdesur të mos binin në sy të plakut, blenë pistil, pastaj shkuan e dëgjuan radiopostën në radio, te klubi i vogël i Met Peqinit. Megjithatë Reshati e kishte mendjen te sheshi në të dalë të qytetit. Jeta në konvikt e kishte shkëputur para kohe nga kafshët.

U kthyen tek Andrea. Ai kishte zbritur një samar përdhe dhe, ulur mbi të, po lexonte një libër me fletë tepër të mëdha e të verdha.

— Po ju? — tha ai duke i parë me habi.

— Erdhëm.

— Ikni, or, të luani!

— Jo. Unë kam qejf, — tha Reshati duke u



skuqur. — Më mirë të lozim këtu. Na lejon?  
— Mirë. Si të doni.

Gjithë ditën luajtën duke hipur e zbritur herë në njërin kalë, herë në tjetrin. Andrea nuk e ngrinte kokën nga libri i madh. Herë pas here, pa e pasur medjen, nxirrte një krehër nga xhepi i këmishës dhe ua shkante përsipër krelave të arta.

Plaku u kthye ndaj të ngrysur. Fshatarët i kishin marrë tani kafshët dhe sheshi kishte mbetur i shkretë. Në një hejbe leshi ai kishte futur kusitë, filxhanët dhe tasat që bënë zhurmë në çdo hap. Fytyra e tij ishte e lodhur, por e gëzuar.

— Unë mbarova, — tha. — Ikim tani? — dhe iu kthye Andreas. — Sa zure sot ti?

Andrea futi dorën në xhep dhe nxori një shuk dhjetëlekëshesh. Shumë dhjetëlekëshe. Plaku i mori, lëshoi hejben në anë, u ul në bisht dhe filloi t'i numëronte duke i shtrirë mbi njërin gju. Pastaj i mbaroi, i numëroi edhe një herë, i futi në një xhep të brendshëm të xhaketës prej shajaku dhe u nis nëpër shesh. Kokulur.

— Ku po shkon ashtu? — u habit Reshati.

— Numëron sa hajvanë ka pasur Andrea sot, — e sqaroi Forja.

— Pse?

— Si «pse»? Që të mos i fshehë lekët.

— Po ku i sheh kuajt ai?

— Numëron grumbujt e bajgave.

Sytë e Reshatit sa nuk u shqyen nga habia. Andrea e shikonte të atin me indiferencë të plo-

të. Më në fund Simoja u kthye duke mërmëritur me vete:

— Gjashtëdhjetë e tetë, — tha. — Ti më ke dhënë gjashtëdhjetë e gjashtë. Po dy dhjetëshe ku i ke futur?

Andrea ngriti supet me mospërfillje.

— Unë, ç'kisha, t'i dhashë. Të tjera s'kam.

— Gjdisëz! Ke filluar të m'i fshehësh paratë. Dhe presim ne të bëjmë prokopi pastaj! Po nga ke ngjarë, more aguridhe? — dhe çapoi drejt të birit që rrinte si hu.

— Na ka dhënë të dyve nga dhjetë lekë, — u hodh Reshati.

Simo bostanxhiu mbeti me duar të ndera drejt të birit.

— Po pse nuk flet, mor hu, mor hu për të lidhur gomarët?

Andrea ngriti supet me një gjest tepër delikat.

— Harrova, — tha.

— Për të krehur s'harron, paratë na i harruake! I hedh në kë majtë e në të djathtë si alicë lumi. U dhashë unë mollë, s'ishte nevoja t'u jepje edhe para. Sa herë t'ju them që paraja e prish fëmijën?

Andrea nuk fliste. Sytë e vegjël të Simos, tani disi më të zbutur, ranë mbi Reshatin dhe atje mbetën.

— Le që mirë bëre, mirë, — tha papritur. — Sot kemi pasur edhe të birin e Isufit. Mirë bëre, mirë.

Hodhi hejben zhurmëruese krahëve dhe u nis përpara.

— Natën e mirë, — tha Reshati.

— Ku do të shkosh ti? — e pyeti plaku.

— Në konvikt.

— A, jo, jo! Sonte je nga ne. Fore, merre shokun dhe luani këmbët se na zuri nata udhëve.

— Po mua më presin atje...

— Ashtu? Të presin, the? Po qe ashtu...

— Shkoni ju, shkoni përpara, se vete unë në konvikt dhe i lajmëroj që të mos bëhen merak, — u hodh Andrea dhe, pa pritur përgjigjen e të atit, u nis drejt qytetit. Këmisha e tij e fryrë nga një ajër i çuditshëm u luhat një copë kohë duke zbardhur në muzgun e udhëve pa drita të qytetit.

Shtëpia e Fore Farashukut ishte në periferi, në atë pjesë që quhej Sheher dhe që dikur duhej të kishte qenë qendra e vërtetë e qytetit, por që tani ishte shndërruar në fshat. E ulët, e mbuluar me hardhi dhe e rrethuar me pemë e përrrenj, shtëpia ishte shumë e lagësht dhe mbante erë myk përzier me erëra mushti, frutash, ahuresh dhe kalbësire. Në oborr silleshin duke rrëmuar në tokën e butë dy derrkucë të vegjël. Në qafat e tyre ishin vënë trekëndësha dërrase, me sa duket për t'i penguar të kalonin gardhet e shumta. Copat e tokës rreth e rrotull shtëpisë ishin të punuara në çdo pëllëmbë dhe ishin mbjellë pjesë-pjesë: bostan, bizele, specat djegës, 10-15 rrënjë patëllixhanë, dy voza të mëdha me bërsi

rrushi, fasule, sallatë, marule; pas qepëve të kuqe të thurura kurorë, qepëve të bardha, të pathurura akoma, një kafazi me pula dhe pranë tij një tjetri me lepuj sykuq, vazhdonin ftonj, kumbulla, picigjata, lajthi, një sërë fshesash, spinaq, sinap, labot, tri rrënjë mollë... Çfarë nuk kishte në atë kopsht. Dhe mbi të gjitha, ndërtuar mbi katër trarë plepi, ishte një kasolle kashte e punuar me kujdes e shije. Nëpër muret e brendshme të saj ishin varur lloj-lloj fotografish shkrimtarësh dhe aktorësh me vështrim si të përrënduar, të cilat kushedi ku i kishte gjetur Andrea. Në njërën prej fotografive kishte dalë Andrea, me vështrimin e egër të tretur diku larg. Reshati iu afrua fotografisë me dyshim. Andrea duhej të kishte dalë atje 10-15 vjet më i madh nga sa ishte në të vërtetë. Të gjithë në qytet thoshin se Kiço Osumi, atje, në atë dhomën e tij të errët, bënte lloj-lloj marifetesh. Për shembull, ai dinte të të fuste fytyrën në një zemër që pikonte gjak, të të bënte që, edhe pse mund të ishte fotografuar poshtë një peme me gjethe, të dukesh sikur kishte hipur në një anije, të mbahehe pas parvazit ndërsa ajo kërcente nëpër ca dallgë të përbindshme; por Reshatit kurrë nuk ia kishte marrë mendja se ai ishte në gjendje të të fotografonte më të madh nga sa ishte në të vërtetë.

— Kur ke dalë këtu? — e pyeti një ditë Andrea që ishte shtrirë në kashtë e lexonte romanin e trashë «Bija e mallkuar».

— Ha-ha-ha, — qeshi Andrea pa harruar të shkonte dorën sipër flokëve të artë. — I ngjaj, hə?

— Pse, nuk je ti?

— Është një shkrimtar. Xhek Londoni. — Ai pa përçark dhe shtoi me zë të ulët: — Po ta them vetëm ty, unë do të bëhem shkrimtar, dhe kam për t'ia kaluar Xhekut.

Reshati filloi të shkonte shpesh e më shpesh në shtëpinë e tyre ku e prisnin gjithmonë mirë. Sidomos kur Andrea shkoi në hekurudhë si vullnetar prej nga nuk u kthye më, pasi kishte zënë punë, kundër dëshirës së të atit, në portin e Durrësit dhe kasollja u mbeti vetëm atyre të dyve. Për Reshatin ishte kënaqësi e veçantë t'i kalonte pasditet në shtëpinë e Simo bostanxhiut. Shpesh e zinte veten duke parë për një kohë të gjatë fotografinë e Xhek Londonit dhe i dukej sikur dëgjonte zërin e Andreas që e thërriste me një familjaritet për t'u pasur zili, Xhek, thjesht, Xhek, pa atë Londrën e borgjezëve nga prapa.

Kundrejt këtyre kënaqësive, ishte i detyruar ta shtonte ndihmën që i jepte Fores në mësim. Shpesh e më shpesh i bënte edhe detyrat, i shpjegonte me këmbëngulje mësimet, të cilat, me përjashtim të aritmetikës, ku me sa duket pazari e kishte shkathësuar disi, Fores i futeshin me vështirësi në kokë.

## KAPITULLI V

Djali që merrej me manovrimin e vincit kishte ndezur një zjarr me dërrasa në një prej të ndarave të apartamentit ende të pambuluar dhe, ulur mbi dy tulla të vëna sipër njëra-tjetrës, kishte zgjatur duart e holla sipër tymit. Albani po shkarkonte kovën e madhe me llaç. Qielli, ulur pothuaj mbi kokat e tyre, i mrrolët, lëvizte ngadalë, por nuk dukej se do të binte shi.

— Alban! — thirri manovruesi. — Eja merr një të ngrohur!

— Lëre të punojë, — tha vrazhdë usta Xhafa nga skela ku po vendoste tullat sipër llaçit të saposhtruar. — Ka punë puna.

— Një avaz di ti, Xhafë. Punë, punë. Ja, s'e sheh, ia pe hajrin punës ti që t'ia shohim edhe ne! — Manovruesi nxori një cigare nga xhepi i

xhupit prej pambuku dhe e vuri në buzë. Cigarja ishte shtrembëruar nga të sjellët nëpër xhepa dhe i futi në shpirt Albanit një ndjenjë inkomoditeti.

— Ia pashë që ç'ke me të, — tha Xhafa pa e kthyer kokën. — Rrita pesë fëmijë dhe jetova me nder e me faqe të bardhë.

— Të rroftë faqja e bardhë ty! Tërë jetën mbete sipër skelave.

— Hidh llaç! — tha me nervozizëm Xhafa dhe rrahu me mistri anën e govatës prej dërrase që kumboi mbytur. Albani e dinte që ky inat nuk ishte ndaj tij. Mori lopatën dhe e mbushi me llaç. Më pas, i mbushur me djersë, Albani lëshoi ngadalë lopatën, dhe shkoi pranë zjarrit.

— Kafshë! — tha nën zë manovruesi pa e hequr cigaren e shtrembëruar nga buzët e holla.

Albani nuk foli. Tjetri i zgjati një cigare, por ai i përsëriti se nuk e pinte.

— Eh, — psherëtiu duke folur si për vete djali. — Mirë të më bëhet. Isha mirë atje ku isha, por nuk më ndjenji bytha rehat. Le që se mos e kisha unë fajin! Edhe si shenjt të kisha ndenjtur, do të më flaknin se do të më flaknin. — Flokët e tij tepër të zinj e të palarë që kishin dalë nga shapka tundeshin mbi ballin e ngushtë.

— Pse, ke punuar diku tjetër, para se të vije në ndërtim? — pyeti Albani.

— Fiu! — fishkëlleu lehtë manovruesi dhe me kurrizin e dorës shtyu tufën e flokëve mbi ballë. Sapo e hoqi dorën, flokët shkuan përsëri

në vendin e tyre të mëparshëm. — Të punuar se! Isha teknik televizorësh. Kam një xhaxha në komunale. Dullën, e njeh? — Albani bëri «jo» me kokë dhe djali vazhdoi: — Ky xhaxhai më rregulloi atë vend pëllumbash. Hyr e dil nëpër shtëpi. Të ngrëna e të pira, po, paraja para, e xhepi i ngrohtë. Po më hëngri kurrizi e s'ndenja rehat. Desha të haja si ariu. Më kishte thënë xhaxhai: Ha për të ngrënë, po ha si miu. Po mua më ishte bërë syri bakër. U merrja njerëzve për një dy. Po mirë kjo, mirë, po pastaj fillova të gris edhe faturat, — ai thithi cigaren që kishte shkuar pothuajse në fund. — Le që, sido të punoja unë, do të më pushonin se do të më pushonin. Më kishte inat përgjegjësi.

— Përgjegjësi i sektorit?

— I repartit, ore, ç'sektor i thua ti? Atë e kisha futur në thes, por ai i repartit, më mblodhi ankesat e njerëzve. Ata po, gati ishin. Dëgjomë mua ti, jemi millet i keq e pikë! Po ç'do ore me punët e tjetrit? Lëre tjetrin në kismet të vet. Millet i keq e pikë! Vajti ajo punë! Po të shkanë këmbët pastaj, prit kur të të shtyjnë të gjithë, të mos të shkojë mendja se të jep tjetri dorën... Do të më kishte shpëtuar xhaxhai po të mos i kisha grisur ato faturat. E hëngra, ç't'i bësh! I bëra tetë muaj brenda.

— Burg?

— Jo po kamp pushimi, si! — ai lëshoi një të qeshur të mprehtë e të shkurtër. — Burg, po çfarë!



Albani nuk foli një copë herë. I kishte mbetur në dorë pulti i komandimit të vinçit.

— Po nuk je rregulluar keq, prapëseprapë, — tha.

— Xhaxhai, — tha. — Yti mishin ta ha, po kockat t'i ruan. Më dhe të dhashë. Sa torba kam shpënë unë në shtëpi të tij, aq të mira qofshin. S'i ra hasha, jo.

Nga e ndara pranë u dëgjua një e goditur govate.

— Llaç! Llaç!

— Tulla! — ia priti një tjetër.

Albani u ngrit. Biseda me djalin që manovronte vinçin e kishte ngathtësuar papritur. Si kishte arritur deri këtu. Rrinte e dëgjonte ç'grinte një tip i bezdisshëm.

— Ku po shkon? — pyeti djali i vinçit pa i nxjerrë duart nga xhepat e xhupit.

— Punë, — tha Albani ftohtë. As vetë nuk e kuptonte nga i kishte ardhur ajo neveri për inxhinierinë. Nuk shquhej si student, por ama edhe në fund nuk ishte. Dhe për gjithçka, a ishte fajtor i ati? Ishte e vërtetë që ai i kishte kushtuar pak kohë; që kishte pasur një besim fyes tek aftësitë e rralla të të birit; që pastaj, pas provimit ishte ftohur më tepër me të... por, mos e gjitha kjo...

Albani pothuajse me habi vuri re se diku brenda tij diçka e pengonte t'i quante gjërat me emrin e tyre.

— ... Me gjithë atë vrull që u ngrite! Po

prit, ore, mbaron puna ndonjëherë? Eh, të isha unë në vendin tënd, ia kisha bërë naftën një herë e përgjithmonë.

— Si?

— I bëja të më lëpinin këmbët. Djali i kryetarit, ma!

— Kë? — pyeti Albani pa e kontrolluar mirë veten.

— Të gjithë. Duke filluar nga drejtori, të parin.

— Alban, llaç! — thirri usta Xhafa pa qenë nevoja, pasi ai tani ishte afër skelës, — lëre nipin e Dullës ti!

— Jepi, jepi, djali i kryetarit! — tha me ironi djali nga cepi i së ndarës ku zjarri ishte shuar. Sipër prusheve hiri i bardhë ishte bërë i trashë.

— Lëre atë ti, — tha Xhafa.

Albani ndjeu tonin e veçantë me të cilin Xhafa i tha ato fjalë, por nuk kishte asnjë dëshirë për të reaguar.

Pasdreke erdhi për kontroll drejtori i ndërmarrjes. Të gjithë u mblodhën në një kthinë. Pesë minuta, kishte thënë drejtori, por foli plot gjysmë ore. Njerëzit u mërzitën nga të folurit e tij të përgjithshëm, por ai nuk e ndiente mërkitjen e tyre. Ishte një burrë babaxhan që merrte zjarr nga fjalët e veta, krijonte dialogë, pyeste dhe përgjigjej vetë. Madje, edhe zotimet që ua

kërkonte punëtorëve i merrte vetë. Albani e dëgjonte dhe i vinte për të qeshur.

— Kështu, hë, do ta mbarojmë pallatin dy javë para afatit? Do ta mbarojmë, doemos që do ta mbarojmë. E mbani mend ç'hata bëmë me mensat e punëtorëve të naftës? Si nuk e mbajmë mend, ne me duart tona i bëmë, duke i thyer të gjitha parashikimet. Keni vërejtje për përgjegjësit? Nuk keni, jo. Shumë mirë. Atëherë të gjithë në punë! — përfundoi ai.

Të gjithë u shpërndanë në punë.

— Alvar, o Alvar, dëgjoi Albani të thërrisnin pas shpinës së tij. Dikush e goditi lehtë me bërryl në ije.

— Me ty e ka, — i tha njeriu që e goditi.

— Me mua?!

Albani u kthye. Drejtori po i buzëqeshte nga larg. Manovruesi i vinçit i zgjati një cigare të cilën ai e mori pa e parë djalin në sy. Manovruesi po i pëshpëriste diçka në vesh. Fytyra e drejtorit u bë edhe më e qeshur nga fjalët e tij.

— Alvar, Alban, një lloj është, — tha ai.

— Urdhëro, — tha Albani duke iu afruar.

— Si po ia shpie me punën e re?

Albani ngriti supet.

— Mirë.

— Punon, hë, punon, punon rinia! Ti je për inxhinier, hë?

— Isha.

— E de, e! Do të shkosh prapë, ja, erdhi shtatori. — Ai i hodhi dorën mbi supe. Ndryshe

nga sa e priste, krahu i tij iu duk Albanit tepër i lehtë! — Ti kujton se na ka shkuar jeta vaj? Jo. Kemi rënë edhe ne, pa jemi ngritur përsëri. Ja, shiko këtë, — ai tregoi me dorë djalin e vicit, fytyra e të cilit ishte djallëzisht e qeshur. — A ta beson njeri që ai ka qenë në burg? S'ta beson. Punon djali, është i sjellshëm...

— Shumë, — ia priti me ironi Xhafa nga skela. Ai punonte në anën tjetër të murit, sipër të cilit i dilte vetëm koka, dhe Albanit iu duk sikur kishte diçka nga teatri i kukullave në atë ndërhyrje.

— Pse, jo? — pyeti drejtori pa e ndier ironinë e Xhafës.

Xhafa tundi kokën.

— Unë s'kam rënë, — ndërhyri Albani.

— Mos rënc kurrë, ishallah! Ti ke bërë ca inxhinieri, e kam fjalën. Sa ke bërë?

— Dy vjet.

— Mirë. Kemi një vend për teknik ndërtimi, provizor, kuptohet. Hë, si thua? Mirë, apo jo? Mirë, doemos që mirë, se ne për të mirë mendojmë.

Albanit i dogjën veshët.

— Pse nuk caktoni usta Xhafën? — tha.

— Xhafa e ka punën. Pastaj unë them për ty.

— Faleminderit! Unë jam mësuar këtu.

Drejtori ngriti supet si për të thënë: «Në qafë paç veten, mor djalë, unë të dola borxhit.» Koka e Xhafës kishte ngrirë sipër murit dhe në sfondin e turbulluar të qiellit kishte diçka prej

busti. Drejtori pa një herë cigaren duke e mbajtur me dy gishta, sikur të ishte insekt i panjohur, dhe e hodhi tutje pa e pirë deri në fund.

— Llaç! — thirri Xhafa nga ana e përtejme e murit.

Albani u fut në të ndarën tjetër dhe filloi të hidhte llaç në govatë. Ai ende nuk e kishte lëshuar lopatën, kur ustai ia priti nga lart:

— Tulla!

Pa thënë asnjë fjalë, Albani veshi dorezat e gomuara.

— Është burrë i mirë Reshat Zagora, — tha Xhafa kur në një çast kokat e tyre u afruan, ai duke marrë llaç me mistri, Albani duke lëshuar tullat mbi skelë.

— Urdhëro? — pyeti Albani, jo aq ngaqë nuk dëgjoi sesa ngaqë nuk ia kishte marrë mendja që Xhafa të bënte deklarata të tilla. Ai përgjithësisht i shmangej dhënies së konsideratave të prera.

— Vetëm se të birin e ka viç, — shtoi usta Xhafa dhe qeshi.

Qeshi edhe Albani. Me mundim vërtet, por qeshi.

Ishte bërë terr kur Albani telefonoi në shtëpinë e Irmës. Ajo kishte një sesion provimi dhe kishte ardhur atë ditë të mësonte në shtëpi. E lanë të takoheshin te kioska ku shiteshin lulemisri.

Ajo kishte veshur pulovrin jeshil dhe sipër tij një xhakavento ngjyrë të mbyllur që ai nuk ia kishte parë herë tjetër dhe që i shkonte shumë me tonet e kuqërremta të flokëve.

— Ku do të shkojmë? — pyeti ajo.

— Shkojmë në ndonjë lokal, — tha Albani.  
— Kam marrë rrogën.

— I mban të gjitha lekët?

— Jo të gjitha, por, sidoqoftë, kam.

Para dy muajsh, kur ai kishte marrë rrogën e parë, ata ishin grindur përsëri me të atin. Më shumë sesa grindje kishte qenë një acarim i mëtejshëm. Albani kishte lënë mbi tavolinë njëqind e pesëdhjetë lekë. Ç'janë këto?, e kishte pyetur i ati. Ai kishte thënë që ishte rroga. Kaq more? Epo nuk kemi të gjithë rroga kryetarësh, ia kishte pritur ai. I ati ishte përtypur, por nuk e kishte kapërdirë dot deri në fund inatin.

— Shkojmë? — pyeti Albani me zë të ndryshuar.

— Mos na shohin.

— Më mirë të na shohin në një lokal se duke u fshehur hijeve. Apo jo? Në fund të fundit, ç'rëndësi ka?

Shkruan në një lokal të periferisë që ishte pothuajse bosh. Pinë nga një ponç portokalli, të cilin Irma nuk e çoi dot deri në fund. Në fillim, kur panë nga xhamat e mëdhenj se lokali ishte pothuajse bosh, Albani mendoi se atje do të ndiheshin qetë dhe do të mundnin të qëndronin gjatë, por pastaj, pas fjalëve të para, kuptoi se nuk

ishte ashtu. Boshllëku i lokalit i kishte vënë pikërisht në qendër të vëmendjes së të pranishmëve. Kamerierja e shëndoshë, banakieri që nuk e hiqte cigaren nga buzët dhe dy të moshuar që rrinin në një tavolinë të anës me duart të kryqëzuara në prehër, nuk ua ndanë sytë gjatë gjithë kohës. Fjalët u rralluan dhe shpejt u bë një heshtje që Albani pothuajse e ndiente t'i rëndonte mbi supe. Do të kishte qenë krejt ndryshe sikur lokali të kishte qenë plot. Pak a shumë ishte ai ndryshim që ndien njeriu kur del me një vajzë në një qytet të madh ku askush nuk e njeh dhe në një qytet të vogël ku e njohin të gjithë.

Ia tha këto Irmës pothuajse me mundim.

— Sonte s'të marrkam dot vesh, — tha Irma dhe tundja e kokës bëri që të luhateshin butë hijet poshtë mollëzave të faqeve.

— S'ka rëndësi, — tha Albani nën zë. — S'ka rëndësi në më kupton apo jo, rëndësi ka të mië ndiesh.

Irma nënqeshi hollë, për të përmbajtur një kundërshtim të dytë.

Biseda, e mbajtur gjallë me zor deri atë çast, u fashit shpejt.

— Dalim, — tha Albani, por nuk u ngrit.

Gota e ponçit, e pirë përgjysmë, dukej sikur digjej mes tyre. Shkëlqimi i nikeliteve të shumta të banakut, i ftohtë, dukej sikur nga çasti në çast do të sulej egërsisht mbi heshtjen. Ca ngulçe të befta po i grumbulloheshin brenda kraharorit.

— Dalim, — përsëriti dhe lëshoi lekët mbi tavolinë.

Irma ngriti supet mbi tavolinë.

Dolën, por heshtja i ndoqi edhe disa dhjetëra hapa. Me sa duket atje brenda sulmi i nikeliteve do të kishte filluar. Dritat po rralloheshin.

Dikur ai i hodhi krahun në qafë dhe gati me mundim, sikur donte të mposhte një ftohtësi të pakuptim, i mërmëriti në vesh se ajo ishte shumë e bukur, jashtëzakonisht e bukur.

— Ti je gënjeshtar dhe i çmendur, — tha Irma.

Duke iu marrë këmbët, ecën drejt lagjes së re.

— Ku po më çon kështu? — pyeti dikur Irma. Kishte më shumë se dhjetë hapa që kishte dalë nga asfalti dhe tani toka poshtë këmbëve të tyre ishte bërë përfundimisht e paqëndrueshme.

— Eja! — foli përsëri me gulçime Albani dhe e puthi diku mes veshit dhe mjekrës.

— Alban!

— Ke besim tek unë?

— Sa i marrë që je! Sigurisht që kam!

— Atëherë ec, tha Shën Pjetri dhe zgjati duart e tij...

— Ku po shkojmë? — Toka poshtë këmbëve të saj luhatej.

— Eja! Ti akoma nuk ke qenë asnjëherë në vendin tim të punës.

Ajo nuk foli. Dritat tani ishin larguar përfundimisht. Grumbujt e gëlqeres zbardhnin nëpër



terrini e turbullt. Irma më në fund arriti të mban-  
te këmbët.

— Alban, në një pallat të pambaruar?

— Pse nuk e dije ti që të dashuruarit janë  
banorët e parë të pallatave të reja? Ja, do ta  
mësosh sonte.

Pas pak, pasi u ngjitën me mundim në shka-  
llët ende të pambaruara, ata ndodheshin në kthi-  
nat e katit të sipërm, pa çati mbi kokë. Irma  
merrte frymë me vështirësi. Dëgjohej fishkëllima  
e erës së ftohtë e të lagësht. Mbi det shndrisnin  
mbytur vetëtima të shkurtra e të kuqe.

— Këtu punon ti?

— Po.

— Qenka ftohtë, — tha ajo dhe u mbështoll  
me xhakavento.

— Ftohtë dhe bukur.

Në qiell, të ndriçuara nga hëna që ndodhej  
mes tyre, shtegtonin re të trasha pllanga-pllanga.

— Ftohtë, — përsëriti ajo dhe u mbështet  
më fort pas tij. Ai i futi duart poshtë xhaka-  
ventos. Pastaj, poshtë pulovrit të saj të butë.  
Buzët e saj digjnin. Ranë dy-tri dërrasa. Qielli u  
ça për t'i mbyllur përfundimisht poshtë një terri  
të butë e të njomësht...

— Do të ketë shkuar vonë, — tha ajo dikur.

— Nuk paska shkuar ende tetë, — tha Al-  
bani duke u përpjekur të shikonte sahatin e do-  
rës. — Tani erret shumë shpejt.

Irma po shkundte rrobat.

— Sa të janë ashpërsuar duart, — tha ajo.

— Klasë punëtore, — ia ktheu Albani.

— Ikim.

— Do të mësosh?

— Për sonte e mori dreqi të mësuarën.

— Më fal! — tha Albani me një sinqeritet të panevojshëm.

— S'di ç'flet! Je bërë fare budalla!

— Mirë. Ikim.

Pastaj, ndërsa ecnin në heshtje nëpër shkallë duke u mbajtur te njëri-tjetri, Albani pati një dëshirë të papërmbajtur për të thirrur. Jo për të thënë diçka të përcaktuar, po ashtu, kot, sa për të mbushur boshllëkun e korridoreve, anekseve, kuzhinave dhe të gjithfarë kthinash të tjera me një zë njerëzor. Dhe iu kujtuan mura-torët që bërtisnin sipër skelave duke imituar lloj-lloj kafshësh e zogjsh.

Ia tregoi Irmës.

— Pse e bëjnë këtë? — pyeti ajo.

— Pa di unë? Mbase sepse nuk e durojnë dot zbrazësinë e apartamenteve. Pasi ke punuar për një kohë të gjatë në ndërtim, boshllëku i shtëpive duhet të të duket i tmerrshëm, — tha mendueshëm dhe përsëri pati tundimin të thërriste, por buzët e Irmës nuk e lejuan.

Kur dolën në trotuar, rrugët ishin shkretuar. Era vazhdonte të frynte nga deti e rënduar në të kuq vetëtimash dhe lagështi. Edhe një makinë që kaloi në bulevard kishte diçka prej ur-

gjencave. Alarmi i saj i kotë u dëgjua edhe një copë herë pasi ishte zhdukur pas kthesës te kino-klub «Rinia». Drita nëpër dritaret e apartamenteve ishte e ngrohtë dhe si e veshur me avull.

— Ke shkruar gjë? — e pyeti Irma te hyrja e apartamentit të saj para se të ndaheshin.

— Diçka.

— Poezi?

— Jo. Një gjë në prozë.

— Tregim?

— Një parabolë. Diçka për hijet, domethënë, si të ta them, — ai e kuptoi se e kishte të vështirë të shpjegohej. — Nuk e kam mbaruar ende, — tha pas pak.

— Atëherë qenka e gjatë.

— Jo. Do të takohemi nesër?

— Më telefono.

E puthura e fundit ishte e shkurtër.

## NJERËZIT PA HIJE

Vazhdim

Ata që nuk e vuanin mallkimin e hijeve ishin fëmijët. Ata hynin e dilnin në hijet e njëri-tjetrit pa frikë, ashtu siç kishin hyrë gjithmonë. Megjithatë, kronikani mjekërbardhë Jani VI Kantakuzeni (ish-domestiku i madh, tani i përzënë nga Jani V Paleologu dhe i fshehur nën emrin e murgut shëtitës Joasëf), pa një grumbull fëmijësh që zhvillonin një lojë të paluajtur më parë: fëmijët vraponin tinëzisht rreth njëri-tjetrit dhe në një çast, gjithë po aq tinëzisht, shkelnin hijen e shokut me këmbët e holla që dilnin poshtë fustaneve të ashpra prej kërpi. Kështu hijeshkeluri quhej i plagosur dhe, po qe se i shkelnin hijen e kokës, quhej i vdekur dhe nxirrej jashtë loje.

Jani VI Kantakuzeni, alias murgu Joasef, iku i menduar drejt manastirit të Ujëbardhës duke thartuar trutë në duhej ta shkruante këtë lojë në fletët e kronikave të tij.

Dhe doemos nuk do ta kishte shkruar, sikur pas disa ditësh, në pazar, mes fjalëve sharëse që dy të dehur i hidhnin njëri-tjetrit, të mos dëgjonte një mallkim të padëgjuar. «Të shkelsha hijen!», i tha qimeverdhi kokëvoglit dhe kokëvogli befas pushoi. E quajti veten të mundur. Uli kokën e iku nën vështrimin përbuzës të të pranishmëve. Pastaj kjo u përsërit edhe herë të tjera. Ndodhte kështu: Njeriu, pasi e shante tjetrin me nënë e me babë, me truall e kasolle, me të gjallë e me të vdekur, duke shpërndarë përqark një shndritje të ligë sysh e dhëmbësh, lëshonte mallkimin:

— Të shkelsha hijen!

## KAPITULLI VI

Memliu i kishte lënë mbi tavolinë një shënim ku i njoftonte se inaugurimi i muzeut të ri historik të rrethit bëhej atë ditë në orën 10.00. Pranë ishte edhe një fletëpagesë telegramesh, si dhe një resto e vogël. Ishte kusuri i mbetur nga pagesa që duhet të kishte bërë atë mëngjes Memliu për telegramin, me anë të të cilit Reshati i uronte ditëlindjen një shkrimtari të njohur. I futi lekët pa i numëruar në xhep dhe mori në dorë ftesën e dërguar nga drejtorja e muzeve. Emri i tij ishte shkruar me shkronja të mëdha kapitale në ngjyrë të zezë dhe spikaste në rrafshin tepër të lëmuar të ftesës. Dikur revoltuhej sa herë vinte re një përkujdesje jo të zakonshme për emrin e tij, por vitet kishin kaluar dhe bash-

kë me to ishte ftohur edhe dëshira e tij për t'u revoltuar për gjëra të tilla të parëndësishme.

Sabriu kishte shkuar në garazh për t'i bërë shërbim makinës që diçka duhet të kishte pësuar pas tri ditësh endjesh nëpër baltën e fshat-rave, dhe ai mendoi se duhej të shkonte në këmbë deri në anën tjetër të qytetit ku ishte ndër-tuar muzeu. Po mund të shkonte edhe me sek-retaren e Komitetit, Greta Tytymçen. Sado që njohja e tyre ishte e vjetër, qysh atëherë kur Greta kishte punuar në një shkollë me të sho-gen, Julinë, ai më shpesh u shmangej kontakteve me të. Atëherë ata sapo ishin martuar, ende nuk kishin marrë shtëpi në qytet dhe, kur Reshati shkonte në fshatin ku ato punonin, Greta ishte e detyruar të lëshonte shtratin e saj. Nganjë-herë, kur i shqyrtonte kalimthi marrëdhëniet e tij me Gretën, ai mendonte se mbase ishte ka-rakteri i prerë i Gretës, e cila edhe ngaqë e njihte prej kohësh e depërtonte tejprtej Reshatin. Por ai përgjithësisht i shmangej një analize të plotë të marrëdhënieve të tyre.

Sidoqoftë, në inaugurimin e muzeut mund të shkonte me Gretën, e cila duhet të merrte pje-së si sekretare që ishte. Krijoi numrin e telefo-nit të saj, por nuk iu përgjigjën. Pyeti te nëpu-nësi i rojës dhe i thanë se Greta Tytymçja kishte më shumë se gjysmë ore që kishte shkuar nga muzeu.

Megjithëse janar, pas pushimit të erës që ki-shte fryrë si e tërbuar gjatë gjithë natës, me

qartësinë dhe qetësinë e saj, dita kishte diçka monumentale. Tamam një ditë muzeale, mendoj Reshati buzagaz ndërsa vishte pallton e rëndë kafe. Donte edhe tre çerek ore që të bëhej inaugurimi.

Muzeu i ri ishte i ulët, por fasada e tij, kolonadat e veshura me mermer, një tarracë gjithashtu e ulët ku ishin ekspozuar në natyrë monumente të gjymtuara të lashtësisë, parku përpara tij ku ishin sjellë pemë dekorative dhe kodra në sfond i jepnin një pamje solide. Muzeu dukej sikur thoshte që larg: Mos më gjykoni keq për krenarinë që shpall, por ajo ç'ka them e shpall unë nuk është asgjë para asaj që mbaj poshtë vetes, thellë në tokë, sepse historinë, më mirë se çdo muze, e tregon toka.

Me siguri duhet të kishte ndikuar koha e bukur që mendonte gjëra të tilla. Mori kthesën tek ura me parmakë hekurash.

Një burrë i thinjur, i thatë dhe me syze me rrrathë briri, veshur me kostum të errët, u shkëput nga grumbulli i vogël i njerëzve që ishin mbledhur te porta e rëndë dhe shpejtoi t'i dilte përpara. Ishte drejtori i muzeve, Mersin Kënga, vëllai i vogël i këngëtarit të njohur, Mërgim Këngës.

— Kush ka ardhur nga Akademia? — pyeti Reshati pasi i shtrënguan dorën njëri-tjetrit.

Mersin Kënga tha emrin e padëgjuar të një studiuesi dhe, kur pa se fytyra e Reshatit u tkur, e quajti me vend të shtonte se i ardhuri ishte kandidat i shkencave historike.



Reshati tundi kokën dhe u afrua pa folur për të takuar njerëzit e tjerë. Pak më tej, në shkallët e gjera dhe të ulëta të parkut të sapokrijuar ishin ulur një grumbull punëtorësh të veshur me xhupa pambuku. Me sa duket ishin të ndërmarrjes së ndërtimit, sepse në mes tyre dalloi Albanin. Disa prej tyre pinin cigare dhe ai, nga vendi ku ishte, nuk mund të shikonte nëse Albani e kishte ndezur apo jo. Po, tekefundit, ç'rëndësi kishte kjo? E gjithë puna ishte se në marrëdhëniet e tyre diçka ishte thyer dhe, për të liruar veten nga përgjegjësia për këtë thyerje, Reshati i kishte dhënë më shumë rëndësi nga sa kishte në të vërtetë një çështjeje dytësore, zhvillimi dhe mbajtja gjallë e së cilës i siguronte, sidoqoftë, pozitë sunduese.

— E shohim një herë ndërtesën përçark? — tha Reshati duke parë më shumë nga kandidati i shkencave. — Kemi kohë derisa të shkojë ora dhjetë.

Kandidati i shkencave tundi kokën në she një miratimi. Lëvizën të gjithë si grumbull nëpër udhëzën ku pllakat prej betoni imitonin rrasa guri të vendosura si rastësisht mes barit duke folur ulët secili me shokun që iu ndodh pranë. Me bisht të syrit Reshati shikonte të dërguarin e Akademisë. Ishte tepër i ri, mbante një palë syze që dukeshin sikur i shkaktonin dhimbje sysh. Flokët e gjatë të krehur lart, me tundjet që pësonin në çdo hap, i jepnin pamjes së tij diçka prej tuhafi dhe, sikur të mos ishte ai vezullim i

zgjuar sysh pas xhamave gjysmë të errët të syzeve fotokromatike, ai do ta kishte besuar që i ardhuri ishte me të vërtetë tuhaf.

Sapo dolën në pjesën e pasme të muzeut, pothuajse të gjithë mbetën duke parë ndërtesën gjysmë të rrënuar të Kishës pa Emër. Mbi mure kishte mbirë bar. Kodra pas saj dukej tmerrësisht e vjetër.

— Kot nuk e zhdukëm këtë rrënojë, — tha me pasion një mësues historie, pjesëtar i bërthamës shkencore të historianëve të qytetit, duke parë nga Reshati.

— Ashtu është, — miratoi Greta Tytymcja. — E prish gjithë pamjen e muzeut.

— Ah, jo, jo, — u hodh me një energji të paparashikuar kandidati i shkencave. — Përkundrazi. Ajo ndërtesë me vlerat historike dhe rrënimin e saj, sidomos rrënimin, ia shton vlerat muzeut.

— Të ishte të paktën e përfunduar, — shtoi dikush nga grumbulli. — Nga themelet duket se kishte për t'u bërë një ndërtesë për të qenë.

Kandidati i shkencave bëri një lëvizje të vrullshme e të pakontrolluar të duarve, duke e kapur veten, rregulloi pa qenë nevoja syzet. Fytyra po i skuqej.

— Ajo kishë lidhet me një pjesë tepër të vrullshme të historisë së kombit tonë, — tha ai duke u përpyetur më kot të përmbante pasionet, — me periudhën e luftërave për Shpalljen e Pavarësisë. Vetëm se, — ai bëri një grimasë iro-

nike, — vetëm se në anën e kundërt të këtyre lëvizjeve, me luftën e pretendentëve për fronin shqiptar, i cili nuk ekzistonte ende.

— Ecim, — e ndërpreu Reshati dhe i futi krahun. — Po shkon ora për përrurimin.

Pastaj, ndërsa shikonin stendat ku ekspozohet ishin vendosur nën një ndriçim tepër të mprehtë, objektet dhe dhomat e periudhave të ndryshme historike, kandidati i shkencave i kishte treguar copa-copa historinë e Kishës pa Emër dhe të luftës së ngatërruar për fronin, e cila tani, e larguar në kohë, tingëllonte absurde.

Fill pas Revolucionit Xhonturk të 1908-s, krahas rritjes e fuqizimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, mori krah edhe aspirata e një sërë pinjollësh të familjeve mbretërore të Evropës për t'u ulur në fronin fantazmë të Shqipërisë. Duka i Abruces (Abruzzo), markezi Auletës, princi danez Aksel, princi gjerman Vyrtemberg (Von Wurtemberg), princi francez Viktor Napoloni dhe duka i Monpasiesë (Monpensier), princi tjetër gjerman Fon Urah (Urach), princat turq Jusuf Izedin dhe Abdyl Mexhite, egjiptianët, princa edhe këta, Ahmet Fuad dhe Omar Tosun e deri te lordi anglez Kitçner (Keetchner) e ngritën secili në hesap të vet fronin e tyre ëndërror në truallin e lashtë të Shqipërisë ekzotike. Kërkonin përkrahje, kontakte të njëpasnjëshme, leje kancelore, bënin krushqi me interes, kontratonin; futeshin marrëzisht në borxhe që nuk do të mundnin t'i lanin kurrë, ndiqnin si në ethe oroskopet

e fiseve, mësonin fjalë e shprehje të popullit që shpresonin ta mbretëronin, shtireshin sikur habiteshin me ndërlikimin e frazeologjizmave të tij, me muzikën e tij të përcudnuar nga orkestra endacake, kërkonin në mënyrë të panjerëzishme njerëzillëk nga rivalët, ngrinin pemët gjenealogjike të familjeve të tyre dhe hajdutërisht i shtrinin rrënjët e këtyre pemëve deri te kryezotët e moçëm e dinjitarë të Arbërisë, porosisnin vula, të cilat i ruanin në arka të thella. Froni i paqenë i Shqipërisë kishte krijuar rreth vetes një vorbull të paparë ethesh për pushtet. Dhe në këtë vorbull, mbase në mesin e saj, ishte futur edhe gjashtëmbëdhjetëvjeçari energjik, spanjolli Juan de Aladro Perez de Valasko. Ai u shpejtua të shpallte farefisninë e tij me kryezotin më të madh të Arbërisë, Gjergj Kastriotin. Vuri kandidaturën për fron. U vetëshpall princ. Bëri kartolina të kushtueshme me fotografinë e tij. Poshtë tyre emrin Juan e shndërroi në Gjin dhe Aladro në Kastriot, sipas kushedi ç'rregullash të panjohura të gramatikës historike. Ndërmori udhëtime në trevat periferike të Shqipërisë. Botoi deklarata të bujshme se kandidati tjetër, rumuni Albert Gjika, ishte sharlatan. Gjetei përkrahje te Faik Konica, dhe, sikur të varej problemi i fronit nga gjëra të tilla, vendosi të ndërtonte në Shqipëri një kishë, një xhami dhe një shkollë. Kisha ishte pikërisht kjo që thirrej Kisha pa Emër. Ajo kishte filluar të ndërtohej nga ca ustallarë të panjohur në verën e vitit 1911, por, pa filluar mirë

vjeshta, ustallarët ikën. Vrulli i kryengritjeve të mëdha popullore kishte krijuar një tym, përmes të cilit mjeshtrit e panjohur, xhepafryrë nga fondet e përvetësuar, mund të fshiheshin ose të shtireshin si të zhdukur.

Kandidati i shkencave e kishte mbaruar historinë, të cilën kishte qenë i detyruar ta ndërpriste shpesh, në dhomën e pritjes të kafes së vogël të Komitetit të Partisë të Rrethit.

— Prandaj, — përfundoi ai me sytë që tani sikur ishin qetësuar, — prandaj thashë pak më parë se ajo ndërtesë ia shton bukurinë muzeut të ri.

Kandidati i shkencave mori përhumtazi një cigare, e vuri në buzë, e ndezi në flakën e çakmakut të Mersin Këngës, u koll, u kujtua për diçka, pa përqark me habi, sikur e kishin futur përdhunshëm në një vend të ndaluar, dhe e fiku menjëherë cigaren duke e shtypur me gishtat që i dridheshin në taketuken e praruar. Pastaj, duke u përpjekur më kot të buzëqeshte, e gjeti me vend të sqaronte se e kishte lënë duhanin para një viti.

Pas gjysmë ore, duke provuar një ndjenjë teprie energjish që i dukej sikur ia kishte induktuar kandidati i shkencave, Reshati gjendej në zyrë.

Ora ishte 12 e 35 minuta kur u hap dera dhe në të ndarën mes saj dhe murit të lyer në ngjy-

rë kanarine, u duk koka e Natale Balanit. Diçka kishte ndryshuar në pamjen e saj dhe Reshatit iu desh njëfarë kohe derisa e kuptoi se ishte frizura e flokëve. Të prerë pothuajse shkurt, ajo i kishte kthyer fundet e tyre nga brenda, duke zbuluar një pjesë të qafës. Sikur të mos i mjaftonte bukuria që e kishte shoqëruar që nga lindja, Natale Balani i kushtonte shumë kujdes vetes.

Qëndroi pa folur, e ndërgjegjshme që po e sodisnin. Reshati tani ia njihte këtë zakon koke-tërie që i ngjante një loje. Pa dyshim, ajo dinte t'i bënte burrat ta shikonin.

— Po? — tha ai dhe u mbështet me gjithë shpatullat në shpinoren e lartë të kolltukut.

— Jeni lodhur?

Reshati buzëqeshi.

— Besoj se nuk keni ardhur deri këtu për të bërë këtë pyetje, — tha ai. — Apo ka ndonjë kolonë në ato evidencat tuaja të planit «Lodhja e shokëve drejtues»?

— Unë thashë kot, por nuk do të ishte keq të kishte edhe kolona të tilla.

— Urdhëro, — tha. — Ç'kishe?

— Asgjë, — ajo nuk u fut brenda. — Vetëm desha të di nëse do të jeni i lirë sonte, — dhe, duke ndier mundësinë e keqkuptimit, shtoi me të shpejtë: — Kemi për të shkuar për vizitë kolektive tek Ollga Çoba.

— Pse? Mos i ka gjetur më në fund dhembët?

Natale Balani qeshi shpengueshëm, por lehtë.

— Jo, — tha. — I ka ardhur djali nga ushtria, ka më shumë se një muaj. Do të vini?

— Në ç'orë?

— Në gjashtë.

Ai i hodhi një vështrim të shpejtë kalendarit të tavolinës, ku shënonte punët urgjente të ditës.

— Po, — u përgjigj. — Jam i lirë. Po, mos bëhemi shumë veta? Ka shtëpi që na nxe ne të gjithë?

Natale Balani u tërhoq një gjysmë hapi të vogël dhe sqaroi se do të shkonin vetëm shokët e Komitetit Profesional. Ai do të vinte si titullar.

— Mirë, — tha Reshati.

Natale Balani doli dhe u duk sikur zyrës së madhe i kishte ikur diçka. Ndoshta jo e domosdoshme, por, sidoqoftë, e nevojshme.

Reshati u ngrit dhe shkoi te dritaret. Poshtë, në shesh, Fore Farashuku po bisedonte me dy të panjohur. Pas tyre ishte një makinë me targën e Tiranës, shoferi i së cilës, me një pozë pritjeje, kishte hapur derën dhe rrinte me njërën këmbë në asfalt. Këmba e tij ishte tepër e vogël. Edhe pse punët në sektorin e tregtisë nuk shkonin mirë, Fore Farashuku kishte krijuar lidhje të ngushta me drejtuesit. Reshati e shikonte se si përpiqej t'i fuste krahun njërit prej të ardhurve, me sa duket për t'i çuar në klub.

Ç'ishte bërë vallë me atë shitësen, Domenika Danin? U bë kaq kohë që nuk ishte marrë me

të. Mund ta thërriste Foren me anë të nëpunësit të rojës. Po ndoshta nesër, e shtyu me vete dhe se pse provoi një lloj djegieje në gjoks, një djegie të vjetër, e cila, për t'u shuar, i mblodhi të gjitha lëngjet e trupit duke bërë t'i thaheshin buzët.

Ra zilja e telefonit. Ndërsa shkonte drejt tij, ai lëpiu buzët dhe e detyroi veten të mendonte se duhet t'i telefononte Julisë që të bëhej gati për vizitën që do të bënte tek Ollga Çoba atë mbrëmje.

Ishte sekretari i parë.

U hap dera e zyrës së ndihmësit dhe Memliu, pasi e mbylli me kujdes pas vetes, tha, kushedi pse, me zë të ulët:

— Ka ardhur Raqi Osumi.

— Kush? — pyeti Reshati. Ai ende po mendonte për bisedën që kishte pasur me sekretarin e parë dhe nuk e kuptoi menjëherë Memliun.

— Ish-nëndrejtori i ushqimores. T'i them se jeni i zënë dhe nuk mund ta prisni?

— Jo, jam i lirë. Pse? I thoni të vijë.

Memliu ngriti supet si për të thënë: Unë për të mirën tuaj e kisha.

— Duket i nxehur, — tha pastaj.

— Pavarësisht. Të vijë si të jetë.

Hamendja e Reshatit se letrën anonime kundër Raqi Osumit e kishte shkruar vetë Raqi Osumi ishte vërtetuar para disa javësh. Vetë Raqi



e kishte pranuar. Në të njëjtën kohë ekipi i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit kishte pasur një varg vërejtjesh për punën e nëndrejtorit, sidomos për sa i përket natyrës së tij prej karrieristi, gjë që kishte bërë që në drejtim të krijoheshin grupazhe, përçarje dhe grindje të panevojshme. Ishte vënë menjëherë në dijeni Komiteti i Partisë. Letra e tij anonime drejtuar kundër vetes kalonte gojë më gojë mes anëtarëve të ekipeve.

Dera trokiti.

— Hyr! — tha me zë të ulët Reshati.

Raqi Osumi hyri vrulltas në zyrë, me fytyrë tepër serioze duke shpërndarë përqark një ajër të acaruar pakënaqësie dhe dinjiteti të marrë nëpër këmbë. Flokët e ashpër, të prerë shkurt, i jepnin pamjes së tij diçka prej oficeri. Në ç'fotografi të bërë nga i ati do ta kishte kopjuar vallë këtë pozë?, i vetëtiu Reshatit nëpër mend dhe e përmbajti me zor të qeshurën.

— Kam ardhur, shoku Reshat, tepër i indignuar, — filloi të thoshte Raqi Osumi me krahët të ngritur anash. — Jo si vartësi te kryetari i komitetit, por si burri te burri. Të më presësh të ardhmen, të më lirosh nga detyra, të më plagosësh në krenarinë time pa m'i thënë përpara dy fjalë si shok, si bashkëkonvikt, si bashkëqytetar? Nuk e prisja nga ju, të them të drejtën.

— Ngadalë, Raqi, ngadalë, — tha Reshati duke u ulur në një prej kolltukëve të anës. — Ulu një herë!

— Por tjetri nuk dëgjoji të ulej dhe vazhdoi të fliste në këmbë:

— Si i harruat menjëherë meritat e mia? Unë, bir i Partisë, i rritur në shtëpinë e fëmijëve, bir i një fotografi të varfër, të cilin e treti veremi për këtë popull. Nga varfëria më la në shtëpinë e fëmijës. Partia më dha dorën... Dorën them? Partia më dha bukën dhe ujin, më dha dritën e syve, më dha shkollën dhe ja, na del dikush, që, duke marrë një masë kundër meje, do të më armiqësojë me Partinë, — Reshati vuri re se sytë e Raqi Osumit po përskuqeshin anash.

— Si? Si?! — nuk po u besonte veshëve ai.

— Po, po, — këmbënguli Raqi Osumi duke e besuar se po godiste në shenjë, — të më armiqësoni me Partinë. Po armiqësohet, vallë, njeriu me nënën e vet? Kurrë! Le të më hidhni në cilindo llum që të doni, unë nuk do të bie në grackën që më keni ngritur, kurrsesi. Sepse unë e di që Partia nuk mund të identifikohet me këtë apo atë person, unë di ta dalloj Partinë nga ai apo nga ju, — ai i mëshoi zërit në mënyrë të veçantë të fjalëza e fundit, — dhe ju nuk do t'ia arrini kurrë të më armiqësoni me të.

Tani sytë e tij ishin përgjakur përfundimisht. Deklaratat ndoqën njëra-tjetrën dhe, kur mendoi se ato kishin mbaruar, më i qetë nga sa e priste, Reshati tha:

— Mbarove?

Pyetja dhe sidomos ftohtësia e zërit të Reshatit e befaskan Raqi Osumin.

— Jo, nuk kam mbaruar, — tha ai vrulltazi, më tepër thjesht për kundërveprim, por me sa duket nuk dinte ç'të shtonte më dhe heshti.

— Tani ulu këtu! — Reshati i tregoi kolltukun pranë vetes dhe kësaj radhe Raqi nuk kundërshtoi.

Raqi nxori një cigare dhe e ndezi me çakmakun që i zgjati Reshati. Edhe duart i ishin skuqur.

— Tani më thuaj edhe një herë: përse ke ardhur?

— Jua thashë dhe më duket se fola qartë, — megjithëse toni i të folurit të tij ishte ulur, fjalët vazhdonin të ishin të mëdha e të fryra në modelin e të folurit të mëparshëm.

— Asgjë nuk kuptova. Përse ke ardhur? Që të më thuash se je i indinjuar për masën që u mor ndaj teje?

— Edhe për këtë.

— Kjo pritej. Tani, kush qenka ai që dashka të të armiqësojë ty me Partinë? Unë?

— Nuk thashë, por...

— The. Megjithatë unë tani jam mësuar të mos dëgjoj kur thuhet budallallëqe të pape-shuara.

— Ju lutem.

— Hiç mos m'u lut. E di si është puna jote, Raqi? Ti je djalë që më kanë thënë se lexon. Ti je karrierist, por nuk je budalla.

— Unë nuk lejoj që të shkelet mbi dinjitetin tim.

— Unë të dëgjova, tani është radha jote të më dëgjosh mua... Përkundrazi, pra nuk je budalla, po je dinak dhe arrivist. Mirëpo, pikërisht këtë nuk ke parashikuar ti, që edhe dinakëria nganjëherë bëhet shkak që të biesh brenda... Ka Lenini një vend ku bën fjalë për një armik të tërbuar të pushtetit sovjetik dhe thotë se ai, ndryshe nga armiqtë e tjerë, ka rënë pre e dinakërisë së vet. Dhe me këtë rast bën analogjinë me dhelprën dhe gjahun e dhelprave. Besoj se të ka rënë rasti ta lexosh. — Raqi Osumi nuk reagoi dhe Reshati vazhdoi: — Vendi ku është fshehur dhelpra rrethohet përçark me një fije pe ngritur në shkopinj të shkurtër. Peri i kuq dallohet në dëborë. Lihet vetëm një shteg i hapur ku presin me pushkët ngritur gjahtarët, të cilët, duke mos qenë shumë, nuk kanë mundur ta rrethojnë të gjithë vendin. Atëherë çohet dhelpra. Ajo, duke ndjekur fillin e perit, mendon, ndryshe nga ariu, ta zëmë, i cili do ta kishte kaluar perin në çfarëdo vendi, pa e vrarë mendjen, pra ajo mendon se, përderisa është ngritur një pe, kjo do të thotë se këtu ka gisht njeriu, pra armiku i saj. Atëherë, duke ndjekur fillin e perit, shkon deri te shtegu i hapur. Këtu është shpëtimi im, mendon me vete dhe futet nëpër të. Atje e presin gjahtarët, të cilët i marrin lëkurën. Kështu pak a shumë të ndodhi dhe ty. Ti nuk dole drejtpërsëdrejti të thuash: më bëni mua drejtor, por bëre një letër anonime. Mirëpo edhe letrën nuk e bëre drejtpërsëdrejti.

Raqi Osumi nuk fliste. Cigarja, e harruar në taketuken që ndodhej mes tyre, lëshonte një tym të hollë e të kaltër.

— Tani, — vazhdoi Reshati, — pasi ke marrë dënimin si karrierist, për të cilin duhet të jesh i sigurt se askush nuk është penduar, ti ngre kurthin tjetër: na shpik teorinë e armiqësimit tënd me Partinë. Kujt mund t'i interesojë kjo? Sigurisht, edhe ti e di mirë që këtë nuk e ha askush, por vjen me një shpresë tjetër, që dikush, në këtë rast ky dikush jam unë, të mendojë sapo ti të dalësh jashtë: Mos i kemi rënë në qafë më shumë nga sa duhet këtij shoku? Pra, sulmi yt, sado që të duket i ashpër, në të vërtetë ka vetëm një mision: të liberalizojë, të zbutë, të amortizojë sadopak goditjen që t'u dha. Por, ja ku po ta them: zbutje nuk do të ketë.

Për njëfarë kohe u bë heshtje dhe Reshati, ndoshta thjesht për ta thyer atë heshtje, u ngrit dhe eci nëpër dysheme. Zhurma e hapave ishte edhe më e keqe se heshtja dhe ai ndaloi para bibliotekës. Pasi kaloi shkarazi sipër librave, vështrimi doli jashtë. Në ballkonin e katit të dytë të pallatit përballë nuk ishte gruaja që zbrazte ujin e vakët të borsës. Dy saksi pa lule ishin lënë në parvazin e ballkonit. Telat tundeshin lehtë dhe në ta nuk ishte nderë asnjë teshë.

— Ku të caktuan me punë? — pyeti ai.

— Normist në fabrikën e bukës.

— Shumë mirë. Futju punës dhe ke për ta gjetur përsëri veten.

Raqi Osumi hapi gojën dhe e pa në mënyrë pyetëse. Faqet e tij të rrumbullakëta, sikur të mos kishin shenjat e të rruarit, do të dukeshin si faqe fëmije.

— Domethënë, — shpejtoi Reshati të sqarohet, — jo veten tënde nëndrejtor, apo drejtor, këtë mos e shko nëpër mend, por atë djalin e urtë, punëtor që lexon e studion për të mirën e punës, bir të një fotografi të varfër, të rritur me mundim. Këtë djalë them të gjesh, të vërtetin, jo atë të shtirurin. Dhe tani shko, se kam edhe punë të tjera për të bërë.

Sapo doli Raqi Osumi, u fut Memli Muçostepa.

— Ç'i bërë ashtu? — pyeti.

— Kujt? — Reshati ngriti kokën nga shkretat.

— Raqi Osumit.

— Asgjë. Pse?

— E pashë korridorit. I ishin bërë sytë gjak. S'shikonte ku vinte këmbën.

Reshati u kufizua me një buzëqeshje të shtrirë.

— Asgjë, — tha. — Asgjë.

— Mos harroni se keni lënë të hani drekë me sekretarin e parë, — tha Memliu para se të dilte.

Reshati pa orën. Kishte kohë. Mbase do të ishte më mirë të pinte një kafe me Greta Tytymçen.

Filxhanët ë zbrazur të kafesë, tani të ftohur, ishin në anë të tavolinës së lartë, ngjyra e blertë e syprinës të së cilës kishte vende-vende gërvishtje të vjetra. Tre punonjësit e seksionit të arsimit i kishin pirë kafetë në heshtje dhe kishin dalë duke përkulur kokat në drejtim të tyre, pa folur. Letrat e mbështjella tub në dorën e majtë të Greta Tytymçes shpërndanin përreth një zbrastësi bezdisëse. Do të kishte qenë më mirë ta kishte pirë këtë kafe me dikë tjetër.

— Dalim, — tha Greta.

Reshati nuk foli, por, edhe për të lëvizur, nuk lëvizi.

— Nuk mendoj se ke të drejtë, — tha ai pas pak. — Mbase e gjithë e keqja ka qenë se mua më kanë ndikuar një sërë rrethanash private dhe sentimentale, e pranoj këtë, por kurrsesi, kurrsesi...

— Jo, Reshat, mos u përpiq, mos u përpiq t'i gjesh vetes justifikime. Thamë që do të flasim si miq të vjetër dhe ashtu të flasim. Për mua në gjykimin e kësaj çështjeje edhe ti ke rënë pre e një mentaliteti të hidhur, sipas të cilit është e këshillueshme që vartësit të jenë të urtë e të bindur. Është një mentalitet i rrezikshëm. Duke pasur rreth vetes njerëz të tillë, një kategori she-fash kujtojnë se çimentojnë veten. Shpinëkërrusurit mund të jenë një material i mirë për një bazament monumenti, mendojnë ata. Mirëpo, poshtë këtij bazamenti toka gërryhet, punët shkojnë për drej dhe monumenti fillon të shembet.

Reshati dëgjonte dhe bënte çudi me fjalorin e zgjedhur të Gretës. E dinte që ajo ishte një grua e kulturuar, por saktësia në ndërtimin e fjalive i mbushi mendjen se të gjitha ato që po thoshte atë çast, Greta duhet t'i kishte menduar mirë më parë.

— S'është e vërtetë se kam menduar kështu. E pranoj anshmërinë, po, tekefundit, dikush do ta bëjë këtë detyrë. Unë preferova Foren. Nuk them se s'jam ndikuar nga njohjet personale, të paktën ty nuk mund të ta them këtë. Kjo është e gjitha.

Fytyra e mprehtë e Gretës bëri një grimasë pakënaqësie.

— Kafetë po i paguaj unë, — tha.

Reshati nuk kundërshtoi dhe doli përpara. Në korridor kostumi gri i përgjegjësit të seksionit të arsimit lëkundej si tym.



## KAPITULLI VII

Ndërsa mbyllte dërrën e zyrës, telefoni ra përsëri, por Reshati nuk u kthye më. Bjer sa të kesh në kokë, tha ai me vete dhe shpejtoi të zbriste shkallët e sapolara. Pastruesja, me shkopin e gjatë në duar, u hoq mënjanë për t'i hapur udhë.

— Edhe ti na duhesh sot, — tha Reshati kalimthi, — s'mjafton shiu që po na mbyt. — Ai kishte dashur të bënte shaka, por zëri i kishte dalë i rëndë dhe pastruesja po e shikonte me sy të mëdhenj e të habitur.

— Po vetë ju, shoku kryetar, shoqja Gre-ta... — mërmëriti ajo dhe heshti pa ditur ç'të thoshte tjetër.

Mbase do të ishte më mirë të sqarohet, por

nuk kishte kohë. Nga xhamat e dritares pa Sabriu që, përmes shiut të rrëmbyer, po e afronte makinën te dera e komitetit.

— S'ka gjë, — tha në mënyrë të papërcaktuar, pa e kthyer kokën pas.

— Na mbyti, — tha kur hipi në makinë ndërsa shkundte piklat e shiut nga flokët e rraluar.

Sabriu nuk foli.

— Tek elektropompat e hidrovorit të bregdetit, — tha Reshati dhe hapi mbi gju evidencën e të dhënave operative të përmytjes.

Shiu kishte filluar para pesë ditësh. Agromët e kishin pritur me padurim. Natën e parë kishte qenë një shi i shtruar, por stacionet meteorologjike të Evropës njoftonin se re të tjera të shumta e të rënduara nga shira të vrullshme po afroreshin me të shpejtë nga Atlantiku Lindor. Në mbrëmje u duk sikur shiu do të pushonte, por aty nga mesnata ai rifilloi më me forcë se përpara. Reshati u ngrit nga shtrati dhe i mori në telefon të gjithë hidrovorët e rrethit. Në dy prej tyre nuk iu përgjigj fare njeri, kurse tre të tjerë i raportuan se ishin gati për punë, por sasia e ujërave ende nuk kishte arritur në kuotën e caktuar. Ai u lidh me kryeinxhinierin e ndërmarrjes së ujërave dhe e pyeti se sa ishte kuota e planifikuar për të filluar punë hidrovorët. Kryeinxhinieri, një burrë rreth të dyzetepesave, filloi t'i shpjegonte me nge se mbi ç'eksperiencë të përparshme ishin caktuar kuota të tilla të lar-

ta. Reshata ishte mërzhitur shpejt nga shpjegimet e tij dhe i dha urdhër që, jashtë të gjitha planifikimeve, të fillonte menjëherë puna nëpër hidrovorë. Kryeinxhinieri diçka mëmëriti për problemet tepër të mprehta që mund të lindnin nga tejkalimet e planit të energjisë elektrike, por Reshata nuk deshi të dëgjonte më tej. Kur të mbarosh së bëri ti hesapet, tha, mbase më ashpër sesa duhej, uji do të të ketë ardhur në shtrat.

Thatësira e gjatë i kishte vënë në gjumë punonjësit e drejtorisë së ujërave dhe, që ditën e parë të përmbytjeve, u zbulua se shumë nga elektropompat nuk ishin në gatishmëri. Tokat u mbuluan nga ujëra të tepërta dhe, me gjithë rrëgjimin e rënduar të disa prej hidrovorëve, nuk përballuhej as uji që binte nga qielli, jo më të pakësohej ai ekzistuesi. Ishte dhënë alarmi në të gjitha ekonomitë bujqësore. Rrethi kishte më shumë se 10 mijë ha tokë që kishte përfituar nga tharja e kënetave dhe që ishin të kërcënuar vazhdimisht nga përmbytjet. Njëkohësisht kishte pasur rrëshqitje toke nëpër zonat malore. Disa prej puseve të naftës e kishin humbur lidhjen me qendrën. Linja telefonike të ndryshme ishin këputur. Në dy kooperativa të malësisë kishte pasur edhe defekt në linjat elektrike.

Kishte dy ditë që ai pothuajse nuk futej fare në zyrë. Pas shumë përpjekjesh, me ndihmën e reparteve ushtarake, ishte siguruar lidhja me pusin 607—K. Në zonat malore ishte dërguar me urgjencë miell për bukë, pasi ndërprerja e ko-

rrentit kishte penguar punën e mullinjve. Po mullinjtë me ujë ku ishin?, pyeste veten Reshati.

— Sa shi thua të ketë rënë deri tani? — pyeti Reshati dhe e futi në xhep evidencën duke e palosur keq.

— Sot? — pyeti kryeagronomi i rrethit që ishte ulur në ndenjësën e pasme. Pastaj, me sa duket, e kuptoi që pyetja kishte qenë pa vend dhe shtoi: — Tridhjetë po e po.

— Mos fol si plakat. Ke pyetur njeri?

— Jo, shoku kryetar.

Reshati pa orën e dorës. Nuk kishte shkuar ende tetë. Shiu përjashta ishte shtuar përsëri. Retë që vinin përballë ishin të ulëta dhe dukej sikur do të çiknin makinën. Rruga përpara dukej e mjegulluar. Mbi peizazhe të bëhej sikur një dorë e padukshme vazhdonte të shpërndante mjegull. Kur ishin të vegjël, ata dilnin te pragu i shtëpive dhe, ndërsa binte shi, hidhnin duar me kripë. Kështu u kishte thënë gjyshja, hidhni kripë dhe shiu pushon. As sot e kësaj dite nuk kishte arritur ta kuptonte mbi se ishte mbështetur kjo bestytëni. Ç'lidhje mund të kishte mes ujit, kripës dhe pushimit të rreshjeve? Deti??? Megjithatë ky nuk ishte një argument i mjaftueshëm për të krijuar një bestytëni... O zot!, gati sa nuk foli me zë Reshati.

— Më shpejt, — tha në drejtim të Sabriut dhe u afrua edhe më pranë xhamit të makinës sikur kjo do ta afronte në të njëjtën kohë edhe me zonën e mbytur.

Tani kishte më shumë se një çerek ore që ecnin në rrugë të paasfaltuar dhe Sabriut i duhej të bënte kthesa të shpeshta për t'iu shmangur gropave të shumta të mbushura me ujë.

— Nuk e mirëmbajnë fare këtë rrugë, — tha Sabriu me sa duket për të justifikuar ngadalësinë.

Reshati nuk foli fare. Kryeagronomi i rrethit rrinte në një cep të ndenjësës së pasme, i verdhë në fytyrë.

Përballë po vinte makina e sekretarit të parë. Shoferi i saj ndezi dhe fiku disa herë rresht fenerin e kuq dhe Sabriu uli shpejtësinë duke iu afruar. Shoferët ulën xhamat dhe, përmes perdes së shiut, Reshati pa në thellësi të makinës fytyrën e bardhë të sekretarit të parë. Me siguri që kishte pirë shumë cigare dhe atij i kishte mbetur një zakon i vjetër e i pinte pa filtër.

— Ku po shkon? — e pyeti ai pasi shkëmbyen përshëndetjet e rastit, më të shkurtra se kurrë.

Reshati i tregoi për shqetësimet e hidrovorëve.

— Po ti, ku ishe? — e pyeti pastaj.

— Isha deri në kooperativën «Adriatiku». Njerëzit janë të gjithë në këmbë. Edhe mielli u dërgua për në malësi. Vetëm nga shokët e ndër-marrjes së ujërave kërkohet më shumë. Isha edhe te hidrovari. Ata kanë defekt, por asnjë nga drejtorja nuk ndodhej aty. Ç'bëjnë? Po dështuan sot, më mirë t'ia heqin vetes.

— Hë, hë, — bëri Reshati në mënyrë të përcaktuar.

— Ti do të vonohesh?

— Nuk e di. Kishit ndonjë gjë me rëndësi?

— E ç'mund të ketë më të rëndësishme sesa ky, — tha sekretari i parë duke treguar me kokë shiun, — Fole gjë me mëeteorologjinë?

— Fola, — tha Reshati dhe nuk u shty më tej.

— Dhe?...

— Ashtu, — tha Reshati me pakënaqësi. — Do të bjerë, por edhe mund të pushojë. As mish, as peshk.

Sabriu shkëmbeu një vështrim me shoferin e sekretarit të parë dhe të dy qeshën nën buzë. Kryeagronomi lëshoi një të qeshur të shkurtër nga ndenjësja e pasme.

— Mirë, Reshat, kur të vini në punë hidrovorin, të më marrësh në telefon.

— Dakord.

Makinat u shkëmbyen me të shpejtë duke spërkatur njëra-tjetrën.

Aty nga dreka makina e Reshatit po futej me tërsëllëm në oborrin e vogël të ndërmarrjes së ujërave. Te dhoma e nëpunësit të rojës kishte tym dhe përmes tij Reshati mundi të shquante tre burra, dy prej të cilëve, të ulur në tavolinë, tymosnin të qetë dhe qeshnin me kushedi ç'ndodhi. Sapo panë në derë kryetarin e komitetit, u

ngritën në këmbë dhe nuk dinin ku të futnin cigaret, sikur të ishin nxënës.

— Urdhëroni, shoku kryetar, — tha njëri prej tyre që me sa duket do të ishte nëpunësi i rojës.

— Ku e ke drejtorin?

— Në zyrë duhet të jetë, shoku kryetar. Ta marr në telefon?

— S'është nevoja. Kështu i zgjidhni të gjitha punët ju të kësaj ndërmarrjeje, me telefona?

Reshati doli pa pritur t'i përgjigjeshin dhe, duke ecur nën shiun që nuk kishte ndër mend të pushonte, u fut në korridorin e ngushtë e të gjatë të ndërmarrjes. Atje ishte terr, pasi i gjithë korridori e merrte dritën nga një dritare e vetme, e cila atë çast që e zënë nga trupat e dy burrave. Pranë tyre, disa të ulur në një stol të shkurtër, të tjerët mbështetur pas murit, rrinin nja tetë-nëntë burra të tjerë.

Reshati kërkoi nëpër gjysmëterr derën ku shkruhej «Drejtori», e shtyu, por dera nuk u hap.

— Or shok, — i thirri njëri nga burrat. — Nuk ke njeri në atë anë.

— Po kryeinxhinieri? — pyeti Reshati dhe, duke menduar se mbase ata mund të kishin shkuar në ndonjë hidrovor tjetër, sikur u qetësua.

— As atë s'e ke në zyrë, — iu përgjigj po zëri i parë.

— Po ju ç'bëni këtu? Të ndërmarrjes së ujërave jeni?

— Të kësaj qen ndërmarrjeje jemi, mor shok,

të kësaj, — tha më pakënaqësi njeriu, të cilit nuk i shquhej fytyra. Dikush iu afrua dhe diçka i pëshpëriti në vesh. Me sa duket po i thoshte se kush ishte Reshati.

— Le të jetë, ore, kryetar, — vazhdoi burri. — Sikur ka për të na ngrënë. Sikur po shtoj ndonjë gjë nga vetja? Ja, thuaj ti që nuk është.

— Nuk them.

— Atëherë ç'më grin sallatë kot.

— Ç'po bëni këtu? — pyeti Reshati pasi u tha të uleshin atyre që u ngritën në këmbë, kur e morën vesh se cili ishte.

— Ah, mor shoku kryetar, — foli kësaj rade një tjetër, ai që ishte mbështetur pas parvazit të dritares, — kemi ardhur për mend. Do të na vërë në binarë këshilli teknik.

— Kësaj i thonë: Stambolli digjet e ... ajo krihet, — u hodh përsëri në bisedë burri i parë.

— Jo, po sidoqoftë, shokët kanë planet e tyre, të mos i marrim gjërat rrëmbyer, — kundërshtoi një zë i pasigurt.

— Mos e mbulo diellin me shoshë ti, është siç e tha Njaziu: Stambolli digjet, ajo krihet. Ne e kemi ujin te pragu i shtëpisë, këta na u kujtuan për të bërë mbledhjen e këshillit teknik!

— Kur ka filluar mbledhja? — pyeti Reshati.

Përzieras ata i thanë se kishte më shumë se një orë.

— Ku janë futur?

— Në sallën e këndit të kuq.

— Mirë që nuk po na bëjnë ndonjë mbrëmje



vallëzimi, — shpotiti Reshati dhe u nis andej nga ishte drejtuar krahu i atij që quhej Njazi.

Së trokiturës së tij iu përgjigjën nga brenda që të priste, pasi ende nuk i kishte ardhur radha. Me siguri e kishin kujtuar për ndonjë nga ato që prisnin. Ai shtyu derën dhe mbeti një hop te pragu. Një pjesë e aparatit tekniko-inxhinier të ndërmarres ishte ulur në një tavolinë të gjatë, në krye të së cilës rrinte drejtori. Ai u bë gati të lëshonte një të sharë në drejtim të atij që kishte guxuar të hapte derën pa leje, por, kur pa Reshatin, u meq dhe ngriu vetiu në këmbë. Ndërkohë, njëri nga inxhinierët po vazhdonte t'i fliste një burri trupvogël zeshkan, të cilin Reshati e kishte përballë. Inxhinieri ishte me shpinë nga dera dhe nuk e pa kush u fut. Shpina e tij e mbuluar me kapotë tepër të trashë dukej e madhe.

— Ardit, — i thirri njëri nga burrat pranë dhe i tregoi me kokë nga dera.

Ai që quhej Ardit u kthye nga dera dhe fjala i mbeti përgjysmë.

— Shumë bukur, hə, — tha Reshati duke e mbajtur veten me vështirësi për të mos bërtitur.

— Stambolli digjet dhe drejtorja po na krihet! — e ndryshoi fjalën e urtë, të cilën ia kishin kujtuar pak përpara në korridor.

— Shoku Reshat, — mori përsipër të sqarohet drejtori.

— Ç'shoku Reshat më thua, more, more... si të të them, se nuk ma nxe goja. Ne i kemi grunjërat nën ujë, ti na kurdis mbledhje pas mbledhjesh.

— Por ishte pikërisht kjo situatë e jashtëzakonshme që na bëri të mbledhim këshillin teknik, Thamë të merrnim masa.

Reshatit po i hipte përsëri gjaku në kokë. Drejtori kishte filluar ta drejtohte këtë ndërmarje para 5-6 muajve dhe vinte pasi për më se dhjetë vjet kishte punuar në zyrën e statistikës. Njeri i urtë, ky ishte opinioni i përgjithshëm për të, por, duke e dëgjuar që fliste, Reshati e kuptoi që kishte para vetes një njeri të mefshët, teknokrat, ishte e vështirë të merrej vesh me zyrën ku kishte punuar më parë.

— More, po ju qenkeni të çuditshëm shumë, — tha. — Ç'masa na paske marrë zotrote! Masat e... mos më bëj ta them! Tetë motopompa të fuqishme nuk të punojnë as sot, këto masa ke marrë zotrote?! Përjashta! Pas gjysmë ore ju dua të gjithë nëpër hidrovorë dhe mbledhjen e ardhshme të këshillit teknik nuk do ta bëni pa më njoftuar edhe mua! Përjashta!

Te dera e lënë hapur ishin grumbulluar kokat e atyre që kishin gjetur në korridor. Mbase nuk bëri mirë që foli ashtu në sy të tyre. U hodhi një vështrim hetues fytyrave të tyre. Asnjëra nuk dukej e kënaqur.

Ai çau udhë mes tyre dhe doli në oborr. Sado që vazhdonte të binte shi dhe moti ishte i errët, atje ishte krejt ndryshe.

— Shoku Reshat! — dëgjoi zërin e drejtorit që po e thërriste nga pas, por nuk u kthye.

## VAZHDON KAPITULLI VII

Te xhamat e ndarjes së nëpunësit të rojës, edhe më e zeshkët se ç'ishte në të vërtetë, me sa duket për shkak të ndriçimit të keq, i buzëqeshi fytyra e gjerë e shefit të bujqësisë. Ai bëri një përpjekje për t'u ngritur në këmbë. Reshati luajti dorën në shenjë që të mos lëvizte, megjithatë tjetri u ngrit dhe afroi kokën te dritarja e hapur. Reshati ngadalësoi hapat.

— Ju kërkonin në telefon, — tha.

— Po?

— Kryeministri. Tha se mund ta merrni në telefon deri në orën 13.00.

— Nuk ishte Memliu lart?

— Jo.

— Faleminderit!

Reshati nxori çelësat nga xhepi dhe shpejtoi hapat drejt shkallëve. Nga grumbulli i njerëzve që prisnin në korridorin e ftohtë u shkëput një grua dhe i doli përpara.

— Më falni, — tha ajo.

— Të më falni ju, — ia ktheu Reshati. — Nuk kam kohë tani.

Gruaja, që me sa duket nuk e priste këtë, u shtang. Reshati ngjiti tri shkallët e para me të shpejtë, pastaj u kthye joplotësisht dhe, si duket i penduar për tonin e prerë me të cilin i kishte folur pak më parë, tha:

— Ju kishit punë me mua?

— Unë... Një letër që ju kam dërguar ka tre muaj...

— Dhe nuk keni marrë përgjigje?

— Po, kam marrë, por pikërisht për përgjigjen...

— Më vonë. Të thërras vetë, — tha ai dhe vazhdoi të ngjiste shkallët. Diku e kishte parë atë grua, mbase kishte ardhur edhe herë tjetër në pritje të popullit. I kishte mbetur në mend se, kur fliste, i lëvizte maja e hundës.

Hyri në zyrë dhe, pa e mbyllur derën, i tha centralistes ta lidhnin me kryeministrin. Pastaj u kthye, mbylli derën, u ul në kolltukun e tij të punës dhe ndezi një cigare, e cila i shijoi pa masë. Sa orë kishte pa pirë duhan?

Shirat e gjata që kishin rënë pa ndërprerje, brenda një kohe të shkurtër kishin përmbytur rreth 4000 ha tokë, nga të cilët 2800 të mbjellë

me grurë. Me siguri kryeministri i kishte telefonuar për përmbytjen. I hodhi një sy relacionit për gjendjen që i kishin lënë mbi tavolinë. Rreshjet e 24 orëve të fundit 86 milimetra. Niveli i ujërave kishte rënë edhe 17 cm. Nën ujë ishin tani 1300 ha tokë, nga të cilët rreth 850 të mbjellë me grurë, të cilët, po që se nuk liroheshin deri të nesërmen, do të duhej të rimbilleshin. Furnizimi i pusit 607—K kishte rifilluar atë ditë me mushka e kuaj, nëpër një rrugë tjetër, rreth 40 km më të gjatë nga e para. Nga 18 pompa të fuqishme të 6 stacioneve të pompimit, tani ishin në punë 14. Në aksion ishin hedhur rreth 7000 forca pune, kryesisht të rinj.

Nëpër këmbë kishte ende thërrime të bukës së misrit që kishte ngrënë atë mëngjes në mensën e hidrostacionit të pompimit pranë bregdetit. Pse nuk furnizohej kjo mensë me bukë gruri? Afroi telefonin dhe, pikërisht kur donte të krijonte numrin e ndërmarjes tregtare, ra zilja.

Zëri i Kryetarit të Këshillit të Ministrave ishte i thellë dhe i shtruar.

— Në radhë të parë dua të më thoni nëse janë marrë të gjitha masat për furnizimin e njerëzve. Po energjia elektrike u kthye përsëri në të gjitha fshatrat? Si funksionojnë shkollat? Shërbimi sanitar? — e ndërpreu ai kur Reshati filloi t'i rendiste shifrat që i dinte përmendsh.

— Jo, — tha Reshati. — Nuk ka pasur probleme të kësaj natyre.

— Në rregull. Tani vazhdojmë më tej. Ke qenë ti atje?

— Sapo u ktheva, shoku kryeministër.

— Si është puna me 6 elektropompat që nuk janë në punë sot? Kjo nuk është gatishmëri.

Edhe pse vërejtja ishte thënë me zë tepër të shtruar, Reshati ndjeu gjakun t'i vërshonte nëpër fytyrë.

— Katër, — tha ai.

— Urdhëro?

— Dy u vunë në punë para një ore. Po sot do të vihen në punë edhe dy të tjera. S'ka pasur energji elektrike, shoku kryeministër.

— Mirë, mirë, shoku Reshat. Na mbani në korrent të gjithçkaje.

— Patjetër. Faleminderit!

Edhe pasi linja ishte mbyllur, Reshati vazhonte ta mbante receptorin në vesh pa arritur të mendonte diçka konkrete. Para syve i sillshin sipërfaqe të turbullta ujërash. Re të rënduara me shi që shtegtonin drejt veriut. Gra të veshura me mushama plastike të shpërndara nëpër grurë duke hapur e rihapur vijat kulluese. Vargu «... dhe s'durojnë kurrfarë turbullire gratë,» që kushedi nga ç'poezi i kishte mbetur në kokë. Pastaj Albani veshur me mushama të zezë, sipër një skele...

Sa kohë kishte që nuk ishte ulur të bisedonte me të birin? Nuk kam kohë, mendoi një herë, pastaj një çast një zë i dytë brenda tij shtoi: Nuk ke kohë apo i shmangesh?? As i shmangem,

as i bëj dredhë, por po më zien koka. U bënë kaq net që fle apo nuk fle nga 3 orë. Sa net? Këmbënguli zëri i dytë. Dhjetë? Njëqind? Ti asnjëherë nuk ke pasur...

— Mbaruat me Tiranën? — dëgjoi të flisnin në vesh të tij dhe pothuajse u tremb.

Reshati e uli receptorin pa kthyer përgjigje. Duhet të kishte luhatje të tensionit të gjakut. Fërkoj tëmthat. Mori një kokërr adelate që e përcolli me një gotë ujë. Edhe pasi e piu ujin, thërrimet e bukës së misrit nuk ishin mbaruar nëpër kthinat e shumta të gojës. Duhet të njoftonte sekretarin e parë për telefonatën e Kryeministrit, por këtë mund ta bënte edhe më vonë. Kishte tri ditë që nuk punonte në zyrë dhe tufa e shkresave mbi tavolinë ishte rritur. Mbase duhej të dilte edhe pasdreke të merrej me to.

I telefonoi Julisë. Ajo sapo ishte kthyer nga shkolla dhe për drekë nuk kishte gatuar asgjë të mirë.

— Mund të hash jashtë, — i tha ajo. — S'kam asnjë dëshirë të merrem me gjellë tani. Je i lodhur?

— Jam pak.

Për një kohë u bë heshtje dhe, sikur të mos ishin fishkëllimat e linjës, ai do ta besonte se lidhja ishte këputur.

— Ti diçka ke?

— Jo. Nuk kam asgjë. Pse duhet të kem patjetër diçka sa herë që nuk gatuj?

— Sepse reaksioni i parë i gruas që ka diçka,

shpallet në kuzhinë. — Shakaja tingëlloi boshe dhe për veshët e tij.

— Kisha kujtuar se pas kaq vjetësh jete familjare, do të kishe hequr dorë nga ca paragjykime tipike beqarësh të vonuar.

Biseda po bëhej absurde dhe nuk kishte asnjë kuptim të vazhdohej me këto tone.

— Më prit për drekë, — tha ai.

— Si të duash. Keq për ty është. — Ndoshta vërtet nuk kishte asgjë konkrete. Ishte në periudhën e menopauzës dhe shpesh kohët e fundit acarohesh për mosgjë.

Reshati e mbylli telefonin me të shpejtë duke e shkelur me gishtin tregues të dorës së majtë.

Pa dyshim që duhet të ishte e rëndë për gratë kjo fazë. Mjeku gjinekolog i kishte treguar se gjatë kësaj periudhe viheshin re disekuilibre të theksuara psikike te gratë. Të mos jesh më grua. Të mos kesh më mundësi të lindësh. Ishte në fund të fundit thyerja e raporteve të njeriut me natyrën, madje jo thjesht me natyrën në përgjithësi, por me natyrën e vetes. Në thelb të gjitha përpjekjet e njerëzimit nuk janë gjë tjetër, veçse përpjekjet për përsosjen e harmonisë së tij me natyrën, mendoi ai, por u desh një kohë tepër e gjatë të kuptohej se harmonia e njeriut me natyrën nuk mund të arrihej kurrësi pa përsosur në radhë të parë marrëdhëniet mes njerëzve.

Po bëj filozofi, tha ai pa zë dhe u ngrit e eci nëpër zyrë.



Po bëj filozofi, tha ai pa zë dhe u ngrit e eci nëpër zyrë.

Jashtë vazhdonte të binte shi i shtruar. Qielli dukej më i lehtë. Blloqet e reve nuk ishin çarë ende, por ndriçimi qiellor ishte bërë i qartë. Në ballkon kishte dalë gruaja me robdeshambër, kësaj radhe pa borsë në dorë, dhe shikonte qiellin me kokën të ngritur lart. Reshati pa orën. Po shkonte 12.

— Hë, u bëra filozof — tha me zë kur e ndjeu se kishte një dëshirë të papërmbajtur për të vazhduar meditimin.

Trokitën te dera dhe ai pati frikë mos njeriu që përtej saj kishte dëgjuar. Mos kishte folur me zë?

— Hyr! — tha.

Ishte Ollga Çoba që sillte postën e ditës. Ai firmosi atje ku i tregonte ajo me gishtin e shkur-tër.

— Faleminderit, shoku Reshat, — tha ajo duke mbyllur librin e regjistrimit të postës zyrtare.

Reshati hoqi syzet që i përdorte kur punonte dhe u përpoq ta gjente pse po e falënderonte Ollga Çoba.

— Përse?

— Që më erdhët në shtëpi për çunin. Nuk do t'jua harroj kurrë.

— Mirë, mirë, — tha butë Reshati. Kohë më parë, ndaj shpalljeve të tilla të një lloj servilizmi mbante qëndrime të ashpra, por, me kalimin e kohës, e kishte kuptuar se jo përherë pas tyre

fshiheshin qëllime të caktuara. — I gjete dhëmbët? — ndërroi bisedë.

— Aha, ikën ata! Tani kam porositur të rinj. Ec e duro edhe një herë tani. Apo nuk dhe mbini ca të uruar. Prandaj i thonë dhëmb, se dhëmb.

— Ditën e mirë, Ollga! — e ndërpreu ai.

Ollga Çoba doli duke folur me vete. Reshati telefoni në seksionin e organizimit dhe porositi që çdo ditë, në orën 7 të mëngjesit, donte mbi tavolinën e tij informacionin e hollësishëm rreth përmbytjes. Pastaj filloi të merrej me postën e ditës. Ndihej i qetë. Me sa duket adelata kishte filluar ndikimin e saj.

Kur doli nga zyra, ora ishte 2 e 20 minuta. Te dera e jashtme dëgjoi ta thërrisnin nga e ndara e nëpunësit të rojës.

— Shoku kryetar.

Ai u kthye. Ishte përsëri shefi i bujqësisë. Në kthinë ishte ndezur neoni dhe fytyra e tij e zeshkët dukej tani si e spërkatur me gëlqere.

— Kjo shoqja po ju pret.

Ishte gruaja që e ndaloi te shkallët para disa orësh. Tani ai vuri re se poshtë palltos bezhë që i rrinte lirshëm, fshihej trupi i bukur i një mesogruaje.

— Të më falni për pak më parë, — tha ajo dhe fytyra ovale iu skuq lehtë në mollëza. — Por nuk e dija se ku po shkonit.

Gruaja pa përqark si për të thënë se nuk mund të fliste në prani të njerëzve që rrinin të heshtur në korridor. Reshati i tha se mund të bënin një copë rrugë së bashku, ndërsa ai do të shkonte për në shtëpi.

— Ju nuk më njihni mua, — tha pas dy-tre hapash gruaja me një dyshim të lehtë.

— Të them të drejtën, kështu si fytyrë...

— Më quajnë Domenika Dani.

— Po. E kam dëgjuar edhe emrin tuaj.

Në fytyrën e Domenika Danit rrëshqiti një hije zhgënjimi. Reshati u kthye nga ajo. Në fillim sytë, pastaj, rrethas tyre: balli, mollëzat e kërcyera, hijet e lehta të faqeve, buzët dhe mjekra u ngurtësuan nën kalimin e atij veli të padukshëm. Reshati pati frikë se të njëjtën gjë do të kishte pësuar edhe maja e hundës.

Me një qartësi të mprehtë iu kthjellua në çast gjithçka. Letra. Bisedat me Foren. Sa herë i ishte kujtuar kjo grua dhe hallin e saj e kishte shtyrë për më pas. Dhe, sikur të mos mjaftonte vonesa, tani e kishte harruar fare. Dhe ajo tani ishte mpirë.

— Atëherë më falni, — tha ajo ftohtë. — Nuk kemi përse të flasim bashkë.

— S'ju kuptoj?

— Unë kujtoja se ju e keni lexuar letrën time. Prandaj nuk kisha ardhur deri tani, dhe nuk do të kisha ardhur, sikur mbrëmë burri im... Po nejse, nejse.

— Ju kanë kthyer përgjigje?

Ajo, me një pamje tepër krenare, nxori dorën nga xhepi dhe i zgjati një copë letër të zhubrosur nga të sjellët gjatë nëpër duar. E mori dhe e lexoi.

*«Në përgjigje të letrës suaj dërguar kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit, ju vëmë në dijeni se përgjigjen do ta merrni në drejtorinë e ndërmarrjes.*

**Për seksionin e tregtisë  
Përgjegjësi  
Kristofor Farashuku».**

Reshati pati përshtypjen sikur mpirja që kishte hetuar pak më parë në fytyrën ovale të Domenika Danit, tani, mbase me anë të asaj cope letre, i kishte kaluar atij. Këmbët i ishin bërë si prej druri. Edhe duart. Të parat duart.

— Kur e keni marrë këtë letër?

— Ka një muaj e gjysmë.

— Pse nuk keni ardhur më parë?

— As nuk do të kisha ardhur kurrë sikur të mos ma kishte gjetur burri mbrëmë. Ai u bë si i... Po juve nuk ka ç'ju duhen këto gjëra. Këto më përkasnin mua dhe atij. Domethënë edhe ju mendoni po kështu? — ajo tregoi me gisht letrën.

— Mund të ma jepni mua këtë letër?

— Jo. Më duhet. Përderisa edhe ju mendoni po kështu, unë do të drejtohem më lart, në Parti.

Reshati u gëlltit para se të fliste.

— Nuk dua të them që të mos drejtoheni

më lart. Kjo është një e drejta juaj, por, po qe se... — pastaj ndërroi mendje. Tekefundit nuk kishte nevojë për atë copë letër. — Mirë, mirë. Bëni si të dini.

— Edhe ju bëni si të dini, — tha Domenika Dani flakë për flakë, por, ndryshe nga përmbajtja, toni i fjalëve ishte i butë. — Megjithatë, nuk më duket fare normale që ankohet njeriu për dikë dhe ju i thoni: «Shko e merr përgjigje tek ai për të cilin je ankuar.»

Reshati u gëlltit përsëri, por boshllëkun që kishte në gjoks nuk mund ta mbushte me pështymë. Sido që fjalët e Domenika Danit duhej të ishin të menduara më parë, mbase edhe të përsëritura, ato ranë në zgavrën e gjoksit të Reshatit rëndë, si gurë të gdhendur.

— Sigurisht, — tha. — Kjo nuk është aspak normale.

Kishin mbetur në këmbë poshtë shkallëve të gjera prej guri të komitetit. Sheshi ishte më i pjerrët se zakonisht. Vazhdonte të binte shi. Sa do të kishte shkuar niveli i ujërave të përmbytjes?

— Ju jeni aktualisht pa punë?

Domenika Dani tundi kokën në shenjë miratimi.

— Keni hapur gjyq?

— Po. Kemi bërë disa seanca. Tani ka kaluar në gjyqin e shkallës së dytë.

— Dhe?

Ajo ngriti supet.

— Ashtu, — tha. — Një herë e fitoj unë, një herë ai.

— Mirë, — tha Reshati. — Unë po kthehem pak në zyrë. Do të më falni. Mirupafshim!

Ajo e pa me habi.

— Mirupafshim! — tha hutueshëm.

I ngjiti shkallët me të shpejtë dhe, kur u gjend para derës së zyrës së Fore Farashukut, i merrej fryma.

— Eja pak! — i tha duke dihatur. Fore Farashuku po vishte një xhakavento të trashë. Jaka e saj ishte e mbuluar me një push tepër të bardhë. Xhakaventoja nuk i shkonte Fores dhe Reshati pati përshtypjen se ai po bënte provë plaçkën e tjetërkujt. — Të pres në zyrë!

— Si është puna? — pyeti Fore Farashuku dhe e mbylli derën pas vetes.

Reshati e pa me bisht të syrit. Xhakaventoja e tregonte tepër kaba. E kishte pasur më mirë pallton e vjetër.

— Më sqaro rreth Domenika Danit.

— I kam kthyer përgjigje.

— Kur?

— S'e mbaj mend. Mbase para dy muajve.

— Gënjen. Ka pesë javë.

— Mbase, — u përgjigj më shumë me tundje koke Fore Farashuku. — Ç'bëri 5 javë, ç'bëri 8 javë? Përgjigjja ajo është. — Mospërfillja e tij po i ngrinte edhe më shumë nervat Reshatit. Dhe, sikur të mos mjaftonte mospërfillja, Forja vazhdoi me një kapadaillëk që nuk i shkonte: —

Se mos kam hallin e Domenika Danit unë. Mua po më zien koka për njëqind probleme të tjera.

— E, megjithatë, unë nuk po të pyes për hallet e tjera, por për hallin e saj.

— Ajo është një shpifëse. Bile butë i jam përgjigjur më duket. I kërkonin llogari dhe ajo gjeti mënyrën për t'u ankuar.

— Dhe ankimit të saj duhet t'i japë përgjigje pikërisht njeriu për të cilin ajo është ankuar? Bukur, hë?!

— Ndoshta nuk është dhe aq bukur, por dokumentet i ka të gjitha në rregull Labo Ajeti. S'e kap dot njeri Labo Ajetin.

— Askush nuk ka ndër mend të kapë Labo Ajetin. Ne duhet të kapim të vërtetën dhe t'i japim secilit atë që meriton nga kjo e vërtetë. Për këtë na paguajnë.

— Unë ashtu dija, — tha Fore Farashuku me një kokëfortësi të panjohur për Reshatin, — dhe ashtu iu përgjigja. — Në zërin e tij të trashë nuk kishte asnjë hije nga servilizmi i së shkuarës.

— Ne, sikur biseduam bashkë, më duket.

— Biseduam. Por unë i hyra punës me themel, dhe, për hir të së vërtetës...

Ishte e kotë të bisedohej më tej.

— Ku ndodhet letra e shitëses?

— Në arkiv.

— Mirë. Nesër në orën dymbëdhjetë të dua në zyrë së bashku me Labo Ajetin.

Fore Farashuku tha se Labo Ajeti nuk ndo-

dhej në qytet, pasi kishte shkuar në një dasmë, në Gjirokastrë.

— Atëherë, të hënën, — tha Reshati me ton të ftohtë.

— Mbase nuk arrin të kthehet.

— Ta lajmërosh e të kthehet patjetër.

Fore Farashuku ngriti supet e qeshi fare pa vend.

— Si të urdhëroni, — tha. — Do të vini të hamë bashkë?

— Jo, ... — Fore Farashuku kishte ndaluar me dorën e madhe te doreza e derës, — si shumë shpesh të kam parë të hash nëpër lokale këto kohët e fundit.

— Ky është qortim zyrtar? — pyeti Fore Farashuku duke qeshur, pothuajse miqësisht, duke u përpjekur të ringrinte rrënojat e një ure të vjetër.

— Merre si të duash. Ditën e mirë!

Atë mbërmje, vonë, kur ishin shtrirë për të fjetur, me shpinë të mbështetur pas kokës së shtratit të gjerë, duke parë i menduar pikturën që shpërndante përçark një dritë uniforme, Reshati pyeti Julinë:

— Le ta zëmë se ti e ke inat drejtorin e shkollës sate. A do të bëje një letër me anë të së cilës të gënjeje se ai të bie në qafë, vetëm e vetëm për t'u hakmarrë ndaj tij?

— S'të marr vesh, — tha Julia që po vinte



bikutitë te tavolina e tualetit. — Si më bie në qafë?

— Domethënë të gënjesh se ai kërkon marrëdhënie intime me ty.

Fytyra e Julisë u thartua keq në pasqyrën e vogël vezake.

— Domethënë me atë, — i doli përpara keq-kuptimit Reshati.

— Ç'janë këto pyetje të marra? Asnjë grua nuk do të bënte një gjë të tillë, edhe sikur vërtet drejtori t'i... t'i ketë rënë në qafë, si ç'thoni ju burrat.

— Po sikur ajo të jetë... ta zëmë se do të jetë e përdalë?

Julia u ngrit në këmbë dhe, duke parë me bisht të syrit trupin që shquhej turbull përmes këmishës së tejdukshme në pasqyrën e gardero-bës, tha:

— Për këto shko pyet ndonjë të përdalë!

Fiku dritën, u shtri dhe i ktheu shpinën pa folur.

## NDËRKAPITULL

(ose parahistori)

Ata ishin në klasën e shtatë kur në qytet filluan të bëheshin ndërtime të shumta. Në fshat rreth e qark ishin zbuluar rezerva të konsiderueshme nafte dhe gazi. Qyteti po zbukurohej dhe rritej, por në drejtim të kundërt me Sheherin, kështu që shtëpia e Simo bostanxhiut mbeti përgjithmonë në fshat dhe këtë ai e priti me gëzim. Nga Andrea nuk vinte asnjë letër dhe plaku e kishte bërë hasha, por njerëz të ndryshëm që vinin nga Durrësi sillnin lajme të këqija për të. Kujdesi ndaj Fores në shtëpi u rrit në mënyrë të ndjeshme. I ati përpiquej t'ia përcillte të gjitha njohuritë e veta të ngatërruara për perimtarinë, pemëtarinë apo bletarinë.

Sheheri pothuajse u zbraz; frontet e reja të punës kishin nevojë për njerëz, por Simoja nuk lëvizi nga shtëpia e tij.

Dhanë provimet e shkollës shtatëvjeçare dhe, në verë, Reshati iku në Fier ku do të ndiqte edhe shkollën e mesme ekonomike. Fore Farashuku kishte vendosur të merrej me kopshtin e tij.

Kur Reshati u kthye dhe filloi nga puna në ndërmarrjen gjeologjike të naftës, u shkoi për vizitë. Kocka e madhe e Fores ishte pjekur, lëkura i ishte ashpërsuar dhe ai ua kishte marrë dorën punëve të kopshtit e të bletëve. Plaku, tani kockë e lëkurë, rrinte ulur tërë kohës te pragu dhe shahej me njerëz të paqenë. Pikat e kuqe në lëkurën e holluar të duarve ishin nxirë. I nxorën mjaltë dhe arra. Për Andrean nuk dinin asgjë. Mbase edhe dinin, por nuk donin të flisnin. Atë behar Forja ishte fejuar. Nusen e tij të ardhshme e quanin Donika.

Pas dy vjetësh Reshatin e emëruan përgjegjës sektori. Forja ishte martuar para dy muajve dhe ashtu, me kostumin e dhëndërisë, i kishte trokitur në derën e zyrës, në barakën prej pupuliti. Ishte vjeshtë. Në dorën e majtë kishte një shportë, grykën e së cilës e kishte zënë me gjethe rrushi, pothuajse të verdha. Shporta nuk shkante fare me kostumin e errët, megjithatë Reshati mendoi se ai ishte nisur për në pazar.

Forja e la shportën pas derës dhe u përqaftuan. Cigare nuk pranoi të merrte, si gjithmonë.

— Dua të futem në punë të shtetit, — tha.

Fytyra e Reshatit u çel.

— Patjetër, — tha ai. Kishte kohë që mendohej t'i mbushte mendjen të fillonte punë në ndërmmarrjen shtetërore. I kishte folur për të ardhmen e pronës private, për ligjet themelore të shoqërisë së re socialiste, por Simoja nuk e linte të birin. — Shumë mirë. Më në fund t'u mbush mendja. Apo Donika? Po xha Simoja, hë, ra dakord edhe ai?

— Ç'të bënte! — tha Forja dhe lëshoi të qeshurën e vet. — Pranoi, por më porositi të vij te ti. Ka shumë besim te ti. Le që, e di edhe vetë. Që atëherë në shkollë. E mban mend? — Dhe, pas një heshtjeje të shkurtër, pyeti: — Ti, në sektorin tënd, ke ndonjë vend?

Reshati u mendua. Sektori që drejtonte ishte i ri, dhe kishte ende shumë vende të paplotësuara me njerëz, por ai nuk ishte fort i sigurt se ç'punë mund të bënte Forja.

— Do të bisedoj një herë me shokët, — tha, më shumë që t'i jepte kohë vetes të mendohej. — Por edhe ti, ama, duhet ta vazhdosh shkollën e mesme, hë?

— Shkollën? Po ti e di që unë për shkollë s'ia them. Të mos të kisha ty unë, he-he! As ato shtatë klasë s'do t'i kisha tani.

— Regjistrohuni në shkollën ekonomike të natës.

Forja u mendua pa ua ndarë sytë gishtave të trashë të dorës që e kishte lënë hapur mbi tavolinë.

— Ti, atë shkollë ke mbaruar për veten tënde? — pyeti.

— Po.

Forja po hezitonte.

— Po ti regjistroh u një herë. Fillimi është ca i vështirë. Pastaj ne këtu jemi... — i dha zemër Reshati.

— Do të më ndihmosh, hë?

— Mirë, mirë.

— Kështu edhe bëhet, — tha Forja jo fort i bindur. — Megjithatë kemi kohë. Këtu jemi. Shohim e bëjmë.

U ngrit dhe u drejtua nga dera.

— Unë po iki se të lashë pa punë. E duku ndonjë natë andej nga ne se do të nxjerrim mjal-tin. Kemi rregulluar një makinë centrifuge. Më ka porositur edhe Donika të të them.

— Harrove shportën, — tha Reshati, kur Forja po kapërcente pragun e ulët prej çiment-toje.

— Jo. E kam sjellë për ty.

— Je në vete? — Reshatit i dogjën veshët.  
— Kujt ia bën këto ti, mua?

— E ç'të bëra xhanëm? Të kam sjellë ca fiq. Janë puca nga ata që ke qejf ti.

— Po nuk e di ti që bakshishi...

— E mo, ç'bakshish më thua! Ne jemi shokë, apo jo?

Reshati nuk foli.

Pas dy javëve Fore Farashuku filloi punë si normist pranë sektorit që drejtonte Reshati. Në

të njëjtën kohë u regjistrua në shkollën e natës, Donikën e futi në punë në kooperativë.

Në vjeshtën e vitit 1961, kur Reshati shkoi në Tiranë për të ndjekur shkollën e Partisë, Forja fillonte vitin e tretë të shkollës së mesme. Pas dy vjetësh, kur Reshati u kthye si instruktor në Komitetin e Partisë të Rrethit, Forja e kishte mbaruar shkollën e mesme dhe, meqë ndërmarrrja gjeologjike ishte transferuar në një rreth tjetër, kishte ikur me punë si llogaritar i parë në kooperativën e vogël të Sheherit, e cila e furnizonte qytetin me perime e fruta.

## KAPITULLI VIII

Albani kishte kujtuar se njerëzit që pati takuar herën e parë të furra e Dokë Jemenit ishin grumbulluar atje rastësisht, thjesht për të prituri tavat e vonuara, por një pjesë të tyre e gjeti përsëri atje: vëllanë e gjinekologut, dy futbollistët e tjerë që përtypnin çamçakëz, skulptorin amator Nardi Adhami, si dhe zdruckthtarin Kasem Rahmiu, për të cilin ai vazhdonte të dyshonte se mund të quhej edhe Rahmi Kasemi. Ishin ulur në stolin anash derës së furrës dhe shikonin asfaltin e lagur nga shiu që gjatë gjithë ditës kishte rënë hope-hope. Ai nuk i vuri re edhe dy djem të tjerë, për njërin prej të cilëve ishte i sigurt se ishte elektrikist në komunale, pasi ata ishin ulur në bisht pranë stolit, në anën tjetër.

— U, u! Djali i kryetarit, — filloi Dokë Jemeni. — Na erdhi djali i kryetarit.

— Hi-hi-hi! — qeshi Kasem Rahmiu.

Vëllai i gjinekologut u skuq dhe u shtir sikur nuk kishte dëgjuar. Koço Osumi nxori një paketë me filtër. Katër duar u zgjatën njëkohësisht drejt saj. Dokë Jemeni la tavën brenda në furrë dhe doli në derë duke fshirë duart pas përparësës që ishte bërë pis.

— Po ulu, ulu, — iu drejtua Albanit.

— S'kam kohë, — iu përgjigj Albani. — A mund të më jepni numrin e tavës?

— Uuu! Dashka të na ikë! — tha Dokë Jemeni si me përkëdheli. — Ulu, ulu me ne! Dëgjova që të kanë futur me punë në ndërtim.

Nuk dinte si të bënte. Për të ikur, donte të ikte sa më parë, por në të njëjtën kohë i digjte koka kur përfytyronte se si, ndërsa largohet, ata, me koka të kthyera nga ai, do të fillonin ta përgjonin.

— Vonohet shumë tava? — pyeti.

— Tani e futa. Po bëhet shpejt, se e solle në kohë. Pastaj si për kryetar, ma!

— Hi-hi-hi! — qeshi si për vete me buzën e përveshur Kasem Rahmiu.

Albani u mbështet me shpinë pas murit të pasuvatuar. Në rrugë po kalonte një grua e re që po shtynte përhumbshëm karrocën e fëmijës.

— Inter! — tha Nardi Adhami. Tani Albani e dinte se kjo ishte shprehje e zhargonit të tyre



Iku. Te kthesa e dyqanit ushqimor zbardhte kabina telefonike. Dy vajza ishin futur brenda saj dhe diçka çuqurisnin me receptorin në mes. Albani mbajti këmbët, por pastaj u kujtua se mund ta shikonin (po le ta shikonin, mëdyshoi vetëm për një çast), dhe shpejtoi për në shtëpi. Nga larg dëgjohej një djalë që fishkëllente një motiv poshtë një dritareje.

Albani e hëngri darkën në aneks, ndërsa i ati ndiqte me kureshtje të panevojshme një film. Nëna kishte shkuar në dhomën e gjumit. Lira kishte ulur kokën mbi një libër.

— Ç'e ke atë? — e pyeti ai.

Ajo e ngriti vertikalisht dhe ia tregoi korpertinën pa folur. Ishte botimi i ri i përrallave të Andersenit.

— Hë-hë, — bëri.

Përmes tyllit ndarës të aneksit, shikonte ekranin e televizorit. Një kështjellë. Konti dhe e shoqja kërkonin që motra e këtij të parit të firmoste një testament, sipas të cilit shpallte se hiqte dorë nga çdo e drejtë e saj mbi pasurinë e trashëguar.

Ra zilja e telefonit, por askush nuk u ngrit ta merrte.

Konteshëzën e zbehtë e kishin mbyllur në një prej bodrumeve të thella të kështjellës. E burgosur. E varrosur për së gjalli.

— Lira, kape telefonin.

Lira u ngrit duke bërë një gjest të hapur pakënaqësie.

— Po të jetë Fore Farashuku, i thuaj se nuk jam në shtëpi, — i tha i ati i Lirës dhe Albani nuk u besoi veshëve. U shmang pak dhe e pa të atin në fytyrë. Kishte liruar kollaren, kishte zgjidhur edhe lidhëset e këpucëve dhe, me cigaren që tymonte qetësisht si e harruar në buzë, kishte një pamje të lodhur, gjë që i ndodhte tepër rrallë. Diçka duhet të kishte ndodhur me të kohët e fundit.

Kamera dilte nga kështjella dhe vraponte në një pyll ku ishte fshehur një repart i ushtrisë çlirimtare garibaldine. Njëri prej togerëve të rinj shikonte me dylbi kështjellën ku ishte e dashura e tij, konteshëza e shkretë. Kështjella ishte e heshtur.

Lira u kthye, kur, me një shpurë pas vetes, togeri i ri po shpejtonte drejt kështjellës.

— Kush ishte? — e pyeti Reshati kur pa se ajo nuk kishte ndër mend të fliste.

— Ai pra. — Lira kishte marrë përsëri librin.

— I the që nuk jam?

— I thashë. Do të vijë për vizitë.

— I the që nuk jam këtu?

— I thashë, pra. Tha se do të të presë derisa të vish. Tha vetë, mor ba, — shtoi ajo kur pa fytyrën e pakënaqur të të atit.

— Në këtë orë? — u habit Albani.

— S'ka ç'ju duhet ju, — tha i ati, por tani ishte tepër vonë të mbulonte atë që kishte zbuluar vetë pak më parë. — Shkoni të flini!

Albani u ngrit. I hodhi një vështrim hetues të atit, por i ati u shtir sikur nuk e vuri re, gjithë me sy nga televizori.

Togeri trokiste te porta e rëndë e kështjellës. Tang-tang-tang. Konti dhe e shoqja e shikonin nga dritaret. Të futet vetëm togeri, tha konti, pa shpurën. Dera u hap dhe portieri përsëdyti urdhrin e kontit. Por adjutanti e shtyu dhe eci pas komandantit të tij. Ku shkon? A nuk e dëgjove ti urdhrin e kontit për t'u futur vetëm togeri? Po vetëm togeri ka hyrë, u përgjigj me seriozitet adjutanti, panatyrshëm, unë jam hija e tij.

Ishte pa dyshim një film skematik, i lehtë dhe i punuar fare pa kulturë.

— Natën e mirë! — tha Albani dhe iku për në dhomën e tij duke ndier, kushedi pse, një dhimbje të lehtë në kraharor.

## NJERËZIT PA HIJE

Vazhdim

Në kështjellën pa dritë të kontit Jan Ruli ishin mbledhur burrat më me mend të të gjithë kontesë. Ishin thirrur edhe të tjerë burra të ditur të konteve fqinje me të cilat jetohej në paqe. Ishte atje astrologu i famshëm Ajdonat që e kishte shpëtuar Mezinë nga kolera dhe të zëshmin Vasil Bullgaroktoni nga damllaja, dijetari Niqifor Gregorea i nxjerrë apostafat nga burgu, njohës me themel i Akropolitit, Palimerit dhe Platonit; murgu i lajthitur pas yjeve të padukshme, Vonica Toko, pinjoll i Tokove të famshëm; gatitësi i shpatave, Raul Sambesi, i mbetur në këto vise që nga koha e normanëve, bujku Iza Bua Spata

dhe Jani VI Kantakuzeni, alias murgu Joasef.

Pas dy ditësh e dy netësh diskutimesh, mendjet e tyre dolën më në fund në të njëjtën udhë: të zhdukeshin hijet.

U pi verë dhe u dehën njerëz nga gëzimi. Mirëpo askujt nuk ia paskësh marrë mendja që të paskësh pasur në racën njerëzore nga ata që ëndërronin të kthehej edhe një herë ajo kohë e zezë hijesh gllabëruese. Dhe mendja e këtyre të fundit, e mësuar me të ligën dhe fole ligësish, shpiku diçka të tmershme: këmbalecët. Këmbalecët ishin drurë të lartë me dy biga, ku njeriu mund të vinte këmbët për t'u zgjatur. Sa më lart të ishin bigat, aq më i gjatë bëhej njeriu duke siguruar kështu mundësinë për të dalë sipër të tjerëve. Shpejt ata mësuan të ecnin me këmbalecë. Dhe, hipur mbi to, përvjedhshëm u afroheshin njerëzve të tjerë, përkuleshin duke nxjerrë një hije të gjatë, e cila në çast e gllabëronte qyqarin posht. U bë e padurueshme trokëllima e drunjte e mangallkave nëpër kalldrëmet e ngushta që të shpinin në kështjellë dhe në kalldrëmin e gjerë të rrugës që i binte mespërmes kontesë. As mallkimi në meshën e parë, as mallkimi në të tretën nuk bëri që njerëzit të hiqnin dorë nga marrëzia.

Atëherë u mblodhën sërish njerëzit e ditur në kështjellën e errët dhe, pas tri ditësh e netësh, ranë në një mendje dhe iu drejtuan zotit me kërkesën e dytë: Qielli të ishte përherë i zënë me re, të mos kishte fare diell, gjë që do të thoshte të mos kishte fare hije.

Të nesërmen qielli u vesh me re të zeza e të rënda. Këmbalecët u nxorën menjëherë jashtë përdorimit. Askush nuk mund të fuste në hijen e vet tjetrin, u nxor jashtë përdorimit edhe mallkimi i përbindshëm: «Të shkelsha hijen!» e, bashkë me të për hir të tij, u uruan të gjitha urimet e mallkimet me diell. Tani nuk kishte më mesdita, por muzgje të gjata e të pambarim, të cilat kurrsesi nuk mund t'i quaje mëngjese, e ca më pak perëndime. Deti ndizej i zbehtë dhe shuhej po aq i zbehtë çdo ditë, sikur lëngonte nga një gri e padurueshme.

Kaloi më në fund dimri, por në vend të beharit të shumëpritur, vazhdonte një kohë e keqe me shi e erë. Bimët e mbjella si nëpër terr, nuk arrinin të shpërthenin lule, blerimi i tyre ishte si i sëmurë, sikur sipër së blertës ishte derdhur kazani i madh i së verdhës. Njerëzit po ashtu dukeshin sikur sapo kishin dalë nga ca shtrime nëpër spitale.

Pas një vjeshte po aq të lodhshme, kur qerret ktheheshin bosh nga arat, të diturit u mblodhën sërish. Kolliteshin pa pushim dhe, po të mos ishin çajet e mrekullueshme të kuzhinës së kontit, nuk do të kishin arritur të merreshin vesh kurrë me njëri-tjetrin.

Kaluan tri ditë dhe ata ende nuk kishin dalë nga kështjella. Rojat dhe shërbëtorët thoshin se vazhdonin të pinin çaj, dhe të vrisnin mendjen. Por kishte nga ata zemërkëqij që e përgojnin pa gjë të keq lodhjen e tyre. Hanë e pinë çaj

të kushtueshëm e s'u bie ndër mend për ne, thoshin ata duke përhapur përçark rënkime të venitura.

Dolën pas tre muajsh, kur të gjithë vendin përçark e kishte mbuluar dëbora.

## KAPITULLI IX

Donte edhe 40 minuta që ora të shkonte 12, kur telefonoi Memli Muçostepa dhe tha se Fore Farashuku së bashku me Labo Ajetin po prisnin në paradhomë, sipas porosisë që u kishte lënë vetë.

— U kam thënë në 12, — foli Reshati prerë.

— Domethënë, të presin?

— Të presin, sigurisht, po që se nuk kanë ndonjë gjë tjetër më të mirë për të bërë.

Ishte me humor të mirë. Sapo ishte kthyer nga zonat e përmytura. Uji ishte tërhequr nga fushat dhe kryeagronomi i rrethit që e kishte shoqëruar, ishte i mendimit se gruri mund të mos rimbillej. Koha ishte hapur dhe, po që se mbanin edhe disa ditë me diell, do të kishte mundësi të fillonte ushqimi i pjesshëm i bagëtive me njomi-



shte, gjë që do të rriste edhe prodhimin e qumështit. Mund të thuhej se tashti dimri kishte dalë. Numri i krerëve ishte ruajtur brenda limiteve të parashikuara. Në tufëzat nuk kishin pasur asnjë humbje. Ndoshta do të arrihej që brenda gjashtëmujorit të parë të gjitha brigadat e bujqësisë të vetëfurnizoheshin me produkte blegtorale. Analiza tepër e gjatë e bërë javën e shkuar në drejtorinë e naftës kishte treguar se... Jo, më mirë jo. Ai nuk donte ta prishte humorin e mirë të ditës dhe nuk u shty më tej në arsyetimet për mosmbarëvajtjen e punëve në këtë sektor të rëndësishëm, por të vështirë.

U ngrit dhe ndezi radion. Ishte një radio tepër e madhe e stilit të vjetër, llambat e së cilës, tashmë të rëna, ngroheshin shumë ngadalë. Zëri i saj ishte i thellë dhe i çjerrë. Dikur (ai atëherë ishte nxënës në konvikt), ajo kishte qenë radioja e vetme e gjithë qytetit, që kushedi si ishte gjendur në kafenenë e vogël të Met Peqinit. Dikush këmbëngulte se një radio tjetër ndodhej gjithashtu në gjykatë, por atë nuk e kishte parë njeri. Radioja e Met Peqinit ishte kësisoj, në mos e vetmja radio, e vetmja radio legale popullore. Ishin vitet e para të pushtetit të ri dhe kryetari i pushtetit lokal, një njeri i ndershëm, por pa shkollë, flitej se kishte rënë keq pas asaj radioje. Tregonin se si kryetari ia kishte kërkuar radion Met Peqinit të urtë me të mirë e me të keq, me para në dorë e me pagesë me këste, kishte shkuar deri atje sa i kishte propozuar edhe shkëmbim me mallra të tjera, por

Meti nuk ishte dhënë. Është fati im, thoshte ai, pa pranuar të hynte në arsyetime të thella, duke e lënë të hapur dyshimin se mund ta kishte fituar vërtet, ashtu siç pëshpëritej, në bixhoz. Edhe policit trupmadh, Shaqir Balanit, që, duke dredhur mustaqen e gjatë te banaku, kishte thënë se radio të tilla, të trashëguara nga regjimet antipopullore, ishin strofkulla të propagandës armike, ashtu i ishte përgjigjur Met Peqini. Është fati im dhe do ta vuaj vetë. Një ditë prej ditësh te po ai banak ishte mbështetur Harun Kërtolli së bashku me atë mori profesionesh që ushtronte legalisht dhe ilegalisht. (Thoshin se në çantën e tij të madhe të zezë, krahas veglave për rregullimin e stilografëve, të aparateve fotografike, radiove, makinave qepëse, sendeve elektrike etj., ishte edhe një tub gome, me kokë si të gjarprit, që ai e përdorte për të dështuar ilegalisht gratë, domethënë që provokonte lindje të parakohshme dhe që thirrej me një emër të çuditshëm: Erëletrash, apo diçka e këtij lloji. Pra kishte ardhur Harun Kërtolli, e kishte lënë çantën e madhe sipër banakut dhe ia kishte ngulur sytë radios. Met Peqini, pasi ishte menduar një copë kohë, i kishte vënë përpara një gotë raki. Do të të bëj të ta zërë Arabinë?, e kishte pyetur Harun Kërtolli që ishte shtirur sikur atë çast i kishte ngrënë koka, prandaj kishte shtyrë kapelën e lerosur në një anë dhe kishte filluar ta kruante me thonj. E bën dot ti?, e kishte pyetur Met Peqini, i cili binte përmbys për muzikën arabe. E bëj, kishte ngritur zërin Harun Kërtolli dhe

kishte pushuar së kruari kokën. Met Peqini kishte hapur deriçkën e banakut. Bujrëm, kishte thënë. A, jo, jo këtu. Nuk i kam të gjitha veglat me vete. Këtu ka kartat të hedhura në erë, kishte qeshur dikush në një prej tavolinave, por Met Peqini e kishte parë shtrembër. Edhe Haruni nuk ia ktheu fjalën shakaxhiut. Duroi. Me dy djem të rinj që se si u ndodhën te dera, e mori radion dhe u nis për në shtëpi. Kaloi një javë. Dy. Kaluan tri javë, por Harun Kërtolli nuk e ktheu radion. Sa të gjej një vegël, i thoshte Met Peqinit duke kruar me thonj kokën e vogël. T'i ka futur atë, kartën me erë, i thoshin Metit, por ai nuk deshte ta besonte. Pas dy muajsh, fjala doli: radioja ishte parë në zyrën e kryetarit të lokalitetit. Polici Shaqir Balani solli paratë, por Met Peqini nuk i pranoi. Unë s'kam punë me ty, i tha, kam hesape me atë që i kanë marrë erë kartat e kokës. Por Haruni, që e njihte si gjithë të tjerët inatin e Met Peqinit, kishte rrëmbyer çantën dhe kishte ikur kushedi ku, duke i lënë gruan dhe fëmijët vetëm. Met Peqini u zbut shpejt nga kjo ikje dhe i tha së shoqes t'i dërgonte fjalë të kthehej, se ai nuk kishte ndër mend të merrej me një palo burrë.

Reshati e mbante mend të gjithë historinë dhe, sa herë e sillte ndër mend, vente buzën në gaz. Ndryshe nga sa e kishte gjykuar në rini, tani ai nuk mendonte se kryetari i vjetër kishte bërë një faj të rëndë duke shpërdoruar pushtetin. Ishte diçka krejt tjetër. Nuk ishte përvetësim i paligjshëm, as kompleks madhështie e pushteti. Ishte

diçka tepër e thjeshtë: dashuri për pushtetin e ri, naivitet dhe, mbi të gjitha, humor. Pastaj ai asnjëherë nuk e kishte marrë vesh deri ku kjo histori ishte e vërtetë dhe ku fillonte trillimi.

Trokitën te dera. Reshati pa orën. Ishte fiks 12.

— Po, — tha, — hyni! — dhe nuk e ktheu kokën andej.

— Shoku kryetar, — ky ishte zëri i Fore Farashukut. I druajtur, i urtë, pothuajse i mjerë. — Të vijnë ne?

Reshati nuk iu përgjigj.

— Mirëdita, — tha Labo Ajeti. Reshati e pa me bisht të syrit. Ai qëndronte në këmbë, me duart të lidhura prapa. Vinte i shkurtër dhe shulak. Koka e rrumbullakët dukej sikur ishte vendosur drejtpërsëdrejti mbi shpatulla, pa ndërmjetësinë e qafës, të cilën e kishte fshehur përfundimisht poshtë një jake të lartë këmishe të shtrënguar me një kollare gri të gjerë, të modës së shkuar. Kollarja ishte e spërkatur vende-vende me çërka të shndritshme prej mëndafshi.

— Mirëdita! Uluni!

Fore Farashuku shpejtoi të ulej i pari duke u përpjekur të shpallte në çdo lëvizje se, midis tij dhe Labo Ajetit, nuk ekzistonte asnjë lidhje.

... Biseda që kishin bërë para dy netësh në shtëpi kishte qenë e vështirë.

Reshati e kishte pritur Foren me bezdi të hapur, pa luajtur nga vendi ku ishte ulur për të parë filmin, pjesa e parë e të cilit sapo kishte mbaruar, ashtu, kollareliruar, këpucëzgjidhur.

Ndoshta kishte qenë pikërisht pamja e tij që shpallte një lloj çmobilizimi që atje tej, e cila e kishte bërë Foren ta hidhte poshtë atë lloj mpirjeje dinake, pothuajse hetuese, me të cilën u dha në derë. Fytyra iu zgjerua nga një e qeshur e pakuptim.

— Si u ngryse? — tha duke u shtirur si i gëzuar.

Reshati iu përgjigj me një tundje koke, pa i hequr sytë nga ekrani. Nën një ngjyrë blu të thellë po jepeshin pamje nga parqet natyrore të Islandës. Vende-vende peizazhet turbulloheshin nga avuj të shumtë gajzerësh. Toka dukej e paqëndrueshme, sikur do të çahet nga çasti në çast.

— Sa jam lodhur duke të kërkuar sot, — vazhdoi Forja duke hetuar fytyrën e Reshatit dhe u ul në një kolltuk të lehtë anash tij. — S'lashë vend, s'lashë. Po të mos ju takoja sonte, shumë gjëra do të mbeteshin pa u sqaruar deri në fund.

Tani ekrani ishte veshur krejt me mjegulla gajzerësh. Stopkamera. Zëri i spikerit njoftonte se, pas përfundimit të pjesës së dytë të filmit, tele-shikuesit do të kishin rastin të ndiqnin një emision të plotë rreth parqeve të Islandës.

— Desha t'ju takoja patjetër. Ndryshe është kur i sqaron më parë gjërat, e ndryshe është kur këto biseda bëhen në zyrë. Sidomos kur ke dëshirë që shokut t'ia thuash gjërat hapur me dorë në zemër. — Megjithëse Reshati kishte filluar të shikonte pjesën e dytë të filmit pa ia ndarë sytë ekranit, Forja vazhdonte të fliste. — Këtu, mes sho-

kësh, fjala, sado e rëndë qoftë, nuk mund të të vrasë ashtu siç mund të ndodhë në zyrë në prani të të tjerëve, sidomos në prani të dikujt që mund të mos të dojë fare të mirën. Sepse është e qartë që brenda një kolektivi të ketë edhe nga ata që të duan edhe nga ata që nuk të duan... — Fore Farashuku po djersinte, vuri re kalimthi Reshati, i cili hoqi njërën këmbë nga këpuca dhe e futi poshtë vetes. — Le pastaj të biesh në gojë të atyre që nuk të duan për probleme të tilla, të të dalë emri së bashku me Labo Ajetin...

— Pak a shumë, — e ndërpreu Reshati. — Me sa marr vesh unë, ti do të tërhiqesh, për sa i përket çështjes së Domenika Danit, apo jo?

Fytyra e Fores u zgjerua edhe një herë nga e njëjta lloj e qeshure e jashtme. Djersët që shpesh-toheshin nuk kishin asgjë të përbashkët me të qeshurën.

— Pa-pa-pa! — kishte thënë me një intonacion që të kujtonte një kohë tjetër, e cila dorë-dorës kishte vdekur. — Sa mirë di t'i thuash gjërat ti, shoku Reshat! Unë them njëzet e s'merret vesh ç'them, ti thua një dhe e thua qartë që të mundin ta marrin vesh të gjithë. Kot nuk të kanë vënë për të drejtuar e për t'i dhënë mend një rrethi të tërë, jo!

Reshati liroi edhe një herë kësaj radhe fare pa qenë nevoja kollaren që i varej në gjoks.

— Pa shumë llafe, Fore! — tha me bezdi dhe u kthye sërish nga ekrani.

Reshati zgjati dorën të merrte një cigare nga paketa që kishte lënë mbi tavolinë.

— Prisni, — u hodh një çast Fore Farashuku dhe nga xhepat e thellë të xhakaventos kishte nxjerrë një paketë të jashtme. — Kam cigare të mira, nga ato që të pëlqejnë ty!

Ashtu i kishte thënë edhe vite të shkuara, në zyrën e gjeologjisë, duke i treguar shportën gjysmëzbuluar. Janë fiq puca, nga ata që të pëlqejnë ty!

Reshati mori një cigare nga paketa «Malboro». Atëherë Forja nxori nga njëri prej xhepave, sa shumë xhepa paskësh kjo xhakavento, një pako të vogël.

— Solla diçka të vogël për fëmijët, por s'po i shoh, — tha.

— Ata s'janë më të vegjël, Fore.

— S'janë, u rritën, mashallah, por për ne mbeten gjithmonë fëmijë. E mban mend sa kemi pirë kur të erdhi lajmi për lindjen e Albanit?

Reshati sigurisht që e mbante mend. Ishin te pusi 208, kur punëtori që rrinte te telefoni i kishte thirrur nga larg: Reshat, të të rrojë djali! Ai kishte dashur të pyeste se si ishte e shoqja, por i kishte ardhur turp nga shokët. Ishin futur në klubin e fshatit dhe kishin pirë deri në mesnatë.

— Po Julia si është? — pyeti Forja. Reshati u drodh. Edhe ai ashtu kishte dashur të pyeste atë ditë te pusi 208. Po Julia si është?

— Mirë, — tha duke e mbledhur veten. — Ti

si i ke nga shtëpia? Si po të shkon vajza me studime?

— Jo keq, por se ç'më është ngatërruar me një djalë.

— Epo edhe do të ngatërrohen. Sa vjeçe u bë?

— Nëntëmbëdhjetë.

— E paska kohën.

Në televizor filloi dokumentari që ishte lajmëruar në intermexon mes dy pjesëve të filmit. Nga larg mjegullat e gajzerëve dukeshin si kope të urta me dhen që kullosnin gurishtet yullkanike.

— Me sa duket do të fejohen. Djali është i mirë, babai i punon në ambasadë...

Reshati u shkëput me duf nga ekrani dhe u kthye ballazi nga Forja. Ai e kishte zbërthyer xhakaventon dhe poshtë saj i dukej një pulovër i vjetër leshi.

— Po sikur t'i binte në qafë sat bije një prej pedagogëve, — e pyeti ai duke i hequr sytë nga xhakaventoja. — Si do të bëje ti?

Fore Farashuku ishte skuqur nga veshi në vesh.

— Lëre tani atë muhabet! E bëra atë gafë e iku. Ma mori mendjen Labo Ajeti, pushti, dhe rashë brenda. Gafë e madhe, s'ke ç'i bën! Ç'ma kujton tani?! Ma hodhi! Më tregoi karta e shkresa pa fund. Po ti e di, unë jam me ty, ti e di mirë! Si t'i harroj unë tërë ato që ke bërë për mua? Jam me ty, e pikë!



— Prit një herë, — e ndërpreu Reshati ashpër. — Ç'do të thotë kjo «jam me ty»? Sikur jemi në ndeshje futboll. S'bëhet fjalë këtu në je me mua, me atë apo me këtë, puna është se duhet të dish të gjykosh drejt.

Fore Farashuku i fshiu me dorën mishtore piklat e mëdha të djersës dhe e kapërceu shpejt gjendjen e hutimit që i shkaktoi ndërhyrja e Reshatit.

— Sido që të jetë puna, unë kam qenë, jam e do të mbetem me ty.

— I lëmë deklaratat, — e ndërpreu me nervozizëm Reshati, por me sa duket Forja nuk kishte ndër mend të pushonte:

— Po ja, shoku Reshat, gabon njeriu, gjendet ashtu, bosh, si thua ti dhe gabon. Siç e thonë edhe në atë filmin, gëlltit një lugë çorbë të prishur e pastaj vjell gjithë jetën. Pastaj, kur njeriu e kupton ç'ka bërë, mbase mund të jetë edhe vonë. Nuk them, edhe kështu mund të jetë, por...

— Dëgjo, Fore, — e ndërpreu më me forcë se herët e tjera Reshati. — Të gjitha këto nuk do të kishin asnjë vlerë sikur ti të mos ishe i ri në de-tyrë...

— Po pra, jam i ri, — u duk sikur u mbush për herë të parë me frymë Fore Farashuku.

Reshati bëri sikur nuk e ndjeu tjetrin.

— Veçse ta dish se herë tjetër nuk ke për ta kaluar kaq cekët edhe për arsyen se nuk do të quhesh më «i ri»! Qartë?

— Faleminderit! Shumë faleminderit! — gi-

shtat e tij të mëdhenj po mbërthenin pullat prej meshini të xhakaventos prej kastori. — Gjithë jeta ime është borxhi yt! . . .

Labo Ajeti nxori paketën dhe e ndezi pa ua zgjatur dy të tjerëve. Të paktën mund të kishte kërkuar leje. Kalimthi vështrimi i Reshatit u gërvish në rrëzëllimën e gurit të çmuar të unazës së tij.

— Po? — tha Reshati dhe priti.

— Erdhëm sipas urdhrorit tuaj, — tha Labo Ajeti. Në zërin e tij kishte një siguri të habitshme.

— Dhe nuk e dini pse ju kam thirrur?

Fore Farashuku u mbështet pas ndenjësës së kolltukut, sikur donte të lejonte që fjalët e fundit të Reshatit të kalonin te tjetri, pa ndërmjetësinë e tij.

— Jo, — tha Labo Ajeti. — Unë kam qenë në një dasmë dhe nuk kam mundur të marr me mend se ç'mund të ketë ndodhur gjatë këtyre ditëve.

— Ti, — iu kthye Reshat Zagora Fore Farashukut, — nuk e sqarove shokun pse ju kam thirrur?

— Thashë se do të ishte më mirë t'ia thoshit ju vetë, — tha Fore Farashuku duke ngritur supet.

— Hëm, — bëri Reshati, — ju kam thirrur të dy, — ai i mëshoi zërit fort kur tha «të dy», — t'ju tërheq vërejtje për qëndrimin e mbajtur ndaj punëtores Domenika Dani.

Labo Ajeti ngriti sytë dhe pa me habi një herë nga Reshati, pastaj edhe nga Forja, por ky i fundit nuk e ktheu fare fytyrën nga shoku. Diçka u lëkund në qëndrimin solemn të Labo Ajetit, por Reshati vuri re se edhe lëkundja ishte pothuajse solemne dhe i ngjante lëkundjes së një tribune.

— Keni gjë për të më sqaruar? — pyeti Reshati.

— Unë s'e marr vesh këtë punë, — tha Labo Ajeti. — Ajo ka kaq muaj që është pushuar nga puna dhe ju e zhvarrosni çështjen e saj tani. Çdo gjë, ju siguroj, është bërë konform ligjeve të shtetit.

— Kurse unë mendoj se çdo gjë është bërë duke u fshehur pas ligjeve të shtetit.

— Nuk e dija se ligjet e shtetit mund të kenë aftësinë për të fshehur pas vetes diçka të keqe, nëse ju keni parasysh pikërisht diçka të tillë.

— Tamam. Madje më shumë se kaq. Të shëmtuar dhe të poshtër. — Fore Farashuku tundte kokën në shenjë miratimi pas çdo fjale që thoshte Reshati. — Prandaj, para se t'ia bëj prezent çështjen Komitetit Ekzekutiv në mbledhjen e muajit, ju thirra t'ju vë në dijeni se që të dy keni gabuar rëndë. Ti, shoku Labo, je sjellë si feudal dhe, po që se vërtetohet, edhe më keq akoma, kurse ti, shoku Fore, je treguar kompromisaxhi dhe sylesh në gjykimin e çështjes që t'u besua.

— Ajo është një femër e dyshimtë, — tha Labo Ajeti dinjitar. — Dhe ju, shoku Reshat, të më falni për konsideratën që po jap, po e gjykoni

çështjen shpejtuar. Shoku Fore, që i hyri punës me themel, u bashkua, sikundër e dini, me vendimin tim.

— A, jo, — u hodh Fore Farashuku duke mos vështruar nga shoku, — mua më more në qafë ti. Ja, po ia them përsëri edhe një herë shokut Reshat në sytë e tu.

Labo Ajeti nënqeshi hidhur.

— Më serioz, më serioz, shoku Fore, — tha me ironi dhe u ngrit nga vendi. — Ju, — iu drejtua Reshatit, — mund të bëni ç'të doni dhe gjithë sa keni në dorë. Mua më varët një këmborë në qafë dhe e tunda si dija, por ama e tunda me qafën time. Kam zbatuar ligjet e shtetit, kjo është e gjitha. Ju, po të doni që punët në ndërmarrje të bëhen çorap, mund ta ktheni përsëri në punë Domenika Danin, por ja ku po jua them, unë nuk ulem më në një rast të tillë në karrigen e drejtorit...

— Prit, prit një herë, — u hodh Fore Farashuku. — Kush të tha se do të shkojë puna deri aty?

Labo Ajeti bëri sikur nuk e dëgjoi. Me sy nga Reshati, tha:

— Ju jeni i madh dhe e ktheni lumin nga të doni. Keni gjë tjetër për të më thënë mua?

Reshatit i buçisnin veshët nga inati. I përtypi fjalët që përpiqeshin të formonin të shara të njëpasnjëshme dhe dikur tha ngadalë:

— Në djall!

Labo Ajeti ngriti njërën vetull me qesëndi.

— Këtë s'ta pata borxh, më duket.

— Përjashta! — Kësaj radhe zëri ishte i plotë.

Pa e ulur vetullën, Labo Ajeti u kthye dhe eci me hapa të rëndë drejt derës. Pas vetes lëshonte një zhurmërimë çelësash dhe nga gishti i mesit të dorës së djathtë që luante me ta pas shpine, hidhej kohë më kohë në ajrin e nderë të zyrës rrëzëllima e lehtë e guri të unazës.

Reshati e shikonte në heshtje. Kishte pasur të drejtë pak më parë kur kishte menduar se ai do të dinte që edhe kur të binte, rënien ta kishte solemne.

— Hë, kishte kujtuar se do ta tradhëtoja shokun tim për hatrin e tij! — tha Fore Farashuku, për fjalët kaluan në trurin e nxehur të Reshatit pa arritur të bënin hije.

— Mund të shkosh edhe ti! — tha.

Fore Farashuku u ngrit dhe e vendosi kolltukun e lehtë në vendin e vet.

— Do të vini të pimë një kafe?

— Jo.

— Sigurisht, — ai nguroi pak, pastaj vazhdoi, — ju nuk do ta pushoni, apo jo? — në zë kishte një shqetësim mbi normalin.

— Shoku Fore, shko! Këto gjëra nuk venaosen sot!

Fore Farashuku po mbërthente xhakaventon. Kopsat e saj prej lëkure ishin punuar me shije të veçantë.

— Ju bëtë shantazh, apo jo? Më mirë është ta trembësh një njeri, sesa ta vrasësh, — po dër-

dëlliste Forja. — Sot, më kanë treguar, është i modës shantazhi. Ja, merr armën bërthamore ti. Ajo nuk është përdorur që më 1945, por shantazhi bërthamor sa e sa ka vlarë. Me mijëra. Ka nënshtruar shtete. Ka thyer ushtri të tëra, pa i prekur me majë të gishtit. . . — Përpyekja e Fores për të mbuluar shqetësimin me fjalë, ishte qesharake.

— Kaq shumë të intereson ty mosshkarkimi i Labo Ajetit? — e ndërpreu Reshati.

Duart e Fore Farashukut mbetën pa lëvizur një çast mbi pullat prej meshini. Fytyra e gjerë ngriu. Madje edhe flokët, sikur u rënduan nga një shi i rëndë dhe i padukshëm.

— Mua? Hiç fare! Ta thashë një herë, unë jam me ty. Si mund t'i harroj unë ato që ti ke bërë për ne? Edhe Donika njëqind herë më ka porositur. . .

— Mirë, Fore, mirë. Ditën e mirë!

— Ditën e mirë, shoku Reshat!

Pa dalë ende mirë Fore Farashuku, Reshati i kishte telefonuar Memliut.

— Më gjej pak, kudo që të jetë, kryetarin e gjykatës dhe ma lidh në telefon, — i tha prerë.

Pas gjysmë ore Memliu e njoftoi se kryetari i gjykatës ndodhej në Tiranë, por mund të fliste me njërin prej gjykatësve.

— Ç'mund të më thuash për gjyqin mes Labo Ajetit dhe shitëses Domenika Dani? — e pyeti Reshati kur u sigurua që lidhja ishte vendosur.

Gjykatësi nuk foli menjëherë. Linja fishkëllente.

— Apo nuk e ke të lehtë?

— Pikërisht. Dhe arsyet janë dy. Më dëgjoni?

— Po. Vazhdo.

— E para, nuk është një çështje me të cilën jam marrë unë direkt dhe e dyta, vetë gjyqi nuk e ka të lehtë të arrijë në një përfundim të qartë.

— Pse?

— Fillimisht nisi si një gjyq për kthim në punë, por, që në seancën e parë punët shkuan thellë dhe hynë në udhë pa krye.

— Është hapur problemi i marrëdhënieve intime, domethënë i akuzës që bën Domenika Dani për shfrytëzim pozite?

— Pikërisht. Dëshmitarët herë vijnë e herë jo. Këto janë gjëra që është e vështirë të vërtetohen.

— Po. Dhe është e domosdoshme që të vërtetohen?

— Patjetër.

— Po ligji ç'parashikon?

— Juridikisht ligji është i qartë, por në realitet...

— Ju mendoni, — e ndërpreu Reshati, — se një grua, thjesht për të arritur një qëllim, cilido qoftë ai, do të pranonte të krijonte me dorën e saj një thashethemnajë të tillë?

— Ju doni të thoni se Labo Ajeti është fajtor?

— Unë nuk dua të them asgjë, thjesht ju pyes: A do ta bënte këtë një grua?

— Gjyqi nuk mund të merret me hamendësime të tilla, — tani gjykatësi duhet të kishte vënë

buzën në gaz, pasi fjalët ishin më të hapura, — ai gjykon faktet.

— Pse, nuk është fakt njeriu, psikologjia e tij, vendosja e kësaj psikologjie në një rrafsh të caktuar kohor e shoqëror?

— Njeriu, sigurisht që është fakt, madje fakti kryesor, — me sa duket gjykatësi nuk e kishte kuptuar pyetjen dhe dha një përgjigje evazive.

Reshati e kuptoi se do ta kishin të vështirë të sqaroheshin në telefon dhe pyeti:

— Ku gjendesh tani?

— Në kooperativën «Rruga e Leninit». Pas gjysmë ore kam një gjyq.

— Është i gjatë?

— S'besoj. Punë vjedhjeje, po kemi menduar t'i japim karakter pullor.

— Shumë mirë! Takohemi dot në mbrëmje?

— Sigurisht. T'ju telefonoj?

— Po. Të vafte mbarë!

— Faleminderit! Ndërkohë do të lidhem me gjykatën dhe, kur të takohemi, do t'ju sqaroj saktësisht, besoj.

— Mirë! Pas orës gjashtë unë jam në zyrë. Po ju pres.

Pa e ulur receptorin, Reshati krijoi numrin e përgjegjësit të administratës dhe kërkoi t'i sillte procesverbalet e dy vjetëve të fundit të Komitetit Ekzekutiv, të atyre mbledhjeve ku ishte marrë në shqyrtim, tërësisht apo pjesërisht, ndërmarrja tregtare dhe seksioni i tregtisë. Ndërsa e sqaronte Hito Sporean, te dera e ndërmjetme u fut Memli



Muqostepa. Kur pa se Reshati po fliste në telefon, ai bëri të tërhiqej për në zyrën e tij, por Reshati i bëri shenjë me dorë që të priste. Sytë e tij përtej xhamave të syzeve ishin si të përhumbur. Në dorë mbante një cigare me filtër të pandezur. Rrezet e diellit që futeshin nga dritaret e mëdha përthyeshin në xhamat e trashë të syzeve dhe krijonin dy pika të shndritshme në cepat e syve të tij.

— E përfundove informacionin për Kryeministrinë? — pyeti Reshati pasi mbaroi bisedën telefonike.

— Po.

— I ke sqaruar të gjitha propozimet tona në lidhje me pagat e punëtorëve të naftës?

— Po. Sipas studimit që më dhatë.

— Sille ta firmos.

— Mirë, — tha Memliu, por nuk u ngrit nga vendi.

Një copë kohë u bë heshtje.

— Po merreni me çështjen e shitëses Domenika Dani? — pyeti më në fund Memliu.

— Pse ti mendon se nuk duhet të merrem?

— Përkundrazi.

— Atëherë?

Memliu u ngrit duke fërkuar ballin me dy gishtat e dorës së djathtë. Diçka donte të thoshte, por hezitonte. U nis drejt derës.

— Memli.

Memliu u kthye ngadalë. Nxori një shkrepëse nga xhepi i jelekut bezhë dhe i dha zjarr cigares. E fiku kunjën duke e tundur në erë, pastaj e futi

përsëri në kuti. Hoqi syzet dhe i lëshoi mbi tavolinën e gjatë. Dy pikëzat e dritëzës kishin ikur tani mbi syprinën e tavolinës dhe sytë e tij pa to dukeshin si të pajetë.

— Fol! — tha Reshati dhe u mbështet me të gjithë shpinën pas kolltukut të lartë. Brinjët i krisën.

— Shkojmë të pimë nga një kafe në pallatin e kulturës? — pyeti Memliu dhe vuri syzet. — Bisedojmë atje. Sesi më duket këtu në zyrë.

Reshati i hodhi një sy zyrës.

— Si?

— Dua të flas me Reshatin, jo me kryetarin.

— Pse, kaq të ndarë qenkan për ty këta të dy?

— Nganjëherë.

— Po tani?

Memliu ngriti supet në mënyrë të papërcaktuar. Ai nuk tha «po», por nuk ishte nevoja. Reshati u ngrit dhe eci pas Memliut me një ndjenjë të pashpjegueshme prej nxënësi.

Për shkak të dritës së bollshme që futej në zyrën e madhe, korridori i gjatë dukej si në gjysmëterr.

## NDËRKAPITULL

(ose parahistori)

*Plaku thahej çdo ditë e më shumë, mendjen e kishte humbur, por vazhdonte të jetonte, sikur kishte vendosur të kalbej mbi tokë. Donika, me sa duket e mërzitur nga shërbimet që duhet t'i bënte atij, dy herë kishte marrë fëmijët dhe kishte ikur te njerëzit e saj, në një fshat malor, por të dyja herët, pas një mungese të shkurtër, ishte kthyer përsëri. Pikërisht në një prej këtyre mungesave Reshati kishte përshtypjen se e kishte takuar Foren.*

*Po kthehej nga fshati ku, pas iniciativës që kishte marrë ndërsa punonte në Komitetin e Partisë, kishte pothuajse dy vjet që shërbente si përgjegjës i planit. Binte një shi i imët dhe i ftohtë.*

Mbështjellë me peliçen e rënduar nga uji, rrintë në anë të rrugës automobilistike, mbështetur pas një shtylle telefonike. Julia i kishte telefonuar pak pas drekës se Albani ishte me temperaturë të lartë dhe, pavarësisht nga mjekimet, temperatura nuk po i binte. Kishte më shumë se dy orë që priste. Po bëhej mbrëmje dhe rruga e shkretë nuk e shtynte të mendonte asgjë të mirë. Lëvizja ritmike e puseve të vjetra të naftës, e ngathët si lëvizje reptilesh prehistorike, ua shtonte edhe më shumë trishtimin peizazheve dimërike. I kishte thënë kryetari i kooperativës të merrte të paktën një karrocë, por ai nuk kishte pranuar. Kot nuk kishte pranuar. Dhe tani mendonte se duhej të kthehej sërish në fshat ku e priste një natë e ankthshme në dhomën e ftohtë... Pikërisht kur po mendonte këtë, në luginën e shtrirë u dëgjua një shungullimë e mbytur, e ngjashme me zhurmërimën e një përroi malor dhe pas pak në kthesë u shfaq një Skodë shytë. Reshati i dha një të shtyrë vetes me shpatullën e majtë dhe doli në rrugë.

Makina ndaloi dhe ai, pa e ngritur kokën, u hodh në karrocëri përmes shiut që ishte shtuar atë çast.

— Hipe? — thirrën që nga kabina.

— Ec! — iu përgjigj ai.

Makina u nis, por pas 10-15 metrash ndaloi përsëri. U hap xhami i kabinës dhe një dorë e madhe nxori përjashta një mushama.

— O Reshat! — i thirrën.

— *Ûrdhëro?* — *Ai ishte mbledhur galiç pas kabinës.*

— *Merre, merre këtë se u bëre qull!*

*Ndërsa zgjatej të merrte mushamanë, ai pa se dora e madhe kishte ca pika të kuqe dhe iu kujtuan duart e bostanxhiut plak.*

— *Ti, Fore, je?* — *pyeti me zë të lartë, por nga kabina nuk iu përgjigjën. Makina kishte uturirë dhe ata brenda nuk e kishin dëgjuar. Po mbase edhe nuk ishte dora e Fores. Ishte pothuajse muzg. Megjithatë sesi i dukej. Po të ishte Forja, pse të mos i përgjigjej? U afrua te dritarja e vogël në shpinë të kabinës, por një perde e hollë nuk e lejonte të shikonte brenda. Edhe po qe se brenda ishte me të vërtetë Fore Farashuku, ai nuk kishte të drejtë t'i kërkonte diçka më shumë. Kishin ndaluar, e kishin marrë. Me siguri që në kabinë nuk kishin vende të lira... U ul sërish galiç kësaj radhe poshtë mushamasë së madhe, duke u përpjekur t'i shmangej sa më shumë shiut të pjerrët. Atëherë kishte parë pranë vetes një makinë centrifugë për heqjen e mjaltit prej hojeve. A thua të ishte e Fore Farashukut? Pse nuk i ishte përgjigjur atëherë? Po të ishte Forja, me siguri që do t'i kishte folur. Megjithatë ajo dorë dhe ato pika të kuqe...*

*Makina hyri në qytet kur ishte bërë përfundimisht natë dhe ndaloi përpara thertores. Reshati u hodh nga karrocëria, hoqi mushamanë dhe ia zgjati shoferit. Brenda kabinës ishte terr dhe njerëzit nuk flisnin. Reshati futi dorën e lagur në xhep për të nxjerrë paratë.*

— Lëri ato, lëri, Reshat! Natën e mirë!

Makina u nis në rrugën pa drita që ngjitej për në Sheher. Ku kishte humbur kaq kohë ky Fore Farashuku? I zënë me punët në kooperativën e re, pothuajse e kishte harruar fare Foren, por dhe ai nuk qe bërë fare i gjallë.

Rreth një vit më pas ai iku në një rreth tjetër si sekretar i Komitetit të Partisë dhe u kthye vetëm në vitin 1977, në detyrën e nënkryetarit të komitetit. Foren e takoi që javën e parë. Ishte një mbledhje me punonjësit e financës. Nga presidiumi ku ishte ulur, Reshati shikonte duart e mëdha të Fores që mbanin shënime në bllok. Të ngjathëta, qimeverdha, me pikla të kuqe... Kur mbaroi mbledhja ai e kërkoi me sy nëpër korridore, por nuk e gjeti. I thanë se ishte nisur menjëherë së bashku me kryetarin e kooperativës. Tani jetonte në fshatin ku punonte, i ati i kishte vdekur dy vjet të shkuar, shtëpinë në Shehër e kishte shitur, Donika, pas përfundimit të shkollës së mesme pedagogjike, kishte filluar të punonte si edukatore kopshti. Po Andrea?, e pyeti ai shefin e financës të rrethit që po i tregonte. Shefi ngriti supet. Ç'ishte ky? A, po, ti nuk e njeh! E njoh shumë mirë, kishte kundërshtuar shefi. I kam genë edhe në shtëpi. Ka bërë jo shtëpi, por vilë. Merret edhe me bletari. I vjen ndoresh për gjithçka, vetëm se me punë... Sa i shkathët është në shtëpi, aq i ngathët është në punë. Çudi, sikur janë dy njerëz! Është njeri energjik, por duhet të dish të zgjosh energjitë e tij, dëgjoi Reshati pothuajse

*i habitur që këto fjalë po i thoshte ai vetë, por nga sytë nuk i hiqej që nuk i hiqej një makinë centrifugë në një karroceri makine, në një muzg të ftohtë me shi.*

*Po atë mbrëmje gjeti në shtëpi një kuti plastike plot me mjaltë. E kishte sjellë Fore Farashuku së bashku me një copë letër ku i kërkonte të falur që nuk ishte dukur për një kohë kaq të gjatë, por fshati ishte larg, punë kishte shumë, Donika vuante nga një migrenë rebele dhe fëmijët donin tepër kujdes tani. I uronte gjithë të mirat. Edhe atë natë kishte dashur të qëndronte, të kujtonin të shkuarën, por nuk mund të rrinte pasi në shtëpi nuk u kishte thënë dhe e prisnin. Po këtu ishin, do të hynin e do të dilnin...*

*— Ta kishte mbajtur për darkë, — i tha ai Julisë, pasi mbaroi së lexuari letrën. — Ne jemi rritur bashkë!*

*Julia ngriti supet në mënyrë të papërcaktuar.*

*Pastaj, kur ranë të flinin, i tha të shoqit:*

*— Ku kishte humbur kaq e kaq vjet ky Forja?*

*Ishte radha e Reshatit të ngrinte supet.*

*— Puna, — tha pastaj. — Të kam treguar për të vëllanë, Andrean?*

*— Po. Ai aventurieri që deshi të sfidonte Xhek Londonin.*

*Reshatit nuk i erdhi mirë për shpotinë e Julisë, por në thelb ajo kishte të drejtë dhe nuk e kundërshtoi.*

*— Në fakt, — tha ai mendueshëm, — reak-*

sioni i Andreas ndaj atij mjedisi mbytës kishte diçka të lakmueshme. Ti, sado mirë të ta tregoj unë, nuk mund ta marrësh me mend se si jetonin. Të kam treguar për të atin që i numëronte grumbujt e bajgave për të verifikuar se mos i biri gënjente? Prandaj më vjen keq për Foren. Pastaj, edhe njeri i keq nuk është, apo jo?

Julia me sytë mbi librin e hapur përpara nuk fliste.

— Ti nuk më dëgjon? — tha ai me një theks të lehtë pakënaqësie.

Julia e la librin dhe u kthye nga i shoqi.

— Sikur të të thosha të kundërtën, do të më dëgjoje vallë?

— Sidoqoftë...

— Mirë, atëherë, do të të them ç'mendoj unë për të? Është njeri i paaftë, tip mastiçi që di të ngjitet atje ku i leverdis.

— Në ç'kuptim?

— Në kuptimin e plotë të fjalës. A nuk të duket se e ke duruar gjatë pas vetes?

Për pak kohë u bë heshtje, por Julia nuk iu kthye librit të saj.

— E di si është puna, — tha dikur Reshati. — Jo se unë nuk i di disa dobësi të Fore Farashukut, por në të njëjtën kohë mendoj se, ashtu si te çdo njeri tjetër, edhe tek ai ka një pjesë të madhe të mirë, energji të fshehura, aftësi, që për një arsye a një tjetër kanë mbetur në hije. E gjithë puna është në ç'kënd do ta shohësh njeriun, nga ana e tij e mirë, apo nga ana e keqe. Dhe, pastaj, sipas



këndvështrimit që ke zgjedhur, vlerëson dhe aktivizon tek ai të mirën apo të keqen.

— A nuk të duket pak fetar ky gjykimi yt? I mirë, i keq. Kaq sa i mirë, sa i keq. Sikur jemi në kishë!

— Jo. Mendoj se ky është gjykim materialist dhe realist, jetësor dhe i vërtetë. Pse u dashka që, sa herë të përmenden termat i mirë dhe i keq t'u vëmë gjykimeve damkën fetare?

Julia ngriti supet.

— Këtu nuk është thjesht punë termash. Nejsë, ti e di! Unë nuk e honeps dot Foren! Nuk e di, sesi më duken njerëz si ai, të pengojnë të lëvizësh, sikur të hedhin hijen. Po ti ke stomak të fortë. Mbase ashtu ta do edhe puna.

Pas nja dy javëve Forja bëri vizitën e parë së bashku me të shoqen. Donika ishte tharë, sytë i kishte vazhdimisht të kuq dhe qerpikët i ishin rralluar sikur i kishte shkukur gabimisht me pinceta, në një inat të pakuptueshëm ndaj vetes. Pas gotës së dytë Forja erdhi në qejf dhe filloi të tregonte për Sheherin, për të atin, Andrean, qytetin e fëmijërisë së tyre. Me gjithë përppjekjet e Julisë, Donika nuk u gjallërua. As hëngri e as piu. Rrinte me sy të ngulur në sofrabezin me kuadrate dhe dukej sikur vazhdimisht bënte një llogari të gjatë e të mundimshme që nuk i delte: Mbase nga shkakku i asaj migrenës kronike që kishte. Ikën afër mesnatës. Reshati u përpoq t'i mbante për të fjetur, por ata nuk pranuan. Kishin fëmijët vetëm dhe përjashta i priste makina e kooperativës.

— Të na vini përsëri, — tha Reshati kur po ndaheshin.

— A, jo, — tha me të folurën e tij zhurmëmadhe Forja. — Tani është radha juaj. Ju presim të na vini në fshat. Le që mund të kemi së shpejti edhe ndonjë sebeb.

— Ç'sebeb?

Forja pa nga e shoqja.

— Po ja, — tha ajo sikur po recitonte. — Forja ka qejf të ndjekë shkollën e lartë.

— Ashtu? Më bëhet qejfi. Më bëhet qejfi jashtëzakonisht. Do të bisedoj edhe unë me ata të seksionit të arsimit.

— Ah, sikur ta bënit këtë! Sepse, tani dihet, nuk ecet pa shkollë. Tashti do ta kem pak të vështirë, se, helbete, mosha po më kalon, po me vullnet, me vullnet...

U deshën plot shtatë vjet që Fore Farashuku të mbaronte shkollën e lartë. Ndërkaq Reshati ishte emëruar kryetar komiteti. Në të vërtetë punët në kooperativën ku punonte Fore Farashuku nuk shkonin edhe aq mbarë, sidomos në sektorin që drejtonte ai, por, ca ngaqë ishte mik i Reshatit, ca ngaqë vazhdonte studimet, ekipet nuk i binin ndesh. Sigurisht, këto Reshati nuk kishte si t'i dinte. Kur Forja mori diplomën, shtroi një darkë në të cilën Reshati shkoi së bashku me Julinë. Kishin ardhur edhe dy pedagogë të fakultetit që pinin pa masë. Sytë e Donikës ishin si të përskurur anash. Vazhdimisht, Fëmijët rrinin urtë në divanin e aneksit.

## KAPITULLI X

Reshati kërkoi me sy Julinë mes zallahisë së festuesve dhe i pa flokët e saj të mbledhur topuz diku pas banakut ku shërbente një vajzë e bukur me mollëza të theksuara dhe sy të kaltër të thellë. U përpoq të kalonte, por, sapo bëri dy hapa, filloi muzika dhe Natale Balani që iu ndodh pranë, i kërkoi të vallëzonin bashkë. Ai i tregoi cigaren e nderur që kishte në dorë, por ajo i tha se mund të vallëzonin edhe ashtu. Rreth tyre u krijuan gjithashtu çifte të shumta vallëzuesish. Natale Balani luante shumë lehtë. Dikush e shtyu lehtë me shpinë, u dëgjua në çast një zë i ngjirur që kërkonte të falur, por ai nuk e ktheu kokën t'i përgjigjej.

— Gjithmonë më ka bërë përshtypje sa lehtë

vallëzoni, — po thoshte Natale Balani. Edhe të folurit e saj ashtu si e gjithë ajo festë kishte diçka artificiale.

— Kujtoja se me kalimin e viteve do të ngathësohesha, — tha Reshati, — dhe në të vërtetë jam ngathtësuar.

Natale Balani anoi kokën lehtë. Reshati i hoqi sytë me të shpejtë dhe i brodhi nëpër muret e sallës së vogël të aneksit të turizmit. Për një çast pa pikturën e vogël që paraqiste qytetin e vjetër. Për t'i dhënë tone moderne ceremonisë së fejesës të së bijës, Fore Farashuku kishte marrë masa të shumta. Në aneksin e turizmit ku ishin futur të ftuarit ishin hequr karriget dhe shërbehej drejt e në banak. Në ato pak tavolina të lëna qosheve të sallës së vogël mund të lije gota boshe të pijes. Tre-katër kamerierë të panevojshëm rrinin si të ngrirë mbështetur pas mureve. Nuk e pati të vështirë të gjente konviktin në pikturë. Kisha pa Emër. Xhamia. Rruga e të dehurve, ose rruga e kafeneve. Shtëpia e madhe e Ajçes. Me dritare të vogla dukej si e verbër. Dyqani i Met Peqinit. Kinemaja ku kishte punuar Harun Kërtolli. Posta. Shtëpia e veçantë e Dervish pashë Dacit që po kthehej në muze etnografik. Berberhana. . . Cen Balani, vëllai i madh i Natales, kishte punuar për njëfarë kohe si berber. Shtëpinë e tyre e kishin qëlluar xhindet me gurë për shkak të dashurisë së tij me Zhani dentisten nga Saranda. Atij i ishte thelluar kriza nervore dhe kishte vite që nuk dilte nga shtëpia.

— Si është Ceni? — e pyeti Natalen. Ndoshta, i shtyrë nga dëshira për ta sfiduar artificin e asaj ceremonie, ai kishte qejf të fliste për gjëra reale e të vrazhda.

— Ashtu, si përherë. Tani, në behar, ka ç'bën. Merret me lulet në oborr, por dimri e lodh shumë.

— S'u shërua që s'u shërua, — tha Reshati me keqardhje.

Natale Balani ngriti supet. Tani rrjeta e pamëshirshme e joshjes kishte rënë dhe fytyra e saj ishte bërë e ftohtë. Në anë të ballit i kishin kërcyer dy degëzime damarësh blu që tundeshin si fundet e dy lidhëseve të mëndafshta ku pak më parë ishte lidhur rrjeta. Poshtë mollëzave të gishtave Reshati ndjeu që edhe shpina e saj u ngurtësua.

— Vazhdon të jetë me raport?

— Po.

— E mban mend kur jua qëllonin çatinë me gurë?

Natalja buzëqeshi me vështirësi. Ndoshta nuk duhet ta kishte pyetur ashtu, drejtpërsëdrejti. Cen Balani, pasi ishte shëruar nga dashuria për Zhanin, kishte filluar të bënte shëtitje të gjata me biçikletë përreth qytetit. Një mëngjes në hekurin e timonit kishte vënë një rreth metalik. Të gjithë kishin kujtuar se ishte një pasqyrë, gjë e zakonshme për ato kohë, por pas dy orësh në të gjithë qytetin u hap fjala se në vend të pasqyrës, në atë rreth metalik të praruar prej metali, ai kishte vënë fotografinë e një femre që qeshte. Me

keqardhje thoshin se femra e fotografisë i ngjante jashtë mase Zhani dentistes. Dhe Ceni nuk e mori më veten.

— Ti ke qenë e vogël atëherë, — tha Reshati.

— Kur? — Me sa duket ajo nuk e kishte mendjen aty.

— Kur qëllonin me gurë.

— Jo edhe aq. E mbaj mend.

— Xhindet, — tha ajo duke qeshur me vësh-tirësi, sikur donte t'i thoshte: «Mund ta ndërroni këtë bisedë? Nuk e shihni se kjo po më lodh?» Ndoshta ajo ishte nga të paktët njerëz të sallës që e kishte pranuar panatyrshmërinë e ceremonisë dhe këtë e kishte paguar duke u bërë edhe vetë disi e panatyrshme.

I ishin afruar banakut. Julia po bisedonte me Greta Tytymçen. Qysh nga ajo kohë kur kishin punuar në një shkollë, ato e ruanin miqësinë. Reshati kapi një vështrim të beftë të së shoqes që rrëshqiti në drejtim të atyre të dyve.

— Atëherë ti ke qenë e vogël, — i tha ai Natales me zë të lartë që të mundte ta dëgjonte Julia. — Por unë mendoj se duhet të ketë qëlluar dikush që nuk e pëlqente dashurinë e Cenit për Zhanin.

— Ose dikush të cilit në përgjithësi nuk i pëlqente dashuria, — tha gjithë panatyrshëm Natale Balani dhe, si për të vulosur këtë panatyrshmëri, shtoi pa ndonjë lidhje: — Sigurisht!

— Do të merrni gjë? — pyeti vajza e banakut. Ajo i kishte lyer shumë buzët që dukeshin

sikur do të kullonin sipër gotave të shumta që kishte përpara.

Natalja mori një akulllore në kupë, kurse Reshati një limonadë të gazuar, megjithëse do të kishte dëshiruar më mirë një gotë pije.

— Njiheni me Julinë? — e pyeti ai.

Natalja lëpiu buzët me gjuhën e hollë, u duk sikur diçka donte të thoshte, por, me sa duket, ndërroi mendje dhe u kufizua vetëm me një tundje koke që mund ta merrje si të doje. Një dorë e padukshme po shpejtonte ta lidhte pas fjongove të kaltra rrjetën e rrezikshme.

Mbaroi vallëzimi dhe drejt banakut vërshuan njerëz të djersitur që dihasnin dhe flisnin me zë të lartë. Kishte një kontraktim qesharak në të sjellit e tyre.

— Eja, — tha Reshati dhe, me gotën e përgjysmuar të limonadës në dorë, i hapi rrugë drejt vendit ku ishte Julia me Greta Tytymçen.

— Njiheni? — pyeti ai duke parë nga e shoqja.

Gratë i dhanë dorën njëra-tjetrës.

— Natale... Balani? — pyeti pak e shtirur Julia.

— Po. — Edhe Natalja iu përgjigj me po atë intonacion.

Reshatit iu qesh dhe ktheu kokën anash. Piu pak limonadë. Mund t'i kishin hedhur më pak sheqer.

— I fortë Fore Farashuku! — tha Greta Tytymçja me ironi.

Reshati ktheu kokën dhe pa se ajo ishte drejtuar atij.

— Pse?

— Juve nuk ju duket kështu? I ka dhënë ceremonisë ngjyra tepër moderne, — ajo e tha fjalën e fundit sikur po e pickonte. — Nuk do të ma kishte marrë kurrë mendja se do të kishin ecur kaq shumë përpara shijet e tij. S'ta linte atë përshtypje, — shtoi dhe piu pak nga gota që kishin në dorë.

— Ç'po pi?

Greta ngriti supet.

— Një pije me shumë sheqer, — tha.

— Vërtet, shumë sheqer ka.

— Ku?

— Kudo. Domethënë në pije e rreth e qark. Në ceremoni, muzikë... Kudo.

— Janë aftësitë e bletërritësit. E mbaj mend, kohë më parë, kur ende nuk kishin dalë insekticidet, merrnin një copër letër, e lyenin me mjaltë dhe mizat e mushkonjat, të joshura nga ëmbëlsia, mbeteshin të ngjitura atje. Kjo ishte një lloj vdekjeje e ëmbël. Një lloj vrasjeje e ëmbël. E mban mend ti?

— Sigurisht, — tha me bezdi Reshati dhe liroi kollaren me dorën e lirë. — Si shkon Sandri?

— pyeti për të ndërruar rrjedhën e bisedës.

— Ashtu, me punë. S'pati kokë për shkollë.

— Ku punon tani? E hoqët nga ushqimorja, më duket.



— Në komunale. Kështu, për punë nuk është keq, i zë dora. Më tregonte ustai se një ditë...

Reshati nuk po e dëgjonte më. Biseda mes Julisë dhe Natale Balanit gjithashtu dukej e vështirë. Ai mbajti vesh pa kthyer kokën.

— ... Numër 242, apo jo? — po thoshte Natalia atë çast.

— Diçka e tillë. S'jam fort e sigurt. — Timbri i zërit të Julisë ishte metalik. — Reshati nuk u kushton fare rëndësi këtyre punëve dhe, me kalimin e viteve, edhe unë u çmësova.

— S'e kisha atë përshtypje.

— Për mua apo për Reshatin?

— Për shokun Reshat, — tha Natale Balani.

— Kujtova se, duke punuar kaq vjet së bashku, do të kishit pasur rast ta njihnit më mirë.

— Ndoshta është si thoni ju, por unë nuk kam marrëdhënie pune me kryetarin.

— Si do të bëjë Albani? — dëgjoi ai të përsëriste pyetjen e saj Greta Tytymçja.

— Përse?

— S'po më dëgjon, me sa duket. Për shkollën pyes.

Reshati bëri me kokë nga njerëzit e shumtë.

— Gjithë kjo zhurmë, — tha. — Nuk e di. Mbase do të ndërrojmë degën. Se ç'shkruan. E kam parë edhe dy-tri herë me Lirak Brezin.

— Më ka treguar Sandri. Thotë se po shkruan diçka kundër servilizmit. Atij i pëlqen.

— Unë s'e kam lexuar. Më ka thënë diçka Lira. S'e marr vesh ç'hyjnë këtu bizantinët.

— Me sa duket ngaqë servilizmi mund të jetë një mbeturinë e kohës bizantine. Të paktën për truallin tonë, një sërë dukurish të vjetra të neveritshme janë trashëgim nga ajo kohë. . .

— Gëzuar! — tha Julia dhe e ngriti gotën me lëng të kuq në drejtim të Natale Balanit.

— Qofshi e gëzuar! — ia ktheu Natalja dhe lëshoi kupën e akullores mbi banakun e lartë. Akullorja e pambaruar ishte shkrirë dhe lëngu i saj ishte i turbullt.

Befas u ndie një lëvizje e përgjithshme në sallë. Mërmërimat u prenë dhe kokat u kthyen nga hyrja.

— Nusja, nusja!

— Ja edhe dhëndri!

— Qenka i ri!

— Po ai burri atje kush është?

— Cili? Ai në të majtë të Fores? Krushku.

— I mbajtur mirë duket. Ç'punë bën?

— Në një ambasadë, diku.

— Ore, u dukka e bukur e bija e Fores.

— Lëre, lëre, si karkalec.

— Hi-hi-hi! Karkalec!

Reshati ktheu kokën për të parë njeriun që lëshoi atë të qeshur të mprehtë dhe gërvishtëse. Ishte një mësues historie që e kishte parë në aktivitetet e bërthamës shkencore të historianëve. Pranë tij rrinte edhe një mjek me gotën e pijes në dorë. Sapo pa Reshatin, fytyra e tij u mpi. Të gjithë njerëzit dukeshin të përçudnuar, si në një ëndërr të keqe. Madje, tani që kishin kaluar disa

orë, Reshati kishte vënë re që festuesit ishin rregulluar.

Drejt tij po vinte Fore Farashuku. Mëngët pa kopsa të këmishës i mbulonin gjysmat e duarve të mëdha. Manshetat e mëngëve ishin tepër të gjera, vuri re Reshati.

— Po ju kërkoja, shoku Reshat, — tha ai.

— Po?

— Dëshironi të njiheni me krushkun? Unë i kam folur për ju. Po që se dëshironi. . . — Edhe në të folmen e tij kishte diçka nga artifici i mbrëmjes.

Reshati nuk kundërshtoi. Çanë me mundim mes njerëzve të shumtë.

Krushku ishte në këmbë i rrethuar nga një grumbull kureshtarësh, pikërisht poshtë peizazhit të qytetit të vjetër. Ishte veshur me shije dhe flokët e tij lëshonin përçark një refleks të rëndë në ngjyrë të patëllxhanit.

— Ku punon krushku? — e pyeti Reshati Foren ndërsa i afroheshin.

— Ka qenë me punë në Poloni. Pse nuk jua paskam thënë? Tani e kanë thirrur pranë ministrisë në pritje të emërimit të ri.

Reshati ngriti supet.

— S'jua paskam thënë, hə? S'pata kohë! Gjithçka u bë kaq shpejt, — dhe, duke ulur zërin, shtoi: — Ka shpresë shumë që ta caktojnë në një post të lartë.

Reshati i zgjati dorën të ngarkuarit me punë.

— Ky është Reshati, kryetari ynë, — sqaroi Fore Farashuku.

— Aha! — bëri krushku i Fores. — Gëzohem! Reshati nuk foli.

— Më falni, — tha krushku, — sa të sqaroj diçka për Les Valesën. Do të dijë rinia!

Reshati pa Memliun të mbështetur pas murit dhe eci drejt tij.

— S'po pi? — e pyeti.

— Jo. S'jam mirë. Ju keni pirë?

— Asnjë gotë. Është vapë apo më duket mua?

Memliu nuk u përgjigj. I kishte ngulur sytë në turmën e vallëzuesve mendjehumbur. Reshati ndoqi vështrimin e tij. Po shikonte çiftin e të fejuarve. Djali i kishte prerë flokët shumë shkurt sipër veshëve, sipas modës që i thoshin çufo. Pjesa e sipërme e pantallonave bluxhins ishte mbuluar nga një pulovër i gjerë në ngjyrë gri të hapur. Pavarësisht nga muzika, ai vallëzonte ngadalë si i goditur në kryqe, me një indiferencë të shtirur.

— Sa e lodhur duket, hə? — pyeti Memliu.

— Kush?

— E bija e Fores.

Reshati pa vajzën e Fores. Ishte jashtëzakonisht e zbehtë. Mollëzat i kishte të shtrira e të gjera si të Fores, kurse qerpikët të rrallë dhe Reshatit iu kujtua Donika. S'e kishte parë atë natë. Të ishte e sëmurë?

Drejt tyre po vinte krushku me një cigare tepër të gjatë në buzë. Forja i kishte futur krahun dhe i tregonte njerëzit në të majtë e në të djathtë.

Krushku tundte kokën në mënyrë të njëtrajtshme.

— Ika unë, — mërmëriti Memli Muçostepa pothuajse në vesh. — Duket si thes kuriozitetesh të vjetruara dhe të panevojshme.

— Ju lashë pak, të më falni, — buzëqeshi krushku. — Po ç'ti bësh kureshtjes së njerëzve?

I futi krahun dhe ecën mespërmes sallës pothuajse pa folur. Megjithëse nuk kishte pirë asnjë gotë, Reshatit i merreshin mendtë dhe i dhimbte balli. Kërkoi me sy Julinë, por nuk e gjeti. Mbase ishte futur për të vallëzuar. Ritmi i orkestrës ishte tepër lodhës. Te banaku Natale Balani dhe Greta Tytymçja rrinin pa folur. Vajza e banakut ishte ndërruar kushedi pse me një burrë leshtor, i cili i hapte shishet me shkathtësi.

— Marrim nga një konjak? — pyeti krushku i Fores kur i ishin afruar banakut dhe, pa pritur përgjigje, mbushi një gotë të lartë përgjysmë me konjak, e holloi me ujë gline, hodhi pastaj një copë akulli që Reshati nuk e mori vesh se ku e gjeti dhe filloi ta tundte me shkathtësi, vetëm duke luajtur kyçin e dorës.

— Jo, — i tha Reshati kamerierit leshtor që po i mbushte edhe atij një gotë me konjak, — më mirë një gotë verë.

— Ju pini verë? — pyeti ish-ambasadori.

— Pak.

— Jeni mirë me tensionin, me sa duket.

— Jo. Përdor prej vitesh adalate.

— Bëni shumë gabim që pini verë, atëherë. Ndoshta ndonjë gotë me raki edhe mundet, sepse

të gjithë njerëzit e mjekësisë, me të cilët kam pasur rast. . .

— Pi rrallë, — e ndërpreu Reshati.

— Atëherë ndryshon puna.

Kur u zgjat të merrte gotën e verës, Reshati pa mbi banak pikla të vogla të kuqe dhe iu kujtuan duart e Fore Farashukut. Iu përzie. Jo në stomak, po diku në pjesën e sipërme të gjoksit dhe në bulçitë. Goja iu mbush me lëngje pa shijë dhe ai shpejtoi t'i ulte poshtë me një gllënjë verë. Vera ishte shumë e ftohtë.

Ceremonia e fejesës së vajzës së Fore Farashukut mbaroi aty afër mesnatës. Kur Reshati doli me Julinë, rrugët e qytetit ishin të shkreta. Nga nënhijet e një gështenje të egër përballë turizmit, dëgjohej një zë i trashë që këndonte në aritmi të plotë:

Se gruaja ndërron shtratin,  
kurse lumi kurrë.

Jeta është në duart e atij  
që ndjenjat i ka gurë. . .

Me siguri ishte ndonjë i dehur.

Julia ngriti jakën e pardësyesë dhe u ngjesh pas krahut të të shoqit.

— Je lodhur? — pyeti ai.

Ajo nuk u përgjigj. Rrahja e takave në pllakat e trotuarit tingëllonte e rëndë dhe e zymtë.

— Ti sigurisht nuk mendon për Natale Ba-

lanin? — tha ai të kundërtën e asaj që kishte ndër mend.

— Dhe po që se mendoja pikërisht për të?

— Bën gabim.

— E di që bëj gabim, por nuk mundem ndryshe.

— S'ka asgjë të keqe.

— Flet kryetari kështu, apo Reshati.

— Të dy.

Para disa vjetësh kishte lindur një mënyrë e të shikuarit të tij si dy veta, njëri Reshati, tjetri kryetari. Ai ishte përpjekur t'i mbante të bashkuara ato të dyja, por më në fund e kishte kuptuar se ishte e kotë. Netëve bisedonin shpesh me Julinë për pamundësinë e njësimin të tyre. Arsyetimet që deri atëherë i ishin dukur si mençuria vetë, sipas të cilave një njeri i ndërgjegjshëm duhet me çdo kusht t'i njehsonte këto dy qenie, binin menjëherë. Ai ishte njeri, ishte rritur në atë qytet, me shumë njerëz dhe vende e lidhnin fije të padukshme sentimentalizmi që nuk kishte pse t'i këpuste; kurse si kryetar pushteti ai duhet të ishte i prerë ndaj këtyre ndjenjësive që i bulonin shpesh e më shpesh, duhet të ishte pra një qenie, nëse mund të quhej, e distiluar dhe kjo ishte e pamundur. Atëherë ai i kishte pranuar në të njëjtën kohë edhe Reshatin, edhe kryetarin, por si dy degë të të njëjtit trung. Gjithë puna ishte që, pavarësisht nga ndryshimet e logjikshme, mes tyre të mos kishte kundërveprime, luftë, antagonizëm. Kështu, për shembull, kur, pas tri pritjesh,

një djalë nga fshati i tij kishte ardhur përsëri për të kërkuar lejen e banimit për në qytet pasi ishte martuar me një vajzë të qytetit, të ndarë nga dy burra para tij, Reshati ishte nxehur dhe i kishte thënë, kundër të gjitha rregullave, se bënte mirë të ndahej nga ajo lavire dhe të kthehej në fshat, pasi, sa të ishte ai kryetar, nuk kishte për të lejuar të bëhej pasaportizimi. E dinte se nuk kishte bërë gabim. Në atë rast, ai kishte vepruar si Reshat, si njeri, si bashkëfshatar.

Më në fund, kur hynë te kthesa e shtëpisë së tyre, dora e Julisë në xhepin e pardësyesë së Reshatit ishte ngrohur.



## KAPITULLI XI

Trarët sap, të lidhur me kavo dy e nga dy, po ngriheshin me anë të vinçit duke u përplasur lehtë pas mureve në intervale të parregullta kohe. Duart e futura brenda dorezave prej bezeje të gomuar i kishin djersirë dhe Albani vazhdonte të hidhte beton në govatën e madhe. Djali manovrues ishte ulur mbi një grumbull tullash me veshë dhe në njërin gju kishte mbështetur kutinë e pultit të komandimit të vinçit. Shapkën e shtypur e kishte ngjeshur mirë në kokë, por, megjithatë, tufa e pabindur e flokëve i kishte dalë se i kishte dalë poshtë strehës së gjatë duke i mbuluar njërin sy. Usta Xhafa, duke ecur pa vështirësi mbi murin pothuajse të mbaruar, doli në atë pjesë të mbuluar me soletë ku ndodhej Albani.

— Punë dreqi, — tha ai. — Ja ç'është kjo: punë dreqi! Kësaj i thonë bëj të bëjmë plane!

— Pse? — pyeti Albani.

— Muret i ka larë dimri. Kam frikë se duhet punuar edhe një herë të paktën në dy-tri radhët e krehut të katit.

Ai po hiqte përparësen nga qafa.

— Ku do të shkosh?

— Të gjej inxhinierin. Apo s'e gjen lehtë atë! — ai u përkul në anë të soletës dhe i thirri djalit që përdorte vinçin: — Dëgjo këtu ti, manovrues, edhe këta dy trarë dhe mos ngjit të tjerë. Mirë?

Nga poshtë nuk iu përgjigjën, por kjo nuk e shqetësoi Xhafën. Mbështolli përparësen, futi brenda saj mistrinë dhe plumbçen dhe i la në një anë duke i vënë një copë tullë përsipër.

Albani ngriti supet si për të thënë «Si të duash».

Pas një mungese të gjatë, brigada e tyre ishte kthyer përsëri të përfundonte pallatin e banimit që kishte mbetur në soletën e katit të katërt. Gjatë atyre muajve, pasi i kishin dhënë dorën e fundit muzeut historik të rrethit që u inaugurua në janar, ishin marrë me përshtatjet e muzeut etnografik, i cili ishte ngritur mbi sarajet gjysmë të rrënuara të Dervish pashë Dacit. Albanit nuk ia kishte marrë kurrë mendja që një ndërtesë banimi të kishte aq shumë kthina, qoshke, ndërkatë, pasmure, qilarë, baxha, nënhatulla të banueshme, tunele, karakolle, korridore që, në vend të dilnin

siç mund të merrej me mend, në dhoma plot dritë, të shpinin në tunele të errëta e që andej në dalje të papritura përjashta. Ia kishte treguar të gjitha me imtësi arkitekti i ndërmarrjes, Pirro Tytymçja, kushëri i largët i Sandrit. Lëkura e fytyrës së tij, tepër e bardhë dhe e hollë, lejonte të shikoje poshtë saj damarët blu që rrihnin me një ritëm jonormal.

Albani u mbështoll mirë me peliçen që kishte hedhur krahëve për t'u mbrojtur nga era e lagësht e detit. Në hapësirat mes reve qielli kishte një kaltërsi marramendëse.

Tani dhoma ku ata kishin bërë dashuri atë natë të largët ishte përgjysmë e mbuluar me trarët cjan që ishin vendosur puthitur me njëri-tjetrin. Mbi ta do të hidhej beton, serë, termoizolant, pastaj përsëri beton dhe do të krijohesh një lloj solete ndarëse mes kateve, si një kapak i rëndë. Nëpër dhomën e zbrazët, si në një sarkofag madhështor do të sillej ajo natë. Tashmë trupftohur, me ca dritëza të largëta që regëtinin lodhshëm nëpër cepa e në thellësi... Pastaj këtu do të futej për të banuar një familje dhe kurmi i dashurisë së asaj natë do të ngrohej sërish. Në trupa njerëzish të tjerë. Mbrëmjeve. Pasdrekeve.

Te kthesa e rrugës, poshtë blirit që sapo kishte gjethuar me një blerim delikat, u dha usta Xhafa me të ecurën e tij të rëndë. Në krah ishte inxhinieri i ndërmarrjes, i shkurtër, me rripin e pantallonave të shtrënguara tepër lart, gjë që bënte të dukej më i shkurtër nga sa ishte në të vërtetë.

Nuk flisnin dhe Albani pati përshtypjen se në të ecurën e Xhafës kishte më shumë nervozizëm nga sa mund të mbante në të vërtetë shpirti i tij i butë.

Elektromotori i vinçit kërciti dhe dy trarët cjan filluan të ngjiteshin përsëri. Djali i vinçit diçka i thoshte me zjarr njëres prej grave. Ajo rrinte mbështetur pas dërrasës së trashë që e kishin ngulur në tokë ku ishin montuar pajisjet elektrike të vinçit. Sytë e saj ishin jashtëzakonisht të ngjashëm me siguresat e bardha që kishte sipër kokës.

Biseda kishte ngecur. Dëgjohej vetëm zhurma acaruese e lugëve dhe pirunëve pas porcelanit të pjatave. Jashtë po bëhej mbrëmje dhe, ngaqë ende nuk e kishin ndezur dritën, lëvizjet dukeshin të ngathëta dhe sikur i përvidheshin vështrimit të njëri-tjetrit.

— Do të dalësh? — e pyeti Julia të shoqin.

Reshati e kishte gojën plot dhe u kufizua vetëm me një tundje të kokës që mund ta merrje si të doje.

Në mesin e tavolinës shishja me kos ndriçonte si platin. Sapo e kishte nxjerrë Lira nga frigoriferi dhe, sa herë që i hidhte sytë andej, Albanit i shkonin mornica duke menduar se sa e ftohtë duhet të ishte. Përgjithësisht nuk i hahej kaq herët, po, sipas një zakoni që kishte mbetur me sa duket që nga ajo kohë kur i ati punonte në fshat dhe i duhej të flinte herët, ata vazhdonin të dar-

konin përherë aty rreth orës shtatë. Si fshatarët, thoshte me pakënaqësi Lira.

— Do edhe pak kos? — e pyeti Julia Reshatin që e shtyu pjatën me gjysmën e biftekut të pambaruar.

— Po mirë.

Julia i tha Lirës të sillte një pjatë tjetër. Albani vazhdonte të hante kokulur. Mishi ishte i ftoh-të dhe ai kujdesej të mos bënte zhurmë, ndërsa e priste me thikën e pamprehur.

— Ti, Alban, do kos?

— Jo, — tha Albani, — faleminderit! — dhe në trup i kaluan përsëri mornicat.

— Si po ia shpie me punë? — e pyeti i ati. Qysh se ishin ulur për të ngrënë para më shumë se gjysmë ore Albani e kishte ndier që më në fund nuk kishte se si t'i shmangej një bisede të plotë ku do të analizoheshin të gjitha ato që ishin lënë në mes gjatë bisedave të bëra kohë më kohë. Në të vërtetë ato asnjëherë nuk kishin qenë tamam biseda. Për një arsye apo për një tjetër, më shpesh për shkak të një acarimi të pakuptueshëm që vazhdonte të paktën që nga viti i parë i studimeve, ato zhvilloheshin ose si një varg sharjesh të përmbajtura me zor të Reshatit, ose si një rebus të hedhurash e të priturash mes të dyve.

Albani tundi kokën për të thënë «çka».

— Pse nuk kishe pranuar të punoje si teknik? — e pyeti Reshati. Me sa duket nuk e kishte të lehtë që, pas një shmangieje të gjatë, ta zbriste bisedën në një truall konkret, prandaj po i binte sërish larg e larg.

Albani lëshoi ngadalë thikën dhe pirunin, u gëlltit, ngriti kokën dhe e pa ngultas të atin. Nëse i ati kishte lënë përsëri hapur shtegun për një shmangie të re, çka do të thoshte që përsëri biseda të mos bëhej e plotë, ai e ndjeu se duhet ta mbyllte atë përfundimisht.

— Ty të tha drejtori? — e pyeti dhe u çudit me tonin e prerë të zërit të vet.

— Po.

— Tepër vonë. Kjo është një histori shumë e vjetër, të paktën e katër muajve të shkuar. Nuk i lejohet kjo neglizhencë një drejtori, ca më shumë kur bëhet fjalë për djalin e kryetarit të tij. — Pa e kuptuar edhe vetë, ai kishte rënë pre e atij të foluri të hidhur, të bisedave të mëparshme.

— Alban! — ky ishte zëri qortues i s'ëmës. Albani u kthye dhe e pa sikur deshi t'i thoshte: Sa mirë, për veten tënde thua ç'të duash në adresë të babait, kurse ne nuk do të na lejosh! Por ajo edhe mund të mos e kishte parë vështrimin e tij, pasi mungonte drita.

— Pa hë! — e shtyu të fliste më tej i ati.

Albani mbështeti të dy bërrylat në tavolinë para se të fliste.

— A nuk të duket se më ke rrethuar keq? — e pyeti.

— Ou! Pa shiko, shiko! Po me se të paskam rrethuar kështu? Me tanke? Me ushtri?

— Më keq akoma, me kujdes, me veten tënde. E di si e ndiej veten?

— Hë?

— Si të mbështjellë me lesh.

E qeshura e Lirës ishte fare e shkurtër dhe ra si gur në një prej qosheve të errëta të dhomës. Mbase diku pas luleshqiponjës.

Reshati iu kthye së shoqes:

— Unë s'po marr vesh gjë. Di të ma sqarosh ti? Ky brezi i ri po na flet një shqipe të koklavitur.

Julia nuk foli dhe Albani ia diti për nder.

— Ashtu është, — tha Albani. — Janë ca gjëra që nuk duam t'i marrim vesh, i shtyjme dhe i quajme të koklavitura.

— A mund të ma shkoklavitësh ti, «zoti shkrimtar»?

Reshati shtyu pjatën e pambaruar të kosit dhe, sikur ta kishte pasur ndër gishta, ndezi në çast një cigare.

— Si urdhëron, zoti kryetar i Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit, — edhe Albani e shtyu pak më tej pjatën, pa qenë nevoja. Duke u përplasur, pjatat lëshuan një tingull të keq, si kërvatje dhëmbësh.

— Mos u shani, mos u zini se maçoku është i imi, — tha një shaka të vjetër Lira, por, në vend që ta zbuste, shakaja e nxori më në pah ajrin e acartë të grindjes.

— Lira! — tha qortueshëm Julia dhe me këtë deshi të thoshte se kjo bisedë duhej të bëhej ndoshta edhe pa pjesëmarrjen e atyre të dyjave.

— Atëherë vazhdo! — tha Reshati duke e përmbajtur inatin.

— Më ke mbështjellë me emrin tënd, me postin tënd aq sa po më merret fryma, aq sa më duket sikur njerëzit nuk do të ma mësojnë kurrë emrin, por do të më thërresin vetëm «i biri i kryetarit». Ti mendon se drejtori; ai që pavarësisht nga sa ndodhi, është burrë i mirë; donte të më bënte nder mua?

— Po, pak a shumë ashtu mendoj.

— Gabohesh! Ose, më saktë, ke qejf të shtirësh sikur nuk i merr vesh këto gjëra, pasi kështu e liron veten nga përgjegjësia. Ti e di mirë që këtë nder drejtori po ta bënte ty. Pikërisht, duke pasur parasysh këtë, unë kundërshtova. E di, të lutem, — tha ai duke bërë një gjest me të cilin kërkonte që të mos e ndërprisnin, — e di që brenda mospranimit tim ka një dozë donkishoteske, si shabllonet që përdoren nëpër drama, por sidogoftë. . . — ai nuk diti si të vazhdonte më tej, bëri sikur u kollit, pastaj, duke parë duart, vazhdoi: — Me siguri drejtori të ka përkëdhelur duke të thënë për mua se jam një yll, një djalë tepër i zoti, se nuk e merr vesh ç'paska qenë ai drejt pedagog që më la në klasë, se paskam aftësi të rralla në ndërtim, se për mua thonë e ç'nuk thonë shokët e mi të punës. A nuk të ka thënë kështu? — tha ai tani me një zë të sigurt, i kënaqur që kishte gjetur një rrjedhë për fjalët e tij. Ishte i kënaqur gjithashtu që më në fund biseda kishte dalë nga tonet tepër të vështira të fillimit.

— Pak a shumë.

— Dhe ti e besove?



— Pothuajse. — Reshati, i mësuar me biseda të vështira, nuk po hapej.

— I besove. Ashtu siç u ke besuar notave që kam marrë në shkollën e mesme, të cilat i kam marrë nën emrin tënd dhe nën hijen e postit tënd.

— Notat i kam besuar se nuk kam menduar kurrë që djali im është i paaftë për t'i marrë ato.

— Dhe, pak a shumë, ke pasur të drejtë, — tha Albani me dhimbje. Përfundimisht, biseda ishte bërë, në saje të kujdesit të Reshatit, rationale dhe toni i saj normal, por Albani, i pamësuar, nuk mund ta kuptonte ende. — Nuk është puna se mua më mungon aftësia intelektuale për t'i marrë ato nota... jam, domethënë nuk kam qenë, se emri dhe posti yt më bëri dembel, më mësuan dembelizmin. Notat merreshin me lehtësi...

Julia zgjati dorën dhe mori një cigare nga paketa që ishte mbi tavolinë. Reshati ia nderi me çakmak. Në dritën e tij ai pa njollat e hirit të duhanit që i ati i kishte shkundur në pjatën me kos.

— Dhe ti mendon se për të gjitha këto jam unë fajtor? — pyeti Reshati.

— Në njëfarë mëse, po.

Edhe pasi u fik çakmaku, shishja e kosit, duke kthyer dritën e tij, vazhdoi të lëshonte për pak kohë ndriçim të zbehtë përçark.

— Pse?

— Sepse mund të më kishe qëndruar më pranë për të kuptuar ç'po ndodhte me mua.

— Mbase, — tha Reshati dhe nderi një cigare

tjetër në fundin e së parës. Një cigare muhabet, kështu thoshte Xhafa. Edhe ata e kishin bërë një cigare muhabet. Reshati sikur u kujtua për diçka dhe ia zgjati paketën të birit: — Do ta ndezësh?

— Jo, nuk e pi. Faleminderit!

— Mjaft më tani si në sallonin e mirësjelljes, — tha Julia me zë si të lagur dhe u ngrit. — Do t'ju bëj nga një kafe. Mirë?

— I bëj unë, — u hodh Lira.

— Rri ti, kotele!

Lira shkrepiti çelësin dhe tani shishja e kosit, nga burim drite, u kthye në akumulues, sikur po përgatitej të ndriçonte kushedi ç'terr tjetër.

Ata të dy rrinin me bërryla të mbështetur në tavolinë, pa e shikuar njëri-tjetrin. Albani ndihej bosh. Nuk kishte thënë as çerekun e atyre që kishte menduar se ishte e domosdoshme të thuheshin dhe ishte zbrazur. Mos donte të thoshte kjo se...

— Po për shkollën si do të bësh? — e pyeti Reshati kur i kishin pirë hurbat e para të kafesë.

Albani ngriti supet.

— Do të ndërrosh degë?

— Kjo nuk lejohet. Të ishte në vitin e parë, po. Tani është vonë.

Reshati donte t'i thoshte se mund të ndërhynte ai, por e përmbajti veten.

— Po ti edhe shkruan. Ka një klauzolë në rregullore...

Albani lëshoi një psherëtimë të gjatë e të vrazhdë para se të fliste.

— Budallallëqe! Kam kaq muaj që nuk po e mbaroj dot një parabolë! E lexova sot. Me sa duket ka qenë thjesht një shfryrje dufi, jo, jo, asgjë më shumë... — shtoi pastaj sikur kundërshtonte mendimin e pashprehur të dikujt.

— Atëherë? Unë mendoj se një njeri me shkollë të përgjysmuar është gjysmak.

— Do të vazhdoj inxhinierinë.

— Mendon se do të mundesh?...

— Besoj.

Pasi u vesh në korridor, Reshati u kthye te dera e kuzhinës dhe foli nga pragu:

— Megjithatë, atë tregimin bën mirë ta përfundosh.

Albani u kthye dhe për herë të parë gjatë asaj pasdrekeje e pa të atin në fytyrë. Iu duk i zbehtë. Me sa duket i kishte amplifikuar më shumë nga sa duhej ca të vërteta të thjeshta.

— Ti e ke lexuar? — pyeti me zë të zbutur përfundimisht.

— Jo, po përgjithësisht jam kundër lënies në mes të punëve.

— Mirë. Në këtë kuptim jam dakord.

Reshati bëri të dalë.

— Shoku kryetar, — i foli si me të qeshur Albani. Reshati ktheu kokën. — Faleminderit!

— Përse?

— Për «pritjen» që më rezervuat.

Reshati bëri një grimasë buzëqeshjeje.

— Do vish të dalim?

— Jo. Jam i lodhur.

— Si të duash. Isha i lirë, prandaj.

Fore Farashuku telefonoi katër herë gjatë kohës që Reshati nuk ishte në shtëpi. Nuk kishte lënë vend pa e kërkuar, por nuk e kishte gjetur. Kishte diçka tepër të rëndësishme për t'i thënë, thoshte ai në fund të çdo bisede dhe priste që Julia t'i thoshte të vinte e ta priste në shtëpi, gjë që ajo nuk e bëri.

Reshati u kthye aty nga ora 10.00. Me një vështrim që i hodhi kalimthi, Julisë iu duk tepër i lodhur dhe i tronditur.

— Do të pish një kafe? — e pyeti pa i rënë në sy.

— Jo. Kanë fjetur fëmijët? — Ai, sipas zakonit, u mbështet me njërin sup pas murit dhe filloi të zgjidhte këpucët duke e mbështetur njërin këmbë në gjurin e tjetrës.

Julia ngriti supet.

— Ku ishe?

— Jashtë.

— Shëtite?

Ai e pa me habi.

— Më ka kërkuar njeri?

— Jo, askush, — gënjeu ajo duke i marrë **xhaketën.**

Reshati u fut në dhomën e gjumit dhe pas pak doli i veshur me pizhame e me një cigare të pandezur në buzë. Dhe, ndërsa rrinte përhumtas në korridor, ra zilja e telefonit.

— Po, — tha duke e ngritur ngadalë receptorin.

— Jam Fore Farashuku, shoku Reshat. Nuk kam lënë vend pa ju kërkuar. Po ju, ku ishit?

— Hë, Fore, si është puna?

— Do të kisha dëshirë që këtë bisedë të mos e bënim në telefon, se dihet ajo punë, ndryshe është kur e ke tjetrin përballë, kur e shikon në sy.

— Ashtu është. Megjithatë këtë natë po e bëjmë në telefon. Ti mund të flasësh lirisht.

Por Fore Farashuku me zërin që telefoni e sillte më të trashë nga sa ishte në të vërtetë, filloi të dërdëlliste se në shtëpi kishte një verë shumë të mirë, se edhe Donika, sa herë që shkonte ai në shtëpi. . .

— Dëgjo, Fore, mund t'i biesh shkurt, apo jo? — Pas bisedës që kishte bërë me Albanin ndiente një lodhje të ëmbël, të cilën çuditërisht donte ta shijonte vetë, si një filxhan kafe, deri në fund.

— Po, po, patjetër, — tha Forja dhe mbeti.

U hap dera e kuzhinës dhe në pragun e saj u duk Albani.

«Ç'deshe?» — e pyeti i ati me shenja.

Albani tregoi telefonin me gisht, por bëri shenjë se puna nuk ishte urgjente dhe se mund të merrte më vonë. U fut përsëri brenda.

— Fore, mos ke ndër mend të na mbash gjithë natën me vesh pas telefonit? — e pyeti Reshati. Shfaqja e të birit dhe gjestet e tij familjare i kishin kthyer edhe humorin.

— E kam të vështirë...

— Ti? Sikur nuk më besohet. S'para shquhesh për druajtje ti Fore.

— Ha-ha-ha, — qeshi në anën tjetër Forja.  
— Shoku mbetet shok, s'ke ç'i thua. Të njeh dhe e njeh. Një jetë e tërë...

— Pa nostalgjira dhe pa shumë teori, Fore!

Matanë telit u dëgjua një e thithur e gjatë e ajrit dhe Reshati pati ndjesinë sikur kablli u zbraz. Vetëm largoi kokën nga receptori.

— Hë, e kam fjalën për çështjen e asaj shitëses. E bëra atë budallallëk me brirë, i hëngra aguridhet që më vuri përpara Labo Ajeti, po kam frikë se dhëmbët e mi nuk e durojnë dot një mpirje të fortë. Nuk e di a jam shumë i qartë?

— Përkundrazi, je i paqartë.

— E kam fjalën këtu: ju jeni një titullar me emër, i konsoliduar prej vitesh e vitesh, bir dëshmori, me stazh dhe me reputacion të madh, — me sa duket kjo shprehje ishte huazuar nga fjalori i krushkut, — pothuajse i paprekshëm, ndryshe është puna ime. Mua edhe një dallgë e vogël më merr frymën e më mbyt, më shemb. S'kam themele unë, jam si rrepka e kuqe, rrënjëdalë...

— Tani po bëhesh fare i pakuptueshëm, Fore. Mund t'i biesh më drejt? — Ç'kishte parandier Fore Farashuku?

— Ja, ja, tani. E kam fjalën këtu, domethënë, po qe se bëhet problem diku puna e asaj shitëses, sikur të dilte që gjykimi im nuk ka qenë edhe aq kundër gjykimit tuaj... me ju nuk bëhet shaka,

nuk ju godasin dot lehtë ju... Kurse, po mbeta vetë unë, he-he, e hëngra. Vajta...

— Prit një herë, prit, — e ndërpreu ashpër Reshati. — Që t'i marrim punët shtruar...

— Ndihma e fundit. Nuk ka për të ndodhur më. Do t'i vë gishtin kokës. Mirë më thoshte babai, ndjesë pastë, mos iu ndaj Reshatit, dëgjoje Reshatin, por unë! Ah, ah, kokë!... Po qe se nuk do të më japësh dorën, mendoni edhe vetë! Shtëpi, punë. Vajza e fejuar... telashe, telashe.

— Mjaft, Fore, mjaft se e mora vesh!

— Domethënë ju?

— Ky është një kompromis i shëmtuar që unë nuk kam si ta marr përsipër. Socializmi i ka ndarë punët, por ka ndarë edhe përgjegjësinë e punëve.

— Të kuptohemi drejt, unë nuk ju kërkoj të merrni përsipër gabimet e mia. Dua vetëm një lloj mbështetjeje. E mban mend se si më the kur më more me punë në qytet: Mbështetu tek unë!

— Të mbështeteshe për punë, të thashë.

— Punova dhe gabova... — për çudi atë natë Forja ishte brisk nga goja. Ç'alarm e kishte sjellë në këtë gjendje?

Reshati u ndie përsëri tepër i lodhur. Më mirë të mbyllte telefonin dhe të shkante në djall Forja me gjithë hallet e tij. Po a nuk je ti ai që i dhe dorën, e ngrite, e solle deri këtu? Po qe se ai ka gabuar, kjo do të thotë se i pari fare, ai që gaboi në fillim jam unë. Pastaj, vërtet...

— Secili do të mbajë të tijat. Unë atë që ta

besova ty tërësisht çështjen dhe kjo nuk është pak, më duket, — tha me zë.

— Jam i gjithi borxhi juaj, jeta ime pa ty nuk është gjë tjetër vetëm jeta e vogël e një bostanxhiu të varfër...

— Mjaft tani. Unë do të them të miat. Ti nuk ke pse e ul veten kaq poshtë, ne këtu jemi.

— Domethënë ju?

— Po, po. Tjetër, do më?

— Unë, jo, jo...

Reshati e kishte mbyllur telefonin para se të mbaronte tjetri.

Tekefundit në bazë të gabimit të Fores ishte gabimi i tij që e kishte ndihmuar për t'u ngjitur. Me sa duket nuk po merrte mbi shpinë gjëra që nuk i takonin. Vetëm se po i merrte me vonësë. Pse e pranova ortakërinë?, e pyeti ai veten duke mos ia ndarë sytë telefonit. Nuk donte t'ia dinte se kush do ta bënte gjykimin, në fund të fundit kjo nuk kishte rëndësi. Iu shfaq përpara syve Domenika Dani dhe ngadalë, por ashpër, u ngrit nga thellësia e ndërgegjes pyetja të cilën ai e kishte shtyrë vetë sa e sa herë të tjera për më vonë: Pse nuk ishte marrë seriozisht vetë me ankesën e saj? Sa muaj ishin zvarritur punët? Po sikur të kishte qenë ai në vendin e saj?

Ndjeu marrje mendsh dhe u mbajt pas murit. Nuk e kishte vënë re Julinë që tani i rrinte përballë.

— Kush ishte, Fore Farashuku? — e pyeti ajo.



— Po.

— Dukesh i prishur në fytyrë. Do të të bëj një limonadë? Pi edhe adelat. Mos ke luhatje tensioni?

— Jo, jam mirë. Vetëm se sot ndihem tepër i lodhur. — Sa e shpërndarë qe biseda me Fore Farashukun, mendoj ai kur u përpoq ta rendiste përsëri për t'ia treguar Julisë.

— Merre lejen, — i tha ajo.

— Ndoshta. Po shkoj të bie.

— Albani të ka pritur.

Reshati e pa në mënyrë pyetëse. Ajo vuri buzën në gaz.

— Asgjë, — tha. — Më duket se ka mbaruar atë tregimin.

— Ma futni në çantë se e lexoj nesër në zyrë. I thuaj natën e mirë. Si është ajo thënia e Gëtes?

— Cila?

— Ajo për prindërit.

— Megjithëse e ka thënë kur ishte tepër i ri.

— Pavarësisht.

— «Prindërit fisnikërohen prej fëmijëve.»

Reshati buzëqeshi pothuajse me mundim. Në kuadratin e errët të dhomët së gjumit, me dritën e korridorit në fytyrë, ai dukej i verdhë.

Julia zgjati dorën dhe fiku dritën e korridorit për të mos e parë.

## KAPITULLI XII

Ndërsa rruhej dhe, më pas, ndërsa zbriste shkallët e pallatit, ëndrra iu kujtua copa-copa, asnjëherë sipas një radhe të caktuar. Megjithatë copat ishin të vizatuara qartë, si të skalitura me një thikë të mprehtë nëpër sipërfaqe dërrasash të shpërndara andej-këndeje, që notonin mbi ujëra të turbullta, poshtë qiejsh që ndërroheshin me shpejtësi. Në sfond Kisha pa Emër. Sipër kioskës një reklamë e madhe... Ujërat iknin dhe, duke notuar sipër tyre, dërrasat përmbyseshin përsëri... Jo, nuk mund ta rindërtonte krejt ëndrrën. Vetëm se frynte një erë, ndërroheshin qiejt dhe ujërat. Pastaj një zë këndonte. Këndonin me të vërtetë. Në fillim zëri i trashë i solistit: «Krimb, o krimb, sa lart je ngjitur.» Dhe ia priste korri që nuk dukej: «Duke u zvarritur, duke u zvarritur.»

Kur doli në rrugë, e kishte harruar ëndrrën. Dita ishte e bukur. Asfalti shndriste nga drita e bollshme që dukej sikur buronte nga fasadat e ndërtesave të lyera rishmë me gëlqere.

— Mirëmëngjesi, shoku kryetar, — e përshëndetën në të majtë.

— Mirëmëngjesi!

Pak më tej dy djem të rinj po lexonin gazetën «Sporti popullor». Për diçka nuk binin në një mendje. Pastaj njëri nga ata pa orën.

Te stenda përpara kinemasë po ndërronin reklamata. Reshati pa titullin e filmit të ri «Dëborë dhe gjak». Paska ardhur filmi i Bert Drenicës, tha me vete dhe mendoi se duhej të vente në një prej netëve për ta parë. Berti i kishte dërguar ftesë kur ishte shfaqur premiera, por ai nuk kishte pasur mundësi të shkonte. Kishte ndjekur jehonën në shtyp. E vakët. Fjalë të përgjithshme. Asnjë analizë për të qenë.

U fut në sallën e madhe të kafes së turizmit. Atje ndriçimi dukej edhe më i fortë për shkak të mbulesave të bardha e të lara, që me sa duket do t'i kishin ndërruar atë mëngjes. Në tavolinën pranë derës ishte ulur një grumbull i madh njerëzish që rrinin si të përgjumur. Parfumi që kishin vënë gratë ishte shumë i fortë. Duhet të kishin ardhur me trenin e parë nga rrethi fqinjë dhe tani, meqë treni mbërrinte tepër herët, po prisnin të kalonte koha. Filxhanët e kafesë përpara tyre ishin të ftohtë, si vështrimet e grave.

Reshati pa drejtorin e naftës që po ia bënte

me dorë nga një tavolinë afër fundit të sallës, pranë tavolinës së rezervuar ku ishte ulur Fore Farashuku së bashku me njërin prej sekretarëve të partisë të rrethit. Në ëndrrën e gjatë të asaj nate ai nuk e kishte parë kurrë Foren, por fotografi të ndryshme të tij.

— Erdhi përgjigjja nga qeveria? — pyeti drejtori i naftës.

Fore Farashuku kishte veshur një kostum blu me një rigë të hollë të bardhë.

— Përse?

— Për studimin e shpërblimeve.

— Akoma. Po nga muaji tjetër besoj. Ka kohë ajo punë.

Forja po i hidhte sheqerin kafesë së sekretarit, i cili rrinte ftohtë. Dukej menjëherë që biseda mes tyre nuk po shkonte.

— Ah, s'bëhen punët kështu. — Drejtori merrte zjarr shpejt.

— S'kam parë njeri që t'i shkojë kaq shumë puna sa ty, — bëri shaka Reshati. — Ndizesh menjëherë si pus gazi.

— Jo, po kështu është, apo jo? Bëni studim, na thatë. E bëmë. Tani prit të fillojë gjashtëmujori.

— Po ti e di që fondet e pagave janë vjetore. Edhe për gjashtëmujorin po bëhet një shkelje.

Erdhi kamerieri dhe solli kafetë për të dy. Në tabaka kishte edhe disa gota me pije.

— Do marrësh një konjak? — e pyeti drejtori dhe zgjati dorën e mori një gotë për vete.

— Jo. Nuk pi kurrë në mëngjes.

— Unë e dua një. Jam mësuar që kur isha me ekspeditat. Sa herë dal nga shtëpia, them: sot nuk do të pi, po do ti, sa futem këtu, ma ka qejfi.

— Mirë bën! Edhe unë e pija.

Fore Farashuku u ngrit nga tavolina dhe eci drejt banakut. Pas pak u kthye duke hapur një paketë me filtër, punë jo dhe aq e lehtë për gishtat e tij të trashë e të ngathët.

— Mirëmëngjesi! — tha ai kur kaloi pranë tavolinës së tyre.

Reshati vuri filxhanin në buzë dhe nuk iu përgjigj. Si kishte rënë pre e tij një natë më parë, në telefon? Sot do të kishte bërë të kundërtën. Sigurisht. Të paktën nuk do të kishte bërë atë që bëri një natë më parë.

— Mirëmëngjesi, — iu përgjigj drejtori dhe shtoi me zë të lartë: — Dhe nuk m'i dërgove që nuk m'i dërgove ata kuzhinierët, shoku shef, sikur i ke të importit, të shkretën!

— Patjetër, shoku drejtor, patjetër, — tha Forja dhe iku.

Drejtori e piu gjysmën e gotës me konjak me një të kthyer.

— Pehlivani! — tha, por me sa duket u kujtua për Reshatin dhe shtoi: — Më fal, e di që e ke shok, po s'më pëlqen.

— Përgjithësisht edhe mua nuk më pëlqen të flasim për të tjerë kur nuk janë të pranishëm.

— Ti kujton se unë kam frikë t'ia them në sy?

— Jo, por sidoqoftë.

— A, ja, për këto nuk kam qejf të futem unë nëpër komitete, për këto «sidoqoftë», «mbase», «megjithatë», «pothuajse» e më the të thashë. Fjalë-mushka janë këto, ja ç'janë!

— Kush tha...

— Mirë, mirë! Ika unë se më vajti ora. E di ç'do të më thuash: njeriu është edhe i mirë edhe i keq. Përralla! Njeriu është ose i mirë, ose i keq. I miri, edhe mund të ketë ndonjë të metë, e marr vesh këtë. Kurse ky, — ai bëri me kokë nga Forja, — edhe mund të ketë ndonjë të mirë. Ika tani se, po filluam, mbeta këtu.

Reshati nuk foli. E thithi cigaren fort dhe ndjeu një marramendje të këndshme. Ç'kishte parandier Fore Farashuku që i kishte kërkuar një natë më parë t'i dilte zot? Po kjo nuk kishte asnjë rëndësi, rëndësi kishte që ai diçka i kishte premtuar. A kishte bërë mirë? Një natë më parë e kishte justifikuar veten, por tani nuk ishte në gjendje ta kujtonte se si. U ngrit dhe doli.

Ora në sheshin e qytetit ishte 7 pa 5 minuta. Shpejtoi hapat duke menduar se e kishte vonuar shumë urdhrin e kthimit në punë të Domenika Danit. Copat e ëndrrës bënë përpjekjen e fundit për t'u ngjitur nga thellësitë e errëta. Ëndërr e stisur, tha me vete, duke ngjitur shkallët e gurta të komitetit.

Kur hyri në zyrë, ora kishte shkuar përtej shtatëgjysmës pasi i ishte dashur të ndalonte te

nëpunësi i rojës e t'u jepte udhë dy-tri problemeve të çastit.

U ul në kolltuk. Shtyu dosjen sipër së cilës kishin shkruar «Të ditës», pastroi xhamin e tavolinës dhe mbeti.

Së pari Domenika Dani, tha me vete më pas, kur i kaloi ajo gjendje pritjeje.

— Më lidh me drejtorin e ndërmarrjes tregtare, — i tha Memliut, pasi shkëmbyen përshëndetjet e mëngjesit dhe priti me receptor në vesh. Me dorën e lirë ndezi një cigare.

— Këtu Labo Ajeti, — u dëgjua në anën tjetër të telefonit. — Urdhëroni, shoku Reshat!

— Duke filluar nga dita e nesërme, shitësja Domenika Dani të kthehet në punë, po në atë vend ku ka qenë më parë.

— Me urdhër?

— Jo po me lutje, si! Me urdhrin tim. Vendimin tuaj e quaj të pavlefshëm dhe e heq nga fuqia.

— Atëherë kot sa jemi ne këtu.

— Nëse jeni kot apo plot, këtë do ta vendosë organizmi përkatës, sikundër e dini.

— Po qe se ju këmbëngulni, unë them: Ose ajo ose unë në ndërmarrje.

— Këtë e thua seriozisht apo thjesht për të bërë presion? — tha Reshati, dhe nuk po e gjente dot ku e kishte dëgjuar atë mëngjes apo atë natë zërin e veçantë të Labo Ajetit.

— Jo. E them seriozisht. Ose unë, ose ajo.

— Meqë pyet seriozisht, po të përgjigjem: ajo.

— Kjo mos do të thotë se unë duhet të heq dorë nga posti?

— Si ta shikoni. Çelësat e drejtorisë mund të m'i sillni në zyrë.

Labo Ajeti nuk foli.

— Do të mendohem, — tha pastaj.

— Mund të mendoheni sa të doni për veten tuaj e për punët tuaja, por për Domenika Danin nuk keni përse mendoni më. Është e prerë.

— Nuk paskam të drejtë as të mendohem?! Çudi!

— Për të jo. Sepse mendoni mbrapsht.

Reshati uli telefonin. Krimbi, tha me vete. Krimb, o krimb, sa lart je ngjitur... Po, këtu e kishte dëgjuar zërin e trashë të Labo Ajetit. Ishte ai solisti që kishte dëgjuar në ëndërr të këndonte para se korri t'ia priste: Duke u zvarritur, duke u zvarritur... Në ëndërr e kishte dëgjuar, si nuk ishte kujtuar më parë?

Te dera e brendshme kishte hyrë Memliu me një copë letër në dorë.

— Po?

— Ndërsa flisnit në telefon, ju kërkoi sekretari i parë.

Reshati kapi telefonin.

— Jo, — ndërhyri Memliu. — S'është nevoja të telefononi. Më porositi që, në orën nëntë, së bashku me përgjegjësën e seksionit të tregtisë, të ndodheni në zyrën e tij.

— Tjetër?

— Këtë kisha. Nuk më tha gjë tjetër.



— Mirë. Lajmëro Foren po qe se ai nuk e di.

— Urdhëro? Si, «po qe se?»...

— Asgjë. Lajmëroje.

Ja pse kishte marrë në telefon Fore Farashuku një natë më parë. Reshati vuri buzën në gaz. Donte edhe më shumë se një orë që të shkonte 9.00.

Ra zilja e telefonit. Ishte përsëri Labo Ajeti. Zëri solemn i tij, sado që përpiqej ta fshihte, kishte marrë një të krisur të thellë.

— Jam dakord, — tha. — Domenika Dani të kthehet në punë...

— Nuk kërkohej mendimi juaj. Unë dhashë urdhër, — e ndërpreu Reshati.

— Mirë. Kush do t'ia komunikojë? A ka mundësi ta bëjë këtë dikush tjetër?

Reshatit iu kujtua kollarja gri e Labo Ajetit. Si kishte menduar dikur se piklat e qëndisura me mëndafsh ishin imitime të një spërkatjeje rastësore diamantesh?

— Jo, — tha. — Komunikimin do ta bëni ju.

— Në kolektiv? — nga zëri i Labo Ajetit vazhdonin të shkundeshin tonet e ngritura.

— Hë, po, shumë mirë u kujtuat. Ta bëni në kolektiv.

Nga ana tjetër nuk u përgjigjën dhe ai e uli receptorin, pasi po binte zilja e telefonit të brendshëm.

— Po?

— Ç'është ajo thirrje te sekretari i parë? — Ishte Fore Farashuku.

— Në orën nëntë, — tha Reshati sikur nuk

e kuptoi se ku rrihte pyetja e tjetrit. — Të lajmëruan?

— Po pra, po. Më tha Memliu, po nuk e di. . .

— E di ti, e di. E dije që mbrëmë.

— Jo, për kokën e kujt të zë, të betohem.

— Pa betime, Fore, — dhe iu kujtua Simo bostanxhiu, në një sfond të turbullt shtufi, në një muzg të largët, me beretë, i kërrusur, duke numëruar grumbujt e bajgave. . .

— Të vij të bisedojmë pak?

— Pse, nuk u kënaqe mbrëmë?

— Domethënë, ju. . .

Reshati nuk foli. Kishte kohë t'i merrte pas ato që i kishte premtuar mbrëmë pothuajse me zor, por iu kujtua rënia e papritur e Labo Ajetit.

— Po, — tha. — Jam ai që isha mbrëmë.

— Faleminderit shumë! — sikur u çlirua Fore Farashuku. — Nuk di si të ta shpërblej. Pa ju unë do të isha një, një. . .

— Një bostanxhi, Fore. Mos e thuaj më!

Reshati uli receptorin dhe, nga frika se mos telefoni binte përsëri, ia kaloi lidhjen zyrës së Memliut.

Hapi çantën dhe nxori parabolën e Albanit. Në mëngjes herët i kishte lexuar tre pjesët e para. I kishte mbetur vetëm fundi.

## NJERËZIT PA HIJE

### Fundi

Dhe sapo njerëzit e ditur u dhanë te porta e rëndë e kështjellës, sipër së cilës ishte emblema e re e kontesë, një bredh e sipër tij një diell që po lindte, gjithçka përqark u mbyt nga një dritë e paparë. Drita nuk vinte nga qielli, e njëkohësisht qielli ishte gjithë dritë, nuk vinte as nga bora, e bora shkëlqente. Nuk vinte nga gurët e gurët shndrisnin. Nuk vinte nga njerëzit, por edhe prej tyre buronte e shpërndahej përqark një dritë e veçantë, pothuajse e njomësht, si qumësht. Pemët dhe bimët, çdo gur e çdo fëmijë, çdo kasolle e çdo muranë, çdo kështjellë e çdo dushk i vogël i zhveshur, çdo mal e çdo bari sipër malit lëshonte një dritë të barabartë.

Takoheshin njerëzit në rrugën e madhe, për-  
kuleshin me respekt para secilit dhe uronin:

— T'u bëftë jeta dritë, miku im!

Më të moshuarit shikonin dritën që dilte edhe nga opingat e tyre të ngrëna nga udhët, tundnin kokat dhe, ulur mbi njërën këmbë të thyer poshtë vetes, thoshin:

— Ç'mundim për të ardhur deri këtu! Përmes hijeve kemi kaluar!

— O zot! Ç'hije!

— T'u bëftë jeta diell!

— Dritë e paç edhe ti!

— T'u bëftë jeta dritë!

Përkuleshin përsëri dhe shkonin. Secili në punën e tij dhe të gjithë bashkë bënë punën e përbashkët.

Dhe drita buronte nga lart e nga poshtë. Tani kështjella e kontit shkëlqente jo më shumë se ajo kokrra e vogël e grurit që kishte rënë përfund derës së madhe, ndërsa sillnin prodhimet nga arat dhe asnjëri nuk kishte më shumë dritë nga tjetri.

## VAZHDON KAPITULLI XII

Reshat Zagora hyri në hollin e Komitetit të Partisë në orën 9.00 pa 5 minuta. Burri që ndodhej te kthina e nëpunësit të rojës u ngrit në këmbë për të përshëndetur, por ai i bëri shenjë të ulej.

— Sekretari i parë po ju pret, — tha njeriu duke nxjerrë kokën nga dritarja e vogël.

— Po, — tha Reshati pa ndaluar.

Në korridorin e brendshëm, nën një dritë të kaltër që e bënte të dukej më i bardhë nga sa ishte në të vërtetë, Fore Farashuku po bisedonte me ndihmësin e sekretarit të parë. Reshati bëri sikur nuk i pa dhe ngjiti shkallët që të çonin në katin e dytë. Heshtja e korridoreve kishte një shije të butë e të njomësht. Diku u mbyll një derë dhe

kërkëllima e saj u soll një copë herë brenda kraharorit të madh të Reshatit.

Dera e zyrës së sekretarit të parë ishte gjysmë e hapur, po Reshati priti sa iu shua ajo kërkëllimë e derës së parë diku poshtë gjoksit, para se të trokiste. Pa pritur t'i përgjigjeshin, shtyu derën dhe u gjend brenda.

— Hajde, hajde, Reshat! — sekretari i parë u ngrit nga tavolina dhe shpejtoi t'i dilte përpara. Trupi i tij i shkurtër lëvizi shkathtësisht në hapësirat e pamjaftueshme të objekteve të shumta, u vërtit një copë kohë mes tyre, derisa doli te një ambient i veçantë i krijuar me kolltukë rreth një tavoline të ulët, ku ishin lënë një sërë albumesh të mëdha.

Reshati eci me hapa të gjatë dhe zuri vend poshtë dritares, në kolltukun përballë derës.

— Si ia keni kaluar? — tha.

— Ja, ashtu, me probleme. — Pa u ulur mirë sekretari i parë ishte ngritur përsëri. Shkoi te tavolina e madhe për të marrë paketën e cigareve dhe çakmakun. Pas pak ia zgjati Reshatit.

— Kisha thirrur edhe shefin e tregtisë, — tha ai duke e ndezur cigaren me çakmakun që e mban-te të fshehur në grusht. — Në të vërtetë do të ishte më mirë të kishim biseduar një herë së bashku, por kam një mbledhje urgjente, pastaj thashë ta konsumonim problemin si konsultë, — ai pa orën edhe një herë dhe, sikur të mos i besonte asaj të dorës, i hodhi një sy edhe orës së murit: ishte

9.00 fiks. — Me sa duket, — tha për Fore Farashukun, — s'do të jetë lajmëruar në kohë.

— Besoj se... — filloi të thoshte Reshati duke parë nga dera, por ajo u hap: — Erdhi!

Në derë u dukën flokët e shumtë e të krehur me kujdes të ndihmësit të sekretarit të parë.

— Të vijë shoku Fore? — pyeti ai.

— Po, po. Shumë mirë!

Reshati shikonte gishtat e shkurtër të sekretarit të parë që luanin me paketën e cigareve mbi sipërfaqen tepër të lëmuar të tavolinës.

Mbi parket u dëgjuan hapat e rëndë dhe aritmikë të Fores.

— Ejani, ejani, shoku Fore, — tha sekretari i parë. — Uluni këtu, mos rrini në karrige!

Vetëm atëherë Reshati ngriti kokën për të parë Fore Farashukun dhe iu qesh. Forja ishte ulur në cepin e ndenjësës së njërës prej karrigeve të tavolinës së gjatë dhe duart e mëdha leshtore i kishte lëshuar të hapura sipër kupave të gjunjëve me një pamje tuhafi në fytyrë.

— Jo, faleminderit, shoku sekretar! Rri dhe këtu unë. Faleminderit!

— Eja, Fore, eja, — tha Reshati duke u ndier ngushtë, sikur të mos ishte Forja, por ai vetë në atë karrige në mesin e zyrës.

Forja u ul në cepin e kolltukut që i treguan, gjithë sy e veshë. Reshati pinte cigare dhe shikonte se si rritej hiri në majën e saj.

Çdo sekondë që kalonte e bënte më të vështirë fillimin e bisedës. Reshati u bë kureshtar ta dinte

sesi do ta thyente heshtjen sekretari i parë dhe pothuajse nuk u besoi veshëve kur dëgjoi një zë të shtruar:

— Ju kam thirrur për një problem tepër të rëndësishëm dhe të mprehtë, që mendoj ta konsumojmë edhe në formën e një konsulte, kështu, të përbashkët. — Ai bëri një rreth me të dyja duart dhe ato mbetën një çast para gjoksit të tij, atje ku ishte mbyllur rrethi imagjinar.

Fore Farashuku nxori një bllok të vogël, kapakët prej plastike të të cilit imitonin lëkurën e krokodilit.

— Jo, — tha sekretari i parë duke bërë përsëri një lëvizje energjike me dorë. — Nuk është nevoja të mbani shënime.

— Sidoqoftë, unë jam i ri...

Sekretari i parë bëri një grimasë buzëqeshjeje.

— Po mirë, si të doni. — Ai thithi fort cigaren dhe Reshatit iu duk se, përveç mushkërive, në atë të thithur morën pjesë edhe fyejt e kockave. — Pra, problemi është veçanërisht i mprehtë dhe i rëndësishëm, sidomos në planin organizativ dhe etik. — Ai pushoi përsëri. Ishte e qartë se konsideratat për problemin dikur do të mbaronin dhe ai duhej të futej përfundimisht në vetë problemin. U mbush me frymë dhe tha: — Ne e dimë se, kur një njeri, cilido qoftë ai, ankohet për një hall të vetin tek unë, ose te shoku Reshat, — ai pa me dyshim nga Forja, pastaj shtoi: — ose te ju, shoku Fore, ky është vlerësuar si një akt i madh besimi



i këtij njeriu te Partia e te pushteti. Nuk e di a jam plotësisht i qartë, apo jo?

— I qartë, i qartë, shoku sekretar, — tha Forja pa ngritur kokën nga blloku.

Sekretari i parë vazhdoi:

— Kjo duhet vlerësuar disa herë më tepër kur njeriu që vjen të qajë hallin është grua dhe pastaj, ca më shumë kur halli që ajo vjen të qajë është i sferës intime. Në këtë rast besimi i saj te Partia është jashtëzakonisht i madh, apo jo?

— Po, shoku sekretar.

— Pra, besoj se e keni të qartë. E kam fjalën për shitësen Domenika Dani. Erdhi dje në pritje burri i saj. I indinjuar, doemos, doemos... Ajo, si të thuash, erdhi te Partia që të vërë vetullat dhe nxori sytë, kështu i thonë kësaj, po të mos flasim me doreza. Erdhi për të ruajtur nderin dhe njolla e nderit të saj u vulos me shkresa zyrtare nga ju. Kjo, shokë, e komprometon punën e Partisë.

Për çudi, Reshati nuk arrinte ta ndiente veten fajtor. Hodhi këmbën e djathtë mbi gjurin e së majtës dhe sytë i mbetën te maja e këpucës.

— Dhe, — sekretari i parë kishte marrë zjarr pas gjithë atyre fjalëve të përmbajtura që kishte thënë deri atëherë, — sikur të mos mjaftonte njolla në nderin e saj, guximi i saj ndëshkohet me një masë tjetër: ajo pushohet nga puna. Edhe një qorr do ta lexonte në këtë veprim arbitrar hakmarrjen, kurse... — ai nuk e përfundoi fjalinë. Fiku cigaren me një gjest inatçor, pastaj, sikur mungesa e cigares t'i shkaktonte dhimbje fizike,

në çast nxori një cigare tjetër, së cilës i dha zjarr. — A është e vërtetë që ajo i ka drejtuar një letër kryetarit të Komitetit Ekzekutiv?

— Po, — tha Reshati dhe nuk pati asnjë dëshirë të sqaronte se pikërisht atë mëngjes ai kishte dhënë urdhër që Domenika Dani të rifillonte punë dhe se çështjen e Labo Ajetit do ta analizonin në mbledhjen e radhës të Komitetit Ekzekutiv. Në të njëjtën kohë e ndjeu se me atë «po» që tha, ai kishte pranuar dialogimin me sekretarin e parë dhe nga ky dialogim Fore Farashuku ishte përjashtuar.

— Dhe, si e gjykuat ju, shoku Reshat, këtë punë?

Reshati uli këmbën mbi tapetin bezhë.

— Komiteti Ekzekutiv iu përgjigj negativisht shoqes, — ai e kapi vështrimin mosbesues të sekretarit të parë, por nuk ndaloi. — Në të vërtetë, me sa gjykohet çështja, përgjigjja ka qenë e gabuar dhe janë marrë masat për t'u korrigjuar. I është zënë më shumë nga sa duhet besë anës teknike të çështjes, domethënë shkresave, procesverbaleve dhe mendimit të drejtorisë.

— Apo të drejtorit? — e ndërpreu sekretari i parë.

— Qoftë edhe të drejtorit, — tha Reshati me një ton të përmbajtur që po e habiste edhe atë vetë, sikur të qe fjala për një të tretë, i cili nuk ishte i pranishëm mes tyre. — Me sa duket, në gjykimin e çështjes, apo më saktë, në paragjykimin e saj, ka pasur një dozë të madhe teknokra-

tizmi. Fakti që edhe gjyqi nuk ka mbaruar ende...

— Shitësja nuk ju drejtua juve si të ishit levë e gjyqit, — vërejtí sekretari i parë. — Por...

— Nuk desha të them këtë, — u preu udhën keqkuptimeve të mundshme Reshati. — Për sa i përket gjyqit, unë ruaj mendimin tim, të cilin, para se ta shtroj në byronë e Partisë, nuk besoj se bëj gabim që ta parashtroj edhe këtu.

— Sigurisht që jo.

— Është tepër i thjeshtë: një punëtore ka hapur gjyq kundër drejtorit të saj. Është për rikthim në punë. Gjyqet shtohen, seancat ndjekin njëra-tjetrën, gjyq i shkallës së parë dhe gjyq i shkallës së dytë...

Sekretari i parë thithi fort cigaren dhe tundi kokën.

— Qëndrimi i gjyqit, — vazhdoi Reshati, — të paktën në rastin konkret, bashkohet me përgjigjen që mori shitësja nga ne e që mund të përkethehet me sentencën: drejtori ka gjithmonë të drejtë.

— Shoku Reshat, — e ndërpreu sekretari i parë. — E dini se pohimi juaj i fundit është tepër i rëndë për ju?

— Sigurisht.

Reshati pa me bisht të syrit se Fore Fara-shuku nuk shkruante më në bllok. Fytyra e tij ishte e hapur dhe merrej vesh që shumë gjëra nuk i kuptonte. Me siguri, mendoi Reshati, ai tani e ndien veten si një fëmijë qurravec në një bisedë burrash. Por nuk provoi keqardhje.

— Megjithatë, — tha sekretari i parë, — unë e gjej të shpejtuar.

— Mbase, — Reshati mori një cigare nga paketa e sekretarit të parë që ishte mbi tavolinë. Sekretari i parë e pa me mosbesim.

— Më falni, — tha. — Ndihmësi juaj më tha se ju po përgatitni një material për drejtorin Labo Ajeti, të cilin do ta paraqitni në mbledhjen e parë të Komitetit Ekzekutiv. Si ta kuptoj këtë? Apo thjesht një keqinformim?

— Aspak. Është e vërtetë.

— Atëherë?

Reshati ngriti supet. Shtegu për të lehtësuar ndopak veten ishte hapur, por ai nuk kishte asnjë dëshirë të ecte në të. Futi dorën në xhep për të nxjerrë çakmakun, por sekretari i parë i kishte zgjatur ndërkohë dorën e tij, brenda së cilës çakmaku i padukshëm ishte ndezur. Reshati falënderoi me kokë.

U bë heshtje. Në shesh, përmes dritares së hapur, u dëgjua një njeri që thërriste:

— Kasem, o Kasem!

— Hë, more, ç'do?

— Do vish në stadium të shohim stërvitjen? Përgjigjja e tjetrit erdhi e mbytur.

Zërat u larguan, por mes tyre vazhdonte heshtja. Reshati e ndjeu se nuk kishte ç'të thoshte më. U mbështet me të gjithë shpinën pas kolltukut të butë. Sytë filluan të bridhnin nëpër zyrën e madhe. Abazhuri i punës. Një dosje e hapur mbi tavolinë. Lapsat në një kuti vishnje. Ventilatori

i blertë, ende i pandezur këtë vit. Televizori në mesin e raftit të librave. Librat.

— Po ju, shoku Fore? — dëgjoi Reshati zërin e sekretarit të parë dhe mbajti vesh.

Fore Farashuku i hodhi një sy bllokut të hapur, sikur të lexonte atje përgjigjen, e mbylli, bëri një lëvizje boshe në ajër me stilolapsin e shndritshëm, u mbush rëndë me ajër dhe tha me një zë çuditërisht të hollë, sikur sapo kishte pirë një mashtrapë me vaj të skuqur:

— Tashti, shoku sekretar i parë, unë jam i ri, — qeshi me fjalët e fundit dhe shtoi: — Dome thënë në këtë detyrë jam i ri, sepse, si të thuash edhe aq i ri unë nuk jam, jo. Mungesa e përvojës në çështje të tilla, që ju, me shumë të drejtë i quani delikate dhe të mprehta, mungesa e reputacionit, — Reshati e përmbajti me zor të qeshurën, — domethënë e reputacionit të nevojshëm, bënë që unë...

«... të gaboja», plotësoi me mendjen e tij Reshati, ftohtë, por u çudit kur dëgjoi Foren që të thoshte:

— ... t'i kërkoja ndihmë shokut Reshat.

Shih, shih, dreqi, tha me vete Reshati dhe u mbështet pas shpinores së lartë të kolltukut për të dëgjuar më mirë.

— Unë i besoj eksperiencës drejtuese të shokut Reshat, por Partia na ka mësuar që të besojmë e të kontrollojmë. E unë u tregova sylesh. U shpejtova, nuk i peshova mirë punët me peshoren e ndërgjegjes. Me ndershmëri po, me ndershmëri

vepruam, por jo me thellësinë e duhur. Dhe, është e kuptueshme, shoku sekretar i parë, apo jo?

— Hë-hë, — bënte me bezdi sekretari i parë.

— Plotësisht, — tha me ironi Reshati, por Fore Farashuku nuk i ktheu sytë nga ai dhe, pothuajse me një lloj mospërfilljeje ndaj ndërhyrjes së Reshatit, shtoi:

— Unë kam pasur, kam e do të kem respekt të thellë për shokun Reshat. Ai më ka qëndruar afër, më ka ndihmuar prej kohësh dhe ia di për nder. Por, për sa i përket gjykimit të çështjes së shitëses Domenika Dani... Sepse Partia na mëson që shfaqjeve të teknokratizmit, të burokratizmit, të bajraktarizmit estetik...

— Etatist, shoku Fore, — e korigjoi Reshati.

— ... Etatist, — përsëriti edhe Fore Farashuku dhe, kur pa se sekretari i parë kishte vënë buzën në gaz, si me siklet, tha: — Më falni, shoku sekretar i parë, por unë është hera e parë... dhe jam kaq shumë i emocionuar, sa, si të them, emocionet...

Shih, shih ç'mamuth sentimental, tha Reshati me vete.

Dhe ashtu siç ishte, i mbështetur pas shpinës së lartë të kolltukut, me një qartësi të pamëshirshme, derisa dëgjonte zërin e Fores që përpiquej të lirohej nga përgjegjësia, iu shfaq ajo pasdreke, vite të shkuara, ndërsa priste makinë në buzërrugë. Binte një shi i ftohtë dhe i pjerrët. Albani ishte me temperaturë. Pastaj e pa veten të hipur në karrocërinë e një kamioni. Një dorë

e madhe qimeverdhë, me pika të kuqe përsipër, sikur sapo kishte dalë nga një thertore shpendësh, zgjatej dhe i jepte një mushama të mbështjellë. O Fore, ti je? Pyetja mbetej pa përgjigje.

— Fore! — e ndërpreu Reshati ligjërimin e ngatërruar të përgjegjësit të seksionit të tregtisë.

Fore Farashukut i mbeti fjala në grykë dhe pa nga Reshati me frikë. Po ne, ti e kupton, sa për sy e faqe, thoshin me ankth sytë e tij të mëdhenj.

— Urdhëroni, shoku Reshat, — tha me zë të ulët, por në të njëjtën kohë i përgatitur për të kundërshtuar.

— E mban mend ti, Fore, vite të shkuara, kur punoja në fshat? Binte shi dhe unë hipa në karrocërinë e një kamioni. Hë?

— Po, — bëri Forja. Tani piklat e spërkatura i kishin pushtuar gjithë fytyrën, por duart i kishte tmerrësisht të verdha.

Sekretari i parë shikonte herë njërin, herë tjetrin pa arritur ta kuptonte përse e kishte ndryshuar Reshati rrjedhën e bisedës.

— Desha të di, — tha Reshati me qetësi. — A ishe ti ai njeriu në kabinë?

## EPILOG

Nga dera gjysmë e hapur e kuzhinës vinte zëri i televizorit.

Reshati, pa e hapur dritën e korridorit, u mbështet me supin e majtë pas murit dhe filloi të zgjidhte këpucët.

— Ule pak zërin se na çmende, — u dëgjua zëri ankues i Lirës. — Apo s'është një film që... lëre!

— Se mos ti më mirë, — ia ktheu Albani. — Mbetë duke lexuar përralla!

Megjithatë zëri i televizorit u ul dhe ai tani mund të dëgjonte më mirë ç'thoshin ata të dy.

— E di se bëre mirë që e le të shkruarën? — ky ishte zëri i hidhur i Lirës. — Me këto mend që ke ti s'kishe për t'u bërë kurrën e kurrës shkrimtar. Pika!



Albani mërmëriti diçka të paqartë nëpër dhëmbë me zërin e trashë. Reshati, gjithë i mbështetur pas murit, kërkoi nëpër gjysmëterr pantoflat me shputën e këmbës.

— Pse, si të duken përrallat ty? — po thoshte Lira.

— Përralla më duken.

— Dëgjo këtu të të lexoj një pjesë. Mua më ngjan me atë parabolën tënde.

— Ç'përrallë është ajo?

— «Hija». Dëgjo: «*I vinte plasje, jo sepse hija ishte zhdukur, por sepse dinte historinë e një njeriu që e kishte humbur hijen... Kjo ndarje e mundoi shumë, mirëpo në vendet e nxehta gjërat rriten shumë shpejt dhe pas tetë ditësh vuri re me kënaqësi të madhe se një hije tjetër e re dilte nga këmbët e tij kur shëtiste në diell. Mund të kishte mbetur ndoshta rrënja e së vjetrës...»*

Reshati hoqi pulovrin dhe e vari në portmanto. Nga nëndera e dhomës së gjumit vinte një rigë e hollë drite. Me sa duket Julia ishte shtrirë dhe po lexonte. U fut që të vishte pizhamet. Julinë e kishte zënë gjumi me faqen të mbështetur mbi librin e hapur. Reshati u vesh duke u përpjekur të mos bënte zhurmë. Fiku dritën dhe doli.

Para se të futej në kuzhinë, u kthye edhe një herë për të marrë paketën e cigareve dhe çakmakun. Nga dera e hapur e kuzhinës vinte zëri i Lirës që vazhdonte të lexonte:

— *Kur mbërriti në vendin e princeshës, hija i tha dijetarit: Dëgjo këtu, miku im, jam i lumtur*

dhe i fuqishëm dhe do të të jap një provë të veçantë të mirëdashjes sime... Ti do të banosh në pallatin tim... Veç të vë një kusht, të pranosh që gjithë bota të të thërresin Hije... Kurrë nuk do të thuash që ke qenë njeri dhe, një herë në vit, kur të dal para popullit në ballkonin e ndriçuar nga dielli, ti do të shtrihesh në këmbët e mia si një hije. Jo, kjo s'bëhet, tha me zë të lartë dijetari, kurrë nuk do të pranoj këtë. Do ta shpëtoj princeshën dhe gjithë vendin nga mashtrimi. Do t'u them atyre gjithçka: që njeriu jam unë, kurse ti nuk je tjetër veçse hija ime e veshur me rroba.

Reshatit iu desh një copë kohë derisa e gjeti çakmakun, të cilin kushedi se si e kishte futur në xhepin e pasmë të pantallonave dhe, para se të shtynte derën e kuzhinës, mbajti këmbët të dëgjonte fundin e përrallës të cilën e lexonte tani Albani.

— «Në mbrëmje gjithë qyteti u ndriçua, shtinë me top. Ushtarët paraqitën armët. Princesha dhe Hija u dukën në ballkon dhe populli thirri: «Urra.» Dijetari nuk dëgjonte asgjë, sepse e kishin vrarë.»

A, jo kështu, mendoi Reshati dhe zgjati dorën drejt derës, e cila, ngaqë ishte lënë gjysmë e hapur, dukej si e spërkatur me dritë, më mirë të kishte mbaruar ashtu, me atë fjalinë e mësipërme.

Dhe përsëriti pothuajse me zë:

— Do t'u them atyre gjithçka: që njeriu jam unë, kurse ti nuk je tjetër veçse hija ime e veshur me rroba.

Isaku, A.

Hija. Roman. [Red.: B. Mustafaj.] T.,  
«Naim Frashëri» 1989.

242 f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 891.983-31

I 75

Tirazhi 8000 kopje      Formati 49x78/16      Stash 2204-82

Shtypur Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1989